



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MATURA SHTETËRORE
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Për të gjithë nxënësit dhe mësuesit
e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Tetor 2019

MATURA SHTETËRORE

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**MATURA SHTETËRORE
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA**

Për të gjithë nxënësit dhe mësuesit
e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Përgatiti për botim:

**Dr. Rezana VRAPI
Mimoza VERZIVOLLI**

© QSHA 2019

Tetor 2019

Qendra e Shërbimeve Arsimore u krijua për të ndikuar në procesin e të nxënit në shkollë përmes vlerësimit. Me qëllim që ta përmbushë këtë mision të saj, ajo është përpjekur maksimalisht të sigurojë se të gjitha vlerësimet që ajo ndërmerr, të jenë të drejta, etike dhe në përputhje me standardet teknike.

Ne jemi të ndërgjegjshëm mbi shkallën në të cilën vlerësimi ndikon në modelet dhe përmbajtjen e të nxënit në klasë. E gjithë puna jonë, në koherencë me kurrikulën, thekson rëndësinë e përputhjes mes qëllimeve, pedagogjisë, materialeve të të nxënit dhe vlerësimit.

Ky material është hartuar të kontribuojë në këtë proces koherence.

Qendra e Shërbimeve Arsimore ofron një metodë drejt një cilësie më të lartë, drejt një lidhjeje më të mirë midis të nxënit dhe vlerësimit, duke nxitur përmirësimin e procesit të të nxënit në klasë.

Si ta lexojmë këtë material

Për ta bërë sa më të lehtë përdorimin e këtij materiali, përmbajtjen e tij e kemi ndarë në seksione.

Seksioni 1 jep një informacion mbi përmbajtjen e testit në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi për Maturën Shtetërore, kompetencat që vlerëson, nivelet e vështirësisë së testit, llojet e pyetjeve etj.

Seksioni 2 përmban disa modele përgjigjesh që nxënësit kanë shkruar në testin e Maturës Shtetërore dhe mënyrën se si janë vlerësuar me pikë këto përgjigje.

Seksioni 3 përmban testet e përdorura në Maturat Shtetërore 2011- 2019.

Seksioni 4 përmban modelin e përgjigjeve të përdorura në Maturat Shtetërore 2011- 2019.

Pasqyra e lëndës

1. SEKSIONI 1	
Testimi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.....	8
2. SEKSIONI 2	
Modele përgjigjesh të pyetjeve dhe të pikëzimit të përgjigjeve tyre.....	24
3. SEKSIONI 3	
Modele testesh të Maturës Shtetërore në vite (2011-2019).....	48
4. SEKSIONI 4	
Skema të vlerësimit të testeve të Maturës Shtetërore në vite (2011-2019).....	156

HYRJE

Materiali që do t'ju prezantojmë në këtë botim, është një përmbledhje e testeve të Maturës Shtetërore për Gjuhën Shqipe dhe Letërsinë për vitet 2011-2019.

Përmes këtij botimi, ne synojmë t'iu vijmë në ndihmë nxënësve dhe mësuesve për t'u familiarizuar me natyrën e testeve dhe të pyetjeve që përdoren në testin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë të Maturës Shtetërore.

Matura e vitit 2018-2019 u shoqërua me disa ndryshime, si pasojë e ndryshimeve në kurrikulën shkollore. Vlerësimi në të fokusohet në dy fusha bazë: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi. Ajo që është më e rëndësishmja në vlerësimin e kësaj mature, nuk qëndron në matjen e aftësive të nxënësve për të riprodhuar njohuri; më e rëndësishmja është pikërisht vlerësimi i kompetencave të nxënësve për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë që zotërojnë, tashmë në situata të panjohura.

Ky model është në koherencë të plotë edhe me metodologjitë e vlerësimit të përdorura sot në vendet më të zhvilluara, ku individi vlerësohet jo për atë që di, po se çfarë është në gjendje të bëjë me atë që di.

Në materialin e prezantuar ne do të japim disa orientime mbi natyrën e këtij testi. Megjithatë, ne gjykojmë të përfshinim në këtë botim edhe teste të viteve të kaluara, pasi në thelbin e vet, Gjuha Shqipe dhe Letërsia nuk ka ndryshuar. Ajo që silllet ndryshe në këtë maturë, është vetëm përqendrimi më i madh i vlerësimit në kompetencat që nxënësi duhet të zotërojë.

Megjithëse testet e përmbledhura në këtë botim i takojnë viteve të kaluara, mënyra e vlerësimit është e zbatueshme dhe e përshtatshme edhe sot në shkollë

Ne shpresojmë që, përmes këtij botimi, i cili do të shoqërohet edhe nga botime të tjera në të ardhmen, t'iu vijmë në ndihmë shkollave jo vetëm me modele testesh, por edhe me mënyrën se si i hartojmë këto teste.

SEKSIONI 1

TESTIMI NË GJUHË DHE NË LETËRSI

Hartimi i testit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë bazohet në një metodologji të mirëpërcaktuar. Natyrisht një test i tillë nuk mund të vlerësojë të gjitha njohuritë dhe kompetencat që nxënësi ka përfutur gjatë të gjitha viteve të shkollimit. Specialistët që hartojnë testin, kanë për detyrë të fokusohen në një përmbajtje të caktuar të lëndës, e cila specifikohet përmes programit orientues të Maturës, të hartuar nga ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar).

Në mënyrë të përmbledhur çdo test i Maturës Shtetërore ka disa specifikime, ku bëjnë pjesë:

- përmbajtja: njohuri, shprehi, kompetenca,
- formati i testit (llojet e pyetjeve),
- totali i pyetjeve në test,
- totali i pikëve në test,
- nivelet e vështirësisë së testit dhe pyetjet për secilin nivel,
- koha (e testit dhe për secilën pyetje),
- pikëzimi i pyetjeve.

Kompetencat në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

Të gjitha kompetencat lëndore, mbi të cilat bazohet përmbajtja e testit, hartohen nga ASCAP. Bazuar në këto kompetenca, QSHA përgatit **objektivat e vlerësimit** (të specifikuar më poshtë), të cilat lidhen me rezultatet e arritjeve të të nxënësve. Duke qenë se provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen me shkrim, kompetencat *gjuhësore* dhe *letrare* që do të vlerësohen, janë:

- **Të lexuarit e teksteve të ndryshme, në mënyrë aktive dhe kritike**, që nënkupton atë që nxënësi jo vetëm t'i kuptojë, por edhe t'i vlerësojë njohuritë që komunikohen në tekst. Ai veçon ide kryesore në tekst, analizon modelet organizative të teksteve, nxjerr përfundime nga informacioni i tekstit, bën përgjithësime në nivel kritik, analizon elementë të stilit, vlerëson sesi stili i autorit mund të ndikojë tek lexuesi përmes teknikave të tij të shkrimit. Së fundi, ai përcakton funksionet, llojin, qëllimet, teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare.
- **Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**, gjë që lidhet me sigurinë dhe aftësinë që fiton nxënësi në të shkruar, përmes formave dhe stileve të ndryshme të të shkruarit. Në këtë rast nxënësi planifikon shkrimin në përputhje me qëllimin, lexuesin dhe kontekstin, përdor strategji të ndryshme të

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

shkrimit, duke organizuar fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin, mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje, fakte e shembuj të përshtatshëm, i përmbahet temës së esesë në një punë me shkrim.

- **Përvetësimi i rregullave të drejtshkrimit dhe pikësimit**, që pasqyrohet në saktësinë në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes, në njohjen e regjistrave të gjuhës dhe zbatimin e rregullave të drejtshkrimit. Nxënësi dëshmon aftësi të fituara gjuhësore të morfologjisë, fjalëformimit, sintaksës, leksikologjisë, drejtshkrimit, në përdorimin saktë të fjalëve, në shkrimin dhe përdorimin saktë të shenjave të pikësimit, në kalimet nga ligjërata e drejtë në të zhdrejtë, në fjalitë e ndërmjetme a të ndërkallura.
- **Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme**, që nënkupton aftësitë e nxënësve në përdorimin e teknikave të analizës së veprave letrare, si dhe interpretimin e veprave të gjinive dhe llojeve të ndryshme, duke dëshmuar kështu aftësitë e nevojshme për të kuptuar letërsinë. Aftësitë e nxënësit lidhen me vlerësimin e elementeve të tekstit letrar si: fabula e subjekti, ngjarjet kryesore që shënojnë elementët subjektualë, konfliktet, marrëdhëniet mes personazheve e skenave të veçanta, mjedisin, kohën e atmosferën, tematikën, stilin e gjuhën, kontekstin historik - kulturor, shoqëror etj.
- **Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike**, që lidhet me aftësitë e nxënësve për të vlerësuar fazat e ndryshme të zhvillimit të letërsisë botërore, lidhjen mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare, të gjinive letrare, autorëve dhe veprave më përfaqësuese shqipe dhe botërore. Kjo kompetencë dëshmon aftësitë e nxënësve për të vlerësuar rëndësinë e autorëve të përfshirë në programin e Maturës Shtetërore, si dhe interpreton e analizon vlerat ideo-artistike të veprave të tyre përfaqësuese.

Pesha e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë në test, sipas programit të Maturës Shtetërore (planifikuar nga ASCAP) paraqitet në tabelën më poshtë:

Lëndët	Pesha
Gjuhë shqipe	afërsisht 40%
Të lexuarit e teksteve të ndryshme (afërsisht 22%)	
Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit (afërsisht 18%)	
Letërsi bërthamë	afërsisht 40%
Të shkruarit	afërsisht 20%

Objektivat e Vlerësimit

Gjuha shqipe:

A. Të lexuarit

Për pjesën e të lexuarit (kompetencë që u takon të dy fushave: Gjuhës dhe Letërsisë), nxënësit vlerësohen për tri aspekte:

- **identifikim i informacionit:**
përfshin aftësi që lidhen me zbulimin, përzgjedhjen dhe grumbullimin e informacionit.
- **integrim dhe interpretim:**
përfshin procesin për t'i dhënë kuptim asaj çfarë është lexuar në një tekst. Pyetjet për këtë aspekt i kërkojnë nxënësit të kuptojë marrëdhëniet midis pjesëve të ndryshme të tekstit. Këto marrëdhënie përfshijnë lidhjet shkaktuese, krahasim- ndryshim dhe kuptimin e tyre si një e tërë.
- **reflektim dhe vlerësim:**
përfshin nxjerrjen e njohurive, ideve apo vlerave nga një tekst. Në vlerësimin e një teksti nxënësi duhet të shprehë një gjykim, bazuar ose në përvojën personale ose në njohuritë që ka mbi botën që e rrethon.

A. Të lexuarit

Nxënësi:

1. identifikon dhe drejton informacionin,
2. identifikon, organizon dhe paraqet fakte, ide dhe opinione,
3. vlerëson informacionin dhe përzgjedh atë që është i nevojshëm për qëllime të caktuara,
4. artikulon përvoja dhe shpreh atë që ndien dhe imagjinon,
5. identifikon kuptime dhe qëndrime të nënkuptuara,
6. komunikon përgjigje në mënyrë efektive dhe të përshtatshme.

B. Të shkruarit

Nxënësi:

1. artikulon përvoja dhe shpreh atë që ndien dhe imagjinon,
2. identifikon, organizon dhe prezanton fakte, ide dhe opinione,
3. komunikon përgjigje në mënyrë efektive dhe të përshtatshme.

C. Njohuri gjuhësore

Nxënësi:

1. komunikon një përgjigje të qartë, të përshtatur me kërkesën dhe audiencën,
2. përdor dhe përshtat formën e të shkruarit për qëllime dhe efekte specifike,
3. organizon idetë në fjali, paragrafë dhe tekst si një i tërë,
4. përdor si duhet shenjat e pikësimit, shkruan saktë fjalët dhe të prezanton një përgjigje të qartë,
5. përdor struktura të sakta gramatikore dhe zotëron një fjalor të gjerë për të shprehur kuptimet me qartësi dhe saktësi.

Letërsi

Në fushën e letërsisë kompetencat janë grupuar në tri aspekte, të ndara sipas tri niveleve të vështirësisë.

Njohja dhe të kuptuarit - Niveli I

Nxënësi:

1. identifikon thelbin e mjeteve letrare: si gjuhën figurative dhe mjetet e metrikës,
2. identifikon detaje apo paragrafë të veprës letrare,
3. identifikon figurat e stilistikës,
4. dallon karakteristikat bazë të një vepre letrare,
5. përcakton specifikat e një personazhi, duke u bazuar në atë çfarë ai thotë në dialog, monolog etj,
6. demonstroi një të kuptuar të ideve të një vepre apo fragmenti letrar.

Interpretimi kritik – Niveli II

Nxënësi:

1. sintetizon thelbin apo idenë e veprës letrare,
2. komenton thelbin e gjuhës figurative të përdorur nga shkrimtari,
3. shpjegon thelbin e një karakteri, nisur nga specifika të veprës letrare,
4. komenton përdorimin e mjeteve të stilistikës për krijimin e efekteve të caktuara në vepër,
5. shpjegon se si zgjedhjet e efekteve nga ana e shkrimtarit ndikojnë në krijimin e atmosferës së përgjithshme të veprës.

Gjykimi dhe përgjigja personale - Niveli III

MATURA SHTETËRORE

Nxënësi:

1. interpreton, nisur nga një perspektivë e caktuar, qëndrime dhe pozicione të hapura ose të nënkuptuara në vepër,
2. komunikon një përgjigje personale të ndjeshme dhe të arsyeshme në lidhje me veprën e lexuar,
3. vlerëson ndikimin e shumëkuptimësisë, nuancave dhe kompleksitetit brenda një teksti letrar,
4. argumenton rreth një çështjeje të caktuar.

Tabela e specifikimeve

Tabela më poshtë (tabela e specifikimeve sipas strukturës së testit) ilustron fushat për të cilat nxënësi do të vlerësohet, si dhe përqindjet që i takojnë secilës fushë. Ndarja është bërë për qartësimin e kompetencave që zotëron nxënësi dhe vlerësimin e tyre. Njëkohësisht, është mbajtur parasysh se kompetencat e të nxënësit janë parë të integruara me njëra-tjetrën në kërkesat e testit.

Fusha	Përmbajtja	Pikët	Niveli I	Niveli II	Niveli III	Përqindja
Gjuhë Shqipe	Pjesa I Tekst joletrar	16	6	6	4	26%
	Pjesa II Tekst joletrar	10	4	4	2	16%
Letërsi	Pjesa I Tekst letrar-prozë	13	5	5	3	22%
	Pjesa II Tekst letrar- poezi	13	5	5	3	22%
Të shkruajmë	ESE	8	3	3	2	14%
TOTALI		60	23	23	14	100%

Si t'i kuptojmë pyetjet në test?

Në testin e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë për Maturën Shtetërore përdoren pyetje të tipeve të ndryshme: me alternativa, me përgjigje të shkurtër, me përgjigje të hapur dhe ese.

Pyetjet me alternativa

Pyetjet me alternativa kërkojnë nga nxënësi të qarkojë alternativën e saktë midis një grupi të pasaktash ose hutuesesh. Vështirësia e këtyre pyetjeve varet nga mënyra se si i ndërtojmë alternativat. Sa më i ngushtë të jetë dallimi midis alternativës së saktë dhe të pasaktave (hutueseve), aq më e vështirë është pyetja.

Pyetjet me alternativa janë hartuar për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi. Këto pyetje i kërkojnë nxënësit të analizojë aspekte të ndryshme të teksteve të dhëna në test, të tilla si: ideja qendrore, elemente të stilit, zhvillimi i personazheve dhe përmbajtjes, si dhe fjalori.

Nxënësi mund t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve me saktësi, nëse kupton shumë mirë dhe di si ta përdorë përmbajtjen e të gjithë tekstit.

Pyetjet me alternativa vlerësojnë standardet në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në disa mënyra. Disa iu kërkojnë nxënësve të analizojnë aspekte të ndryshme të një teksti. Shumë pyetje iu kërkojnë që të kombinojnë disa aftësi. Për shembull: pyetjet mund t'i kërkojnë nxënësve të identifikojnë një pjesë teksti që mbështet më mirë idenë qendrore. Për t'i përgjigjur kësaj pyetjeje si duhet, nxënësi, fillimisht, duhet të kuptojë idenë qendrore të tekstit dhe, më pas, të tregojë se si mbështetet kjo ide. Pyetjet prirën të kërkojnë shumë më tepër se një rikujtim apo identifikim të thjeshtë.

Pyetjet me përgjigje të shkurtër

Si pyetjet me alternativa, ashtu edhe pyetjet me përgjigje të shkurtër janë hartuar për të vlerësuar standardet e arritjeve në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë. Këto janë pyetje ku nxënësi duhet të përdorë shembuj nga teksti për të mbështetur përgjigjen e tij ose të arrijë në një përfundim (një pohim, një pozicionim apo konkluzion), bazuar në analizën që i bën pjesës.

Qëllimi i këtyre pyetjeve është të vlerësojnë aftësitë e nxënësit për zbulimin, përzgjedhjen dhe grumbullimin e informacionit, për të kuptuar dhe analizuar tekstin.

MATURA SHTETËRORE

Për të dhënë një përgjigje, nxënësit duhet të shkruajnë fjali të plota. Zakonisht, përgjigjet nuk kërkojnë më shumë se tri fjali të tilla.

Pyetjet me përgjigje të hapur dhe ese

Këto pyetje janë hartuar për të matur aftësitë e nxënësve për të shkruar, bazuar në tekst ose në një kërkesë të caktuar (pyetjet ese). Këto janë pyetje që vlerësojnë nivele të larta të arritjeve të nxënësve (aftësitë interpretuese, argumentuese, krahasuese etj).

Ato kërkojnë që nxënësi të komunikojë një përgjigje të qartë dhe koherente, bazuar në tekstet e dhëna ose jo.

Çfarë kërkohet nga nxënësit?

Nxënësve që marrin pjesë në provimin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë në Maturën Shtetërore, iu kërkohet të zhvillojnë përgjigje që lidhen me katër tekste (dy tekste joletrare dhe dy tekste letrare), si dhe të analizojnë tiparet e këtyre teksteve në thellësi dhe në detaje.

Ata duhet të zhvillojnë përgjigje kritike, interpretime të ndryshme, si dhe të shpjegojnë se në ç'mënyrë autorët e ndryshëm e përdorin gjuhën, strukturat dhe formën e saj për të krijuar kuptime të caktuara në një vepër (letrare ose jo).

Ata duhet të përdorin një shumëllojshmëri detajesh nga teksti për të shpjeguar dhe saktësuar idetë e tyre.

Ata duhet të zhvillojnë krahasime të detajuara midis teksteve, të bëjnë interpretime të ndryshme, si dhe të saktësojnë kuptimet e nxjerra nga këto tekste.

Ata duhet të tregojnë se si tekstet i takojnë një tradite të caktuar gjuhësore dhe letrare, si dhe në ç'mënyrë ndikimet historiko- sociale dhe kontekstet kulturore ndikojnë në vlerësimin e një teksti.

Testimi

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Nxënësit që u përgjigjen pyetjeve në testin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, duhet të tregojnë se e kanë kuptuar mirë tekstin (në tërësi dhe në detaje), kanë kuptuar qartë edhe disa aspekte të tekstit.

Ata duhet të zhvillojnë përgjigje personale, duke treguar se e kanë perceptuar drejt qëllimin, funksionin, karakteristikat e strukturës dhe gjuhës (në një tekst joletrar), si dhe temën, motivet, personazhet, sfondin e zhvillimit të fabulës, kompozicionit dhe stilit (në një vepër letrare), duke analizuar kështu tekstin në disa aspekte të veçanta të tij.

Ata duhet t'i mbështesin pikëpamjet e shprehura në përgjigje me referenca nga teksti.

Ata duhet të tregojnë dhe shpjegojnë rëndësinë e mjedisit ku zhvillohet ngjarja (kjo vlen më shumë për tekstet letrare), sidomos mjedisit social-kulturor, traditën letrare që e shoqëron atë, etj..

Vlerësimi i arritjeve

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në Maturën Shtetërore, për Gjuhën Shqipe dhe Letërsinë, konsiston në dy pjesë.

Secila pjesë e vlerësimit ka nga dy fragmente, të cilat nuk janë punuar më parë nga mësuesit dhe nxënësit. Arsyeja e përdorimit të teksteve të tilla, të panjohura, është për të vlerësuar se sa është në gjendje nxënësi të transferojë njohuritë dhe aftësitë nga ajo çfarë bën me tekste të punuara në klasë dhe nën monitorimin e mësuesit, në tekste të panjohura; sa është në gjendje të përdorë kompetencat e fituara, në situata të ndryshme me të cilat ballafaqohet, të ngjashme me jetën e përditshme.

Pjesa I- Gjuhë shqipe

Kjo pjesë përbëhet nga dy tekste.

Fragmenti i parë është një pjesë joletrare. Ai përmban katër pyetje me alternativa, të cilat testojnë aftësitë e nxënësit për të kuptuar çështje që lidhen me strukturën e tekstit, qëllimin e autorit në parashtrimin e ideve, lidhjet shkak-pasojë.

Fragmenti pasohet edhe nga 5 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësojnë aspekte të tjera të pjesës, të tilla si: identifikimin e informacionit (i drejtpërdrejtë ose jo), vlerësimin e strukturës së tekstit, karakteristikat gjuhësore dhe përmbajtësore, si dhe gjenerimin e ideve dhe reflektimin personal.

Në vite tekstet joletrare kanë qenë të llojit: argumentues, përshkrues, informues, udhëzues. Në maturën 2018-2019 lloji i tekstit joletrar ka qenë përshkrues.

Fragmenti i dytë vlerëson njohuritë gjuhësore të nxënësit. E gjithë pjesa përmban disa probleme në strukturë fjalie, drejtshkrim, shenja pikësimi, koherencën midis paragrafëve etj., të cilat duhet të zgjidhen përmes 10 pyetjesh me alternativa, që testojnë pikërisht këto aftësi gjuhësore.

Pjesa II- Letërsi

Kjo pjesë përmban dy tekste, të shkëputura nga dy vepra letrare.

Teksti i parë i takon një autori të letërsisë shqipe.

Teksti i dytë i takon një autori të letërsisë së huaj.

Tekstet janë të gjinive të ndryshme letrare: prozë dhe poezi (poemë epike).

Secili tekst letrar ka në përmbajtje nga tri pyetje me alternativa, të cilat kërkojnë kryesisht përgjigje që lidhen me nivelin e të kuptuarit. Secili tekst ka edhe pyetje të hapura, përkatësisht teksti i parë ka 3 pyetje (me disa kërkesa secila) dhe teksti i dytë ka 5 pyetje. Secila prej tyre vlerëson kompetencat e të nxënit në të tri nivelet e arritjeve.

Pjesë e testit është edhe pyetja ese, e tipit përshkrues.

Marrëdhëniet midis tekstit të përzgjedhur dhe testit

Cilatdo qofshin aftësitë që do të testojmë, një test i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë duhet të përfshijë tekste të panjohura nga ana e nxënësit, të plota apo vetëm fragmente.

Pyetjet që bazohen në një tekst specifik, kanë këto përparësi:

1. Ato na sigurojnë se aftësitë që duam të testojmë, mund të zbatohen në një tekst të dhënë.
2. Ato na sigurojnë se përgjigjet nuk janë memorizuar, por gjenerohen nga informacioni brenda tekstit, qoftë ky i njohur apo i panjohur nga ana e nxënësit.
3. Ato janë një mënyrë shumë e mirë, përmes së cilës nxënësi mund të demonstrojë aftësi dhe njohuri specifike letrare dhe joletrare.
4. Një tekst i panjohur më parë nga ana e nxënësve, i nxit ata të shfaqin aftësi dhe informacione nga kontekste të njohura në të panjohura.

Është detyrë e një hartuesi testi, t'i zgjedhë pjesët (nga veprat) që do të përfshihen në një test. Kjo përzgjedhje duhet të orientohet nga pjesë, me të cilat mund të punohet lehtësisht. Këto fragmente duhet të kenë një gjatësi të mjaftueshme, kuptime të qarta, por duhet të jenë edhe të shkurtra, pasi zgjidhja e testit varet nga koha që nxënësit kanë në dispozicion.

Në provimet e Maturës Shtetërore përzgjedhja e fragmenteve nga tekstet bëhet duke u mbështetur në qëllime dhe pritshmëri shumë të qarta:

- fragmente tekstesh që janë lehtësisht të kuptueshme nga pikëpamja gjuhësore dhe kulturore,
- fragmente tekstesh që janë të distancuara nga pikëpamja kulturore,
- fragmente tekstesh që janë të kuptueshme dhe komplekse nga pikëpamja konceptuale,
- fragmente tekstesh që nuk kërkojnë aftësi dhe njohuri specifike (kryesisht gjenden në pjesën e parë të testit),
- fragmente tekstesh që kërkojnë aftësi dhe njohuri specifike (kryesisht gjenden në pjesën e dytë të testit, ku nxënësit për të analizuar fragmentin letrar, duhet doemos të njohin veprën e plotë dhe aspekte të tjera teorike që lidhen me të);
- fragmente tekstesh që janë përfaqësuese të çështjeve, temave apo motiveve të përzgjedhura.

Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve në test

Në testin e Maturës Shtetërore çdo pyetje ka një sasi pikësh të caktuara. Nëse nxënësi përgjigjet saktë, atëherë ai i merr këto pikë dhe e kundërta. Gjithashtu, i gjithë testi ka një total pikësh, të cilin më pas e kthejmë (konvertojmë) në notë.

Çdo pikë në test përdoret për të na dhënë një informacion në lidhje me çfarë nxënësit janë në gjendje të bëjnë.

Për të pasur një vlerësim sa më objektiv të përgjigjeve të nxënësit, duhet pasur parasysh secila pyetje e testit dhe skema orientuese e pikëzimit (ose e quajtur ndryshe edhe *skema e vlerësimit të testit*). Skema e vlerësimit është një udhëzues që përshkruan mënyrën se si vlerësohen përgjigjet e nxënësve për çdo pyetje të testit.

Roli i skemës është shumë i rëndësishëm, pasi jo vetëm i orienton vlerësuesit për një gjykim sa më të saktë dhe objektiv, por edhe ruan qëndrueshmëri në vlerësim, duke krijuar një lloj standardizimi të këtij të fundit.

Kjo është një nga arsytet se pse vlerësuesit e Maturës Shtetërore pajisen me një skemë, mbi mënyrën se si duhet bërë vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve. Në të jepen parimet e përgjithshme të vlerësimit, si edhe disa momente kyç të përgjigjes, të cilat e orientojnë vlerësuesin se ku duhet ta përqendrojë vëmendjen e tij.

Pikëzimi i pyetjeve objektive

Çdo pyetje në test ka një numër të caktuar pikësh. Për përgjigjet e dhëna saktë, nxënësi merr aq pikë sa ka pyetja. Kur ai gabon, nuk merr pikët e plota ose nuk merr asnjë pikë.

Një nga gabimet që bëhet sot rëndom në pikëzimin e pyetjeve, është se hartuesit shpesh ngatërrojnë shkallën e vështirësisë së një pyetjeje me totalin e pikëve që ajo duhet të ketë. Në rastin e pyetjeve me alternativa (objektive), përgjigjet e nxënësve vlerësohen në përputhje me përgjigjen çelës të dhënë në skemën e përgjigjeve. Për qarkimin e përgjigjes së saktë, nxënësi merr 1 pikë, nëse gabon merr 0 pikë. Pra, pavarësisht nga niveli i vështirësisë së pyetjes, ajo vlerësohet vetëm me 1 pikë.

Ka shumë specialistë që e kundërshtojnë këtë mënyrë pikëzimi, duke argumentuar se nuk është e drejtë që nxënësi të marrë 1 pikë, si në rastin kur zgjidh një pyetje të nivelit të lehtë të vështirësisë, ashtu edhe në rastin tjetër kur zgjidh një pyetje që i takon nivelit të lartë të vështirësisë. Në pamje të parë, kjo vërejtje duket e saktë. Por shtrohet pyetja: Sa pikë do të duhet t'i vëmë një pyetjeje të nivelit të lartë të vështirësisë? Nëse do t'i vendosnim 3 pikë, atëherë në cilin rast përgjigjja e dhënë nga nxënësi do të marrë 2 pikë, po 1 pikë? Shikojmë se nuk ekziston mundësia e përgjigjeve më pak të sakta (të pjesshme), për të cilat mund të jepen pikë ndërmjetëse. Pra, nxënësi ose e zgjidh drejt pyetjen ose jo. Nga ana tjetër, nëse

gjithsecili nga ne do t'i vendoste pikët sipas dëshirës apo intuitës, atëherë e njëjta pyetje mund të pikëzohet ndryshe nga hartues të ndryshëm dhe, për pasojë, nxënësit do të marrin vlerësime të ndryshme, në një kohë kur shfaqin të njëjtin nivel njohurish dhe aftësish.

Vendosja e pikëve për një pyetje duhet të ndjekë një logjikë të caktuar. Dhe kjo lidhet pikërisht me atë çfarë ne presim si përgjigje nga ana e nxënësit. Në rastin e pyetjeve objektive, përgjigjja është vetëm një, pra nxënësi e gjen ose jo dhe nuk ka mundësi për një përgjigje të pjesshme. Pikërisht për këtë arsye, këto pyetje vlerësohen vetëm me 1 pikë, pavarësisht nga shkalla e vështirësisë që mund të paraqesin.

Pra, theksojmë edhe një herë se nuk ka kurrfarë lidhjeje midis vështirësisë së një pyetjeje dhe pikëve që ajo ka. Pyetja mund të jetë e nivelit të lartë të vështirësisë dhe të ketë vetëm 1 pikë dhe e kundërta. Në një test peshën e vështirësisë së çdo niveli nuk e përcakton një pyetje, por i gjithë grupi i pyetjeve që në total bëjnë aq pikë sa i takon këtij niveli (sqaruar më sipër në tabelën e specifikimeve të testit).

Pyetjet me zhvillim (me përgjigje të shkurtra dhe të hapura)

Përgjigjet e pyetjeve me zhvillim vlerësohen duke ndjekur një parim tjetër. Pasi hartohet pyetja, hartuesi duhet të parashikojë përgjigjen që pret të japë nxënësi. Nëse ekziston mundësia e një përgjigjeje të pjesshme, atëherë pyetja duhet të ketë, më shumë se një pikë. Për shembull, pyetja mund të marrë 2 pikë dhe, për vendosjen e tyre, të ndiqet ky arsyetim: 2 pikë për përgjigjen e plotë dhe 1 pikë për përgjigjen e pjesshme. E njëjta logjikë ndiqet edhe nëse pyetja ka 3 pikë.

Gjithmonë, kur vendosen pikët në një pyetje, parimi kryesor është vendosja e kriterëve të pikëzimit. Megjithatë, përcaktimi i përgjigjes së saktë që nxënësi prit të japë, shpesh mbetet një çështje marrëveshjeje midis hartuesve: cila përgjigje do të pranohet si e saktë, cila si e pjesshme, sa gabime duhet të bëjë nxënësi për t'u penalizuar me heqje pikësh etj. Këto dhe të tjera janë disa nga çështjet me të cilat duhet të merret një hartues testi dhe që, sigurisht, kanë një rëndësi shumë të madhe në ndërtimin e testit. Pikët e vendosura pa kriter dëmtojnë cilësinë e informacionit të marrë, si dhe penalizojnë me pa të drejtë nxënësit.

Strukturimi i pyetjeve është një nga elementet më të rëndësishme, për të pasur një pikëzim të saktë: sa më qartë të jetë hartuar pyetja, aq më lehtë do të kuptohet ajo nga ana e nxënësit dhe aq më objektivisht do të vlerësohet përgjigjja e dhënë prej

MATURA SHTETËRORE

tij. Nëse pyetja ndërtohet në këtë mënyrë: Cilat janë karakteristikat e personazhit?, nxënësi nuk e ka të qartë se për sa karakteristika bëhet fjalë.

Nëse në pyetje specifikohet se duhen vetëm dy karakteristika dhe natyra e tyre, atëherë nxënësi e di saktësisht se çfarë kërkohet prej tij dhe nuk identifikon më shumë se sa po i kërkohet, si dhe nuk identifikon karakteristika të një natyre tjetër, që pyetja nuk i specifikon.

Pyetjet me përgjigje të shkurtër i kanë më të përcaktuara kufijtë e përgjigjeve dhe janë shumë më të lehta për t'u vlerësuar. Mundësia e vlerësimit subjektiv në to është tepër e limituar. E gjithë vështirësia qëndron në pyetjet e hapura ose ese. Në këtë rast nuk ekziston një përgjigje "e saktë" dhe përgjigjja e nxënësit vlerësohet në tërësinë e vet për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe nëse ajo që ka shkruar, është interesante dhe origjinale apo jo.

Kriteret e vlerësimit të një pyetjeje ese

Testi i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë në provimin e Maturës Shtetërore ka në përmbajtjen e tij edhe një pyetje ese. Kjo e fundit mund të jetë **argumentuese, përshkuese, analizuese, krahasuese** etj. Pesha që kjo pyetje zë në tërësinë e testit (8 pikë), varet nga pesha që zë rubrika të shkruajmë në kurrikul.

Në vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve për pyetjen ese, Qendra e Shërbimeve Arsimore përdor metodën analitike të pikëzimit. Kjo metodë bazohet në katër kriteret:

- shtjellimi i idesë,
- organizimi dhe struktura,
- stili dhe origjinaliteti,
- saktësia gjuhësore.

Përgjigjja e dhënë nga nxënësi për këtë pyetje, vlerësohet ndarazi për secilin nga kriteret.

Shembull:

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Shpesh dëgjohet të thuhet se adoleshentët janë të pakujdesshëm dhe nuk mendojnë për pasojat e veprimeve të tyre. Po ju si mendoni? Argumentoni qëndrimin tuaj.

Skema e vlerësimit

Për esenë ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë,
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë,
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

1 pikë **Struktura e esesë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin,
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

MATURA SHTETËRORE

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

SEKSIONI 2

Modele përgjigjesh të nxënësve dhe të pikëzimit të përgjigjeve të tyre

Në këtë pjesë të materialit do t'ju paraqesim disa modele të përgjigjeve, që nxënësit kanë dhënë në testin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë në Maturën Shtetërore 2019. Ne kemi përzgjedhur disa pyetje në test, të cilat janë me zhvillim. Fillimisht është dhënë pyetja dhe skema e vlerësimit të hartuar nga specialistët e QSHA, e cila ka shërbyer edhe për orientimin e vlerësuesve të përgjigjeve të nxënësve në Maturën Shtetërore.

Përgjigjet e dhëna si model janë vlerësuar me pikë maksimale ose të pjesshme, në varësi të saktësisë së dhënë nga nxënësi. Për të qartësuar se pse një përgjigje ka marrë pikë të plota ose të pjesshme, kemi zhvilluar edhe komente, të cilat tregojnë mënyrën e vlerësimit.

Gjithashtu, në material kemi përfshirë edhe disa modele përgjigjesh të nxënësve për pyetjet ese. Përgjigjet janë vlerësuar me pikë të ndryshme; ka prej tyre që kanë marrë pikë maksimale (8 pikë) dhe të tjera që kanë marrë pikë të pjesshme. Sërish vendosja e pikëve shoqërohet me komentin e specialistit, ku shpjegohet cilësia e përgjigjes së nxënësit dhe arsyet e vlerësimit që ka marrë.

❖ Teksti joletrar

Pëshpërima e tokës

Shembull 1

Komentoni forcën shprehëse të metaforës në fjalinë e mëposhtme, marrë në kontekstin e të gjithë fragmentit. **2 pikë**

*Për t'i shpëtuar **verbërisë sime ndaj ngjyrave**, kam kaluar shumë kohë nëpër kopshtet dhe zonat përreth.*

Skema e vlerësimit

Përgjigje e plotë

Në përgjigjen e dhënë nxënësi duhet të interpretojë **peshën** që merr fjala **verbëri** dhe **kontrastin** që krijon kjo fjalë me **ngjyrat**.

- Metafora e përdorur në fjalinë e mësipërme nxit një përfytyrim ngacmues për imagjinatën e lexuesit.

Fjala *verbëri* në këtë rast nuk është përdorur në kuptimin e parë (mungesë e plotë e shqisës së të parit). Në kontekstin e mësipërm, ky përdorim lidhet me mungesën absolute të vëmendjes ndaj ngjyrave të jetës.

Krijohet kështu një përjasje e kësaj mungese vëmendjeje me verbërinë. Verbëria nuk është gjë tjetër veçse errësirë e plotë, shkëputje kontakti me botën përreth, botën e ngjyrave dhe të ndriçimit (gjë që krijon edhe kontrastin në tekst). Kjo gjendje njerëzore është vërtet shumë e rëndë. Pikërisht këtë ngarkesë kërkon të transmetojë autori përmes këtij përdorimi: *mungesa e vëmendjes ndaj ngjyrave të jetës është e njëllotë me errësirën e plotë, mosnjohjen, shkëputjen nga realiteti i botës që na rrethon.*

Përgjigje e pjesshme

- Autori ka dashur të theksojë një lloj pandjeshmërie ndaj ngjyrave.
- Vetëm natyra me ngjyrat e saj, mund ta shpëtojë autorin nga **verbëria ndaj ngjyrave**.
- Verbëria ndaj ngjyrave domethënë të jesh indiferent ndaj tyre, të mos i shohësh ato.

2 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të plotë** forcën e metaforës në fjalinë e dhënë.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të pjesshme** forcën e metaforës në fjalinë e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

MATURA SHTETËRORE

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Metafora shpreh indiferencën që secili prej nesh, ashtu si poeti, ka ndaj natyrës, mënyrës së si ajo shfaqet, ngjyrave të saj. Ai kërkon shqisën e humbur ndaj 'mrekullive të vogla', atë të të parit.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë nga nxënësi është e plotë. Së pari, kemi një zberthim të metaforës që mbarat fjala **verbëri**. Nxënësi e ka përgjithësuar **fenomenin e pandjeshmërisë** nga teksti, duke e sjellë në shoqëri si një fenomen të përhapur. Më pas ai kalon në interpretim, ku i jep rëndësinë e duhur të parit për të ndërë bukuritë, "mrekullitë" e natyrës. Edhe pse nxënësi në vend të cilësimit "autori" (kemi të bëjmë me tekst letrar), përdor gabimisht përcaktimin "poeti" (term i përdorur në tekst letrar / poezi), ai sërish i ka marrë **pikët e plota** (pa u penalizuar për këtë), për shkak të cilësisë në interpretimin e dhënë.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Për t'i shpëtuar verbërisë sime ndaj ngjyrave, kam kaluar shumë kohë nëpër kopshtet dhe zonat përreth.
Metafora thuhet mungimin e vëmendjes së autorit ndaj ngjyrave e përforcim të ide duke e quajtur verbëri bashkim që ai nuk i kushton rëndësinë e duhur natyrës.

Komenti i vlerësuesit:

Kjo është një përgjigje e pjesëshe dhe është vlerësuar me **1 pikë**. Nxënësi ka mbetur në nivelin e konstatimit, pa zhvilluar idenë e tij apo interpretuar imazhin e krijuar. Përgjigjja është sipërfaqësore, duke mbetur në nivelin e përsëritjes së frazave nga teksti, por pa dhënë thelbin e raportit midis **verbërisë** (si metaforë) dhe gjithçkaje na rrethon.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Verbëria ndaj ngjyrave (njohur ndryshe si daltonizmi) të pengon shikimin e ngjyrave primare. Autori e përdor këtë në mënyrë metaforike për të shfaqur mospërfilljen e njerëzve ndaj ngjyrave dhe fokusin e tyre vetëm tek zymtësia.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë mbetet e pjeshme. Ka një përpjekje për të shpjeguar fjalën **verbëri**, por sërish përgjigjja e dhënë mbetet në nivel konstatimi, pa e zhvilluar në mënyrë të plotë idenë e tij.

Përgjigje e vlerësuar me 0 pikë (e gabuar)

Metatorat shpreh që njeriu zgjedh të shohë ngjyrat që dëshiron të shohë dhe kjo varet nga mendimet e tij. Prandaj duhet të vëmë më shumë re çfarë na rrethon.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja është e pavend. Ka një shpjegim të gabuar të metaforës. Asnjëra nga fjalitë e mësipërme nuk të çon në përgjigjen e saktë për pyetjen. Nxënësi në këtë përgjigje orientohet më shumë drejt nxjerrjes së konkluzioneve që lidhen me idetë e tekstit, sesa me çështje të stilit (zbërthimin e figurës letrare).

Shembull 2

Bazuar në tekstin e dhënë, **interpretoni** se cila është pesha që autori i jep fjalës. Pse ajo ka kaq shumë rëndësi për të? **2 pikë**

Skema e vlerësimit

Përgjigje e plotë

- Fjala për autorin ka një peshë shumë të madhe, veçanërisht fjala e shkruar. Ai e përjeton atë si pjesë të shpirtit, një mjet për nxitjen e imagjinatës, një mjet për të kujtuar, kur gjërat nuk i sheh dot më apo kur nuk janë më. Fjala për të është imazh, ngjyrë, ndjesi. Fjala për të është pjesë e pandarë e shpirtit.

Përgjigje e pjesshme

Në përgjigjen e pjesshme nxënësi thjesht shfaq një mendim, një ide, por pa e zhvilluar atë.

- Fjala për autorin ka peshë.
- Ajo i nxit shumë ndjesi.
- Fjala është e rëndësishme, pasi përmes saj shpreh shumë gjëra.
- Fjala e lejon autorin të kujtojë gjëra që s'mund t'i shohë drejtpërdrejt.

2 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të plotë** peshën që autori i jep fjalës.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të pjesshme** peshën që autori i jep fjalës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Fjala është pjesë e shpirtit, është ushqim për shpirtin dhe për zhvillimin tonë. Në të njëjtën kohë ajo ushqen edhe që qendron ndajqendron për të parë, por edhe "të verbërit". Është një burim i emant apimi për të arritur në pasi në orëk shpirtërisht të qartë

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja është e plotë dhe tregon se nxënësi e ka kuptuar tërësinë e tekstit. Pjesa e parë e përgjigjes tregon se pse fjala ka rëndësi për autorin e tekstit. Pjesa e dytë e përgjigjes lidhet me interpretimin e rëndësisë që merr fjala jo vetëm për autorin, por edhe për të tjerët.

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Fjala për autorin është një pjesë e shpirtit të tij. Është një mjet për të mbijllur në faset e bllokut të tij të gjitha ngjarjet e tokës. Fjala i jep mundësi këtyre ngjarjeve të jetojnë në sdo shirë duke ushqyer shpirtin e autorit dhe të lexuesve të tjerë me të bukuren. Fjala i mëson autorit dhe lexuesit se çfarë është bukuria

Komenti i vlerësuesit:

Interpretimi është i plotë dhe i qartë, që tregon se teksti është kuptuar si duhet. Nxënësi kalon natyrshëm nga situata e tekstit në përgjithësim, duke nënvizuar, fillimisht, raportin që fjala krijon me të bukuren, dhe më pas, se si e përçon atë në shpirtat tanë.

MATURA SHTETËRORE

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Autori i jep shumë peshe fjalës sepse ajo është mënyra me emër e aftësi shprehëse. Ai e konsideron fjalën si një pjesë të shpirtit dhe i jep rëndësi sepse fjalët e shkruara në letër.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë mbetet sipërfaqësore. Nxënësi parafrazon pjesë nga teksti, pa hyrë në nivel interpretimi. Ai është vlerësuar me **1 pikë** vetëm për idenë e shprehur në fjalinë e parë të përgjigjes.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Autori e vendos pesën të fjalës së tij, për të mëshuar me të. Mesazhi, kuptimi i thellë që autori përcjell vjen me përmjet fjalëve të tij. Për të kështu rëndësi sepse ruajnë vazhdimësinë e gjithçkaje.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë mbetet sipërfaqësore. Ka një ide të shprehur, kur thotë se fjalët shprehin kuptime të thella apo ruajnë vazhdimësinë, por nuk e vazhdon më tej idenë e shprehur, duke mbetur kështu në nivel konstatimi.

Përgjigje e vlerësuar me 0 pikë (e gabuar)

SHUMICË TË MARRËSIT PËR V.
Sipas autorit, pamja duhet të jetë aq e rëndësishme
kurr të lexoj në bllokun e tij aq sa ç'është kurr
ndodhi. Fjala është velem një pjesë e shpirtit p
te pane
ushqen ata që nuk mund të ndalojnë për 12 qershor 2019

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë është e pavend. Shpjegimi i nxënësit është më shumë një riprodhim i parafrazuar i tekstit. Pavarësisht se nxënësi ka shkruar një përgjigje, ajo vlerësohet me **0 pikë**, pasi mbetet e pasaktë.

❖ Teksti letrar Migjeni “...*Bukën tonë të përditshme falna sot...*”

Shembull 3

Kola dhe e shoqja janë konsideruar nga kritika si dy figura tragjike. Bazuar në fragmentin e dhënë, shpjegoni se ku qëndron thelbi i tragjizmit tek ata. 2 pikë

Skema e vlerësimit

Përgjigje e plotë

Përgjigjja duhet të theksojë se në bazë të tragjizmit qëndron pikërisht **tjetërsimi** i të dy personazheve.

- Të dy personazhet po tjetërsohen shkallë pas shkalle. Ky tjetërsim përbën edhe bazën e tragjizmit të tyre. Ata po jetojnë varfërinë më të skajshme, po vuajnë deri në kufijtë e ekzistencës. Kjo gjendje bëhet tragjike për faktin se, veç të tjerash, kjo shkallë mjerimi i **tjetërson**. Ata po humbasin vlerat njerëzore dhe po shkojnë drejt veprimeve që përmbushin nevojat më minimale, instinktet fillestare: të hanë për të mbijetuar.

OSE

- Kola po kalon në një pasivitet gjithnjë e më të dukshëm, i paaftë, i pafuqishëm të ndryshojë gjendjen e tij dhe të familjes. Gruaja e tij, në buzë të mjerimit, po kërkon rrugën e shpëtimit për të birin, duke humbur veten dhe duke përdhosur dinjitetin e saj.

OSE

- Nga një personazh pasiv, stoik në përballimin e skamjes, Kola “shkatërrohet” (huajtësohet) menjëherë. Ai ka humbur gjithçka dhe veten. Ai kurrë nuk është rebeluar, edhe në këtë moment ai s’ka fuqi të ulërijë e të bërtasë. Sfida e mjerimit ia doli ta degradojë dhe huajtësojë atë. Nga ana tjetër gruaja, në emër të detyrimeve të saj si nënë dhe grua, po humbet cilësitë e veta morale.

OSE

- Të dy po humbasin vlerat morale, për shkak të mjerimit të skajshëm.
- Të dy po humbasin në vorbullën e mjerimit, duke shkatërruar çdo vlerë morali brenda tyre.
- Ata janë të lodhur nga mjerimi, të munduar nga tradhtia apo sëmundja e djalit. Këto i çojnë pashmangshmërisht drejt tjetërsimit final.

Përgjigje e pjesshme

- Varfëria e skajshme, po i çon në buzë të shkatërrimit përfundimtar.
- Të dy po humbasin vlerat.
- Të dy po ndryshojnë moralisht.

2 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të plotë** thelbin e tragjizmit të të dy personazhet.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të pjesshme** thelbin e tragjizmit të të dy personazhet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

→ Kola është i pafuqishëm për të ndryshuar situatën me të cilën
 ndodhet, përveçisht dilemave dhe luftave të vraditshme të
 brendshme. Është pesimist dhe me një dhimbje të thellë personale.
 Nga ana tjetër gruaja është e shkatërruar moralisht dhe gjatë gjithë
 kohës në luftën për mbijetesë dhe ekzistencë. Këto tipare i bëjnë
 personazhin me fat tragjik.

Komenti i vlerësuesit:

Në këtë përgjigje nxënësi ka marrë **pikët e plota**. Në shpjegimin e dhënë,
 theksohet **tjetërsimi** i të dy personazheve, secili në veçantinë e vet, por që kjo i
 bën ato figura tragjike. Mbi të gjitha **theksohet** pafuqia e tyre përballë një realiteti
 të ashpër.

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Tragjizmi tek ata qëndron te fakti që janë të pafuqishëm
 për të luftuar dhe për të dalë nga gjendja, ku ndodhen. Ata
 i dorëzohen mjerimit dhe shohin se si biri i tyre vuan
 pa qenë në gjendje të bëjë diçka.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigja e dhënë i përmbush kriteret për të marrë **2 pikë**. Në të theksohet
 pafuqia e personazheve, pamundësia e daljes nga fati që iu është caktuar.
 Dorëzimi pa kushte përbën edhe tjetërsimin tragjik të tyre. Nxënësi e tregon qartë
 se e ka kuptuar në thellësi jo vetëm fragmentin, por edhe të gjithë veprën.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Kola, i përfto të mbajë (me) familjen e tij, e humbet rolin si burra e si baba në shtëpi e gruas. Ai në kokëkuluro me fund të tragjimit. Tragjizmitë gruas shfaqet me humbjen e fjavës së bashkëshortit me shtëpi dhe shpëtimin simon (vdekja e dilit), pasi kapërcen ato kufij. Me fund, familja mbetet e rrënuar.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja i referohet së gjithë novelës dhe nuk ka asnjë referencë të fragmenti i dhënë. Kjo përgjigje është vlerësuar me pikë të pjesëshme, për shprehjen e një ideje të nënkuptuar, që lidhet me tjetërsimin e të dy personazheve: burri që humbet rolin si mbështetja kryesore e familjes dhe gruaja që kapërcen kufijtë e saj (moralë). Shpjegimi i dhënë nga nxënësi nuk parashton ndonjë mendim origjinal, por në një pjesë risjell në mënyrë riprodhuese interpretime të bëra në tekstin shkollor dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me fragmentin.

Përgjigje e vlerësuar me 0 pikë (e gabuar)

Mjerimi del i zhveshur deri në lakunigësi. Ngrehina dhe pasigjat e tij famëkeqe rrethitësiqme jten e këvoj familjeje. Kaxet pamundësi reprimi por nga ama tjetër del në pah një rebelim i brendshëm si për tu përpyekur të kuptohet shkaku që janë në atë gjendje.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë është e pasaktë. Në të nuk shpjegohet se pse të dy janë personazhe tragjike, çfarë i bën ata të tillë. Ndërkohë ajo mbart edhe pasaktësi, si p.sh: *rebelimi i brendshëm*. Në asnjë rast personazhet nuk shfaqin një rebelim, as në fragmentin e dhënë dhe as në vepër. Ndërkohë, fjalia e fundit shfaqet e pakuptueshme në idenë që nxënësi përpiqet të përçojë. Në tërësi përgjigjja e dhënë dëshmon për një të kuptuar sipërfaqësor të novelës së Migjenit.

Përgjigje e vlerësuar me 0 pikë (e gabuar)

Që të dy, Kola dhe Shqija, kanë një jetë shumë të rëndësishme dhe me rrethana të pafavorshme edhe punat e ulëta që duhet të bëjnë për të mbijetuar të botës në këto momente të tragjike.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja është e gabuar. Në përgjigje theksohen elemente si: punë e vështirë, e pafavorshme etj, të cilat nuk e bëjnë një figurë të jetë tragjike. Përgjigjja dëshmon mosnjohje nga ana e nxënësit të thelbit të tragjizmit dhe situata të rënduara e dramatike i vlerëson si tragjike.

❖ Homeri

Iliada – Kënga XXIV (fragment)

SHEMBULL 4

Komentoni dy vargjet e para të këtij fragmenti dhe tregoni në ç'mënyrë ato përcaktojnë tonin e të gjithë pjesës.

3 pikë

Skema e vlerësimit

Përgjigje e plotë

Vargjet e para të fragmentit nisin me një shkallëzim: *I plasi vaji* dhe *vuri ulërimën* dhe vijojnë me metaforën: *duke u lëshuar* (jo- duke rendur, që është veprim njerëzor), të gjitha të hiperbolizuara, të cilat shpalosin shkallën e lartë të dhimbjes tragjike për humbjen e Hektorit. Janë detaje të veprimit, që zbulojnë gjendjen shpirtërore të Kasandrës, dhimbjen pa kufi dhe tronditjen për humbjen e vëllait.

Përgjigje e pjesshme

- Atmosfera vjen e rënduar. Figura si: metafora japin shkallën e lartë të dhimbjes.

OSE

- Kasandra është e para që shpërndan lajmin e kobshëm. Figurativisht kjo realizohet përmes figurës së metaforës apo shkallëzimit.

Si përcaktojnë tonin e të gjithë pjesës:

- Që në dy vargjet e para përcaktohet gjithçka lidhet me tonet e përvajshme të të gjithë fragmentit: *I plasi vaji e vuri ulërimën,/ duke u lëshuar përmes gjithë qytetit.*- thotë poeti. Kështu fragmenti nis me lotët e Kasandrës dhe do të vijojë me lotët e pikëllimit e të gjithë popullit.

OSE

- Një vaj i këtyre përmasave që nis me Kasandrën, do të shtrihet në gjithë fragmentin, duke përcaktuar tonet e tij të zymta e të pikëlluara, që lidhen jo thjesht me humbjen e vëllait, por të princit dhe heroit, që ishte dhe mbështetja dhe shpresa e popullit.

2 pikë

Nëse komentoni në mënyrë të plotë dy vargjet hyrëse të

MATURA SHETËRORE

fragmentit.

OSE

1 pikë Nëse komenton **në mënyrë të pjesshme** dy vargjet hyrëse të fragmentit.

DHE

1 pikë Nëse tregon se në ç'mënyrë ato përcaktojnë tonin e të gjithë fragmentit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Vargjet e para paraprijnë se çdo të ndodhë në vijim (uccori e antikitetit pararendja). Kjo jepet nëpërmjet fjalëve vaj dhe ulërimë, drama dhe pesha e madhe që këto fjalë mbartin poraqet dhe tonin dragjik me nota elegjake që pritet të vazhdojë në gjithë pjesën. Dhe pjesa lëshuar në gjithë fragmentin paraprin ngjarjen e madhe, e ngre atë në nivel të tillë që përkjet gjithë trojanëve, vaji dhe ulërima teknikut, rrëfijnë çdo të ndodhë në vazhdim.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigja e dhënë i përmbahet saktësisht asaj çfarë kërkon pyetja. Pjesa e parë e saj komenton dy vargjet e para të fragmentit. Në të nënvizohen fjalët kyç: vaj, ulërimë. Edhe pse duhej të ishte shtjelluar në mënyrë pak më të plotë kjo kërkesë e pyetjes, përsëri ajo përmbush minimumin e përgjigjes për të marrë **1 pikë**. Ndërkohë, pjesa e dytë e përgjigjes, që lidhet me tonin e fragmentit, është shtjelluar saktë nga nxënësi dhe për këtë pjesë ai sërish do të marrë **1 pikë**.

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Që në vargjet e para Homeri tregon se e gjithë pjesa do të jetë e shogëruar nga vaji i trojanëve dhe dhimbja për vdekjen e Hektorit. Që në vargun e parë poezi fillon me forcë dhe fuqi në funksion të kësaj kemi përdorimin e invercionit: i plasi vaji dhe vuri ulërimën duke nxjerrë përpara veprimin (foljen) përdoret dhe metafora foljore plasi vaji për ta përforcuar kuptimin. Përdorimi i një foljeje të zakonshme nuk do të shkaktoje të njëjtin ngacim emocional. Në vargjet e para përcaktohet vendi ku do të zhvillohet ngjarja: në qytet.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigja e dhënë më sipër përputhet me procedurën e komentit; nxënësi jep fillimisht atmosferën dhe, më pas, mënyrën se si autori e ka krijuar atë, duke komentuar edhe funksionin e figurave letrare në krijimin e imazhit. Kjo përgjigje është një rast shumë i mirë i komentit që merr **pikët e plota**, sidomos për shkak të origjinalitetit të gjenerimit të idesë që do të na përcjellë.

MATURA SHTETËRORE

Përgjigje e vlerësuar me 2 pikë (e saktë)

Vargjet e para të këtij fragmenti janë indentuar mbi bazën e V metaforës dhe hiperbolës (me pat). TONI i përcaktuar nga këto dy vargje është toni varjtues, kudo qartë e vërtetohet për të majtë Hektor, që vdiq kryelartë në luftë. Përmes metaforës "pasi varje" dhe "vuri ulërimin", paraqet mënyrën për gjithë situatën më pas, situatë të varjtjes e varjtues. Pra, që në fillim parashikohet që që do të ndodhë dhe jepet notat e para varjtuese, nota që do të shoqëronin gjithë ndodhjen më pas.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja është e saktë dhe i meriton të **2 pikët**. Në pjesën e parë, nxënësi zhvillon komentin, duke treguar se si gjuha e përdorur nga autori krijon gjendje dhe imazhe të caktuara në fragment. Ndërkohë, pjesa e dytë e saj saktëson edhe tonin që mbartin vargjet e para, që do të përcaktojë edhe tonin e pjesës në vijim.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Që në vargun e parë paraqitet gjendja e rënduar shpirtërore, dhe krijohet një ndjesi që vazhdon gjatë gjithë fragmentit; një dhimbje e tjeskajshme e ndjerë nga gjithë qyteti. Përcaktohet qartë toni varjtues i të gjithë pjesës.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë lidhet vetëm me pjesën e dytë të pyetjes. Ajo shtjellon saktësisht tonin që sundon në dy vargjet e para dhe që shoqëron më pas të gjithë fragmentin. Por në përgjigjen e dhënë nxënësi nuk merret fare me komentin e këtyre vargjeve. Për këtë arsye, ai vlerësohet me **1 pikë** vetëm pjesën e dytë të pyetjes.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Tëri i pagjetë i Hektorit u prir me vaj, ulerimë e ngashërime. Të gjithë e vajin vdekjen e tij, duke filluar nga familja e deri te gjithë populli. Të gjithë vajinë humbjen e heroit, mëngjesit të tyre, dy vargjet e para përceltojnë tonin elegjik të pjesës.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë mbetet e përgjithshme. Nxënësi, mesa duket, nuk e ka të qartë se komenti lidhet me imazhet e krijuara vetëm në dy vargjet e para dhe mënyrën sesi autori e përdor gjuhën për të na i përcjellë ato. Pjesa e parë e përgjigjes më shumë prirret të bëjë një përmbledhje të asaj çfarë ka ndodhur dhe do të ndodhë, por nuk ka asnjë koment të mirëfilltë. Përgjigjja e dhënë ka marrë **1 pikë**, pasi ka të saktë vetëm pjesën që lidhet me tonin e vargjeve dhe të fragmentit në tërësi.

Përgjigje e vlerësuar me 1 pikë (pjesërisht e saktë)

Është momenti më i bujshëm për popullin trojan, ordhja e trupit të pagjetë të heroit të Trojes, Hektorit. Menjeherë nisim ulerimet nga Kasandra e më pas gjithë qyteti e mëri vesh dhe det për ta ndërua. Me një ton elegjik, vajtues dhe shumë të dhimbshëm bëhet e ditur vdekja e Hektorit. Ulerimet që nisim, nisim po ashtu bureshitjen për marrjen më pas.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë është e pjesshme. Ajo saktëson vetëm tonin e pjesës (për këtë përgjigje vlerësohet me **1 pikë**). Nxënësi më shumë përshkruan situatën (çfarë po ndodh në këto momente), duke parafrazuar tekstin, por nuk bën asnjë koment në lidhje me imazhet që krijohen dhe mënyrën sesi përcillen këto imazhe përmes fjalëve kyç apo figuracionit letrar.

MATURA SHTETËRORE

Përgjigje e vlerësuar me 0 pikë (e gabuar)

Në vargjet e para të këtij fragmenti tregohet
lajmi që Hektori ka vdekur, dhe të gjithë vërsulen
për të parë Hektorin. Në këto vargje shpreket
dëshpërimi me një ton thirrës.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja e dhënë është e pasaktë. Në të nuk ka asnjë koment, vetëm një parafrzim të situatës, si dhe përcaktimi i tonit është i gabuar.

ESE

Disa njerëz mendojnë se përgatitja më e mire për jetën është të mësosh të punosh me të tjerët dhe të jesh bashkëpunues. Disa mendojnë se përgatitja më e mire është të mësosh të jesh konkurrues. Me cilin këndvështrim jeni dakord? Argumentoni mendimin tuaj.

8 pikë

Përgjigje e vlerësuar me 8 pikë

Shtetmbardet besojnë se disa nga aspektet dhe ligjet kombëtare kanë mbetur të vjetër dhe duhet të rishikohen dhe të përdoren në mënyrë të përsosur. Kështu me këto ligje të vjetra të shtetit dhe ligjeve të tjerë që mund të shikohen si ligje të vjetra, siç është me përsosur të konkurrencës. Konkurrenca është bërë më e rëndësishme, por edhe në shprehje të gjërë. Kështu konkurrenca gjatë kohës për uljen e shkollës dhe punës. Njerëzit bëjnë të njëjtën gjë, por me mënyrë pak me të përsosur.

Në këtë konkurrenca nuk ka asgjë tjetër. Kjo bërë që ma ndihmon të kuptoj me mënyrë të saktë koma të fjalës të drita dhe ma merr të përsosur për të përmirësuar ato. Siç do të më përsosur të kësaj të jesh, siç do të më përsosur dhe adresime. Konkurrenca mund të shprehjet me dëkë të rrethës këto. Shprehjet që bëjnë shprehjet, fjalë, shprehjet e më këto mënjë këto mund të shprehjet me probleme të mëndë fjalë apo mëndë.

Nga ana tjetër bashkëpunimi është një cilësi që jo të gjithë kanë dhe gjatë kohës për të jetuar në këto fjalë. Kështu me mënyrë të saktë të bashkëpunimit. Dëgjime për me mënyrë të saktë "apo bashkëpunimi" bën fjalë me jave shprehjet që të gjithë me mund të i kemi dëgjime e jave të saktë që dëgjime. Puna me të jetuar është me cilësi që nga pikëpamje fjalë mëndë apo edhe emra o male. Dëkë bashkëpunimi me këto mundësi të plotë për me mënyrë të saktë fjalë, dëkë asnjë mëndë me të mëndë me fjalë.

Megjithatë kë nga ato që mendojnë që puna me grup e pengon shprehjet individuale, ma bërë për të dëkë dhe të vjetër nga të jetuar. Kjo bërësi bëhet me për pengon për të përballen të vjetër situatat e vjetër. Dëkë puna me të jetuar me këto mundësi të rrethës gjatë dëkë koma, puna dëkë fjalë e këto dëgjime për me.

Une mendoj se për të dëkë në jetë është i rëndësishëm nga kombinimi i shprehjet me konkurrencës dhe bashkëpunimit. Në këto mënyrë për konkurrencës për të shprehjet dhe eca për puna, për nga ana tjetër, me mbetur "gënjë sociale e këto mënyrë për ndihmë dhe puna e të jetuar. Megjithatë dëkë të shprehjet të këqijshëm që të mëndë këto "gënjë sociale" ma merr për të jetuar, të mos legje dëkë me të bashkëpunimit të vlerësime dhe të mos bashkëpunimit të vjetër nga ndihma e të jetuar.

Komenti i vlerësuesit:
 Ky është modeli i një eseje shumë të mirë, me referenca të sakta dhe të përzgjedhura me shumë kujdes. Përgjigja dëshmon për një të kuptuar të drejtë të temës, si dhe për një kontroll të plotë të elementeve të një shkrimi efektiv. Struktura e shkrimit është tipike argumentuese, me një paragraf hyrës që prezanton në mënyrë të përgjithshme qëndrimin (opinionin) e nxënësit kundrejt çështjes; paragrafët zhvillues, që parashtrojnë argumentet mbështetëse, dhe paragrafin përmbyllës, ku bëhet përmbledhja e qëndrimit personal. Organizimi i tekstit është i saktë dhe kalimi nga një paragraf në tjetrin bëhet në mënyrë koherente. Ka fjalor të pasur dhe stil të spikatur. Përmban ndonjë gabim të vogël drejtshkrimor, i cili nuk e dëmton përshtypjen e përgjithshme që përpiqet të krijojë shkrimi.

MATURA SHTETËRORE

Në pjesën **“Pëshpërima e tokës”** autori ka krijuar një komunikim të veçantë me natyrën, gjë që shpaloset që në titull.

Vendoseni veten në një situatë komunikimi me natyrën. Cilat janë fjalët që ajo “ju pëshpërit”? Përshkruani marrëdhënien tuaj me natyrën që ju rrethon. **8 pikë**

Përgjigje e vlerësuar me 3 pikë

Natyra, padyshim, është gjëja më e bukur që na rrethon. Bukuria e saj nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër në këtë botë.

Natyra në çdo stinë të sajën ka të karakteristikat e sajë. Pranvera është stina më e bukur, ku çdo gjë lind. Dielli fillon të shkëlqejë më shumë dhe sytë çelin. Ka gjetet fillimin e rilindin pas një dimri të acartë. Gjithashtu dhe kafshët dalin duke soditur dhe shijuar bukurinë që të fal nëna natyrë. Çdokush duke parë nga shiritaja mund të shikojë manshapet e sapa çelura apo sesi fluturojnë dallëndyset, simboli i një jete të re.

Natyra simbolizon ngjyrat e çelura, të cilat na japin jetë. Natyra për këdo mund të jetë frymëzuese, ashtu si dhe për mua. Çdo ditë, duke dalë shëtitje me shokët e mi vërejtja dicka të re, ~~At~~ sep sesi shndërriste livadhi nga pikat e vesës apo sa e mbretkultureshme është të shohesh një perëndim me ngjyra që të çelura.

Komenti i vlerësuesit:

Përgjigjja shfaq probleme, qoftë në idenë që përpiqet të trajtojë, qoftë në anën gjuhësore. Nxënësi shumë pak e prek idenë që parashtron tema, pasi përshkruan elemente të natyrës (bukuria, dielli, stinët etj), por asgjë nuk lidhet me komunikimin personal të tij me natyrën. Ka elemente të përshkrimit, por nuk janë ato që sundojnë punimin; paragrafëve u mungon raporti koherent, madje edhe brenda tyre fjalitë nuk sigurojnë rrjedhshmëri logjike. Vihet re një leksik i varfër dhe stil gati bisedimor, megjithë disa përpjekje të vogla aty - këtu. Si përfundim,

eseja do të vlerësohet me 1 pikë për idenë, 1 pikë për stilin dhe 1 pikë për drejtshkrimin.

Përgjigje e vlerësuar me 5 pikë

Natyrë është nëna jonë, themeli i gjithë jetës që ne, si njerëz, kemi ndërtuar. Ajo është po aq e bukur, sa e vrazhde. Po aq e qetë, sa e stubishme. Çdo rrezë dielli, çdo puhizë, çdo cicërimë zogjsh, çdo ngjyrë lulësh apo dallgë deti, është një pëshpërimë e natyrës.

Për të dëgjuar pëshpërimet e saj, jo vetëm që duhet të hapim gjithë shqisat drejt saj, por edhe zemrën dhe shpirtin. Në jemi produkt i natyrës, kështu që copëza të saj ndodhen brenda secilit prej nesh. Kjo na e bën të mundur komunikimin tonë me të, pa qenë fizikisht të ekspozuar ndaj saj.

Shpirtërisht tani ndodhemi në një lëndinë ku dielli ka shtuar rrezet e tij mbi çdo fytyrë bari. Natyrë po më flet, shumë qetë dhe ambal. Fllodë që fajn zhurit çdo gjëthe pemë, e duket sikur ato kuvendojnë me njëra-tjetrën. Pashtë pemës, nën një fytyrë që vesh timpin tim, natyrë vazhdon më flet. Kësaj radhe që më flet me sugurat e lulëve, sikur të ishte krijuar një yber në tokë. Çdo lule duket sikur ka personalitetin e saj, e rinë afër e afër me njëra-tjetrën si shoga lozonjare.

Përtej lëndinës ndodhet një ligen. Ai valon aq ngadalë duke qetësuar kështu çdo mendim timin. Natyrë më flet përsëri, me disa pesha që notojnë me ngut nën ujë, e më thotë se jeta është gjithmonë në lëvizje, edhe pse mund të duket e qetë në sipërfaqe.

Së fundmi, afrohem pranë ligenit dhe shoh fytyrën time aty. Ujë jam një refleksion i natyrës. Çdo element dhe tipar i imi është shikimje e bukurive të natyrës ilnë jam dhe do të jem gjithmonë pjesë e saj, pa ashtu të gjithë ne. Prandaj le ta dëgjim më afër kë për të thënë. Mos ta lëmë vetë të pëshpërim, për të bërtanë më zë të lartë.

Komenti i vlerësuesit:

Në përgjithësi kjo është një përgjigje e cila mbart disa karakteristika të mira. Nxënësi duket se e ka kuptuar temën, ka një ide tek e cila fokusohet dhe përpjetat ta përcjellë në mënyrë të kuptueshme tek lexuesi. Vihet re një përpjekje për ta strukturuar përgjigjen me një hyrje, zhvillim dhe mbyllje. Megjithatë paragrafi hyrës shfaq probleme, pasi e gjithë hyrja është konceptuar në dy paragrafë, të ndarë artificialisht nga njëri-tjetri, edhe pse mbartin të njëjtën bërthamë paragrafi dhe të njëjtën vetë komunikimi (veta I shumë). Ndërkohë e gjithë pjesa tjetër organizohet në vetën I njëjës. Kjo dëmton edhe stilin e punimit. Edhe pse ka përpjekje për të përzgjedhur detajet përshkruese, në disa raste zgjedhja e tyre nuk është e duhura (antitezat në fillim apo përsëritjet e panevojshme të fjalëve). Të njëjtën gjë mund të themi edhe për fjalinë përmbyllëse, ku sërish përzgjedhja nuk është e duhura. Teksti është shkruar pastër, me një sintaksë të rregullt dhe me gabime të parëndësishme drejtshkrimore. Si përfundim, për idenë, strukturën dhe stilin

MATURA SHTETËRORE

nxënësi do të marrë nga **1 pikë**, kurse për sintaksën dhe drejtshkrimin do të vlerësohet më **2 pikë**.

Përgjigje e vlerësuar me 8 pikë

Mje pjerë të madhe të familjarisë time e kam kaluar në fshat, në mjedise të hapura, ku syri të shikte aer gjelbraim.

Kishin, gjatë asnes së madhe përvëluese, diçja autem, deri në fund, ku misrim tëlot e të feneve dhe ulesha këmbëkryq mbi bar. Ja, e shoh porsi sot atë parje të bukur, që gjendet autem në piktura artistesh të mëdhenj.

Nën hijen e pleparë, një fllad lexonjan luan me fokat e mi. Ranguca e vogël mbuluar me bar leix cipra flladit. Cussi, akoma i gjelbra, tund kokën ndaj pëshpëritjes së enës.

Mje kokofoni kërcën syen ndër ashe. Pemit çuqurisim diç me gjatëet e tyre, të përkulurua prej enës. Zogjtë kuvendojmë magje tyre, por edhe ndër fusha, me xiant etyre melodioze. Diku kockejmë edhe baethkonit për të mos mbetua prapa, e me pas, llokociten më për kanalet e vogla me ujë të flladit.

Natyna merr fajmë lirisht aty ku nuk ka mjesez. E, bashkë me të, marr fajmë edhe unë. Dëgjoj gjithë këchillat e saj, falët që i merr era. Pëshpëritjet janë magje me të emblat. Ato të bëjnë mje me shpirtim e vetë natyren. Aty kupton që jeta s'është asçse një iluzion. Natyna është e dëgjeta e vetme në këtë botë.

Aty kupton edhe diçka tjetër: askush nuk mund ta kapë nëtete-sion e natyres. Asnjë këngë, asnjë poezi, asnjë vepër e asnjë pikturë nuk mund t'i kuptojë tërësisht pëshpërimat e saj.

Këto kujtime e parje të embla gjenden thellë brenda meje; çdo leixje, çdo poezi, çdo ndjersi midis gishtërimeve është e gdhendur me shpirt.

Komenti i vlerësuesit:

Kjo ese përmbush në mënyrë të plotë të gjitha kërkesat që parashtrohen në temë. Ideja është shtjelluar në thellësi, e sjellë përmes imazheve pamore e dëgjimore, që zgjon nxënësi, duke renditur një sërë detajesh plot ngarkesë emocionale. Shkrimi organizohet saktë brenda strukturës përshkruese, me një hyrje interesante, shumë personale, me paragrafë zhvillues të strukturuar mbi bërthama paragrafesh të mirëmenduar dhe një mbyllje përmbledhëse që lë gjurmë të lexuesi. Duket se leksiku është përzgjedhur me shumë kujdes; shumëllojshmëria e imazheve që ofrohen, përkon me shumëllojshmërinë e fjalëve që nxisin përfytyrimin. Të gjitha këto vijnë përmes strukturash fjalie të të

gjitha llojeve, të organizuara drejt si nga ana sintaksore dhe ajo drejtshkrimore dhe pikësimi. Mendojmë se është një ese model e llojit përshkrues.

SEKSIONI 3

**MODELE TESTESH TË MATURËS
SHETËRORE NË VITE**

(2011-2019)

MATURA 2011

PJESA I

LASGUSH PORADECI

Kënga pleqërishte

O këngë pleqërishte! Ti vjersh' e Vendit t'em!
Ti fjalë që më dhimsesh e që më bën ujem!
Tashi jam dëshëruar së largu të më vish:
Dëgjoju, as dëgjoju! moj këngë pleqërisht!

.....
...Në hije të kasolles që nxin atje mi mal,
J-a nis me zë të shtruar...j-a merr më dal-nga-dal...;
J-a thua më të dhembshur...j-a thua më të qarë...,
J-a derdh e përvëlur...j-a zjen... e ja heq zvarë...
Pastaj fillon të ngrihesh, e nis e j-a thërret:
Dh'aq letë- e ngreh së poshti...aq fort e shpje përpjet...,
Aq dyke mërmëruar me zë të parpalitur
Rënkimi –i zemrës s'ate ronitet më të ngjitur...,
Sa... që nga lartësira ku vate fluturoj...,
Me sulm e ulërimë këputet si përroj...
E rrjeth për tatëpjetë prej kulmit qielluar
Si breshër i thërrmuar...si lot i përvëlur...
Pastaj të shuhet zëri...e rrihesh... edhe vdes:
Mjerimi-i vetëvetes të thjevi mes-për-mes:
Së felli-e pa mëshirë të thjevi dhembja jote,
Dëshir' e varfëruar e Këngës magjiplotë!

.....
.....
O këngë pleqërishte! O vjersh' e Vendit t'em!
O fjalë që më dhimsesh, e që më bën ujem!
O mall! O psherëtimë! O vajë! – O lot i zi!
O shpirt i përvëlur që qan nër syt' e mi!
Si ngrihet që nga deti një valë- e dëshëruar:
Nga fund' i zemrës s'ate ti ngrihesh dyke vuar;
E prapë posi vala, që bje së-rish në det:
Ti bje në fellësirën e zemërës së vet.

MATURA SHTETËRORE

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

1. Kjo poezi e Poradecit bën pjesë në lirikat e tij: **1 pikë**

- A) Filozofike.
- B) Të peizazhit.
- C) Erotike.
- D) Shoqërore.

2. Ç'funksion luan përdorimi i foljeve *nis, merr, thua*, në strofën e dytë? **1 pikë**

- A) Krijon efekte simbolike.
- B) Shërben si refren i poezisë.
- C) Krijon imazhin e fazave të këngës polifonike.
- D) Krijon përshtypjen e trokitjes së hapave në kalldrëm.

3. Është fjalë e krijuar nga Lasgushi (neologjizëm): **1 pikë**

- A) mjerimi,
- B) psherëtima,
- C) qielluar,
- D) kënga.

4. Cili nga çiftet e mëposhtme krijon antonimi të kontekstit poetik? **1 pikë**

- A) Që më dhimsesh - që më bën ujem.
- B) Pastaj fillon të ngrihesh – pastaj të shuhet zëri.
- C) J-a nis me zë të shtruar - j-a merr më dal-nga-dal.
- D) Të thjevi dhembja jote – e rrihesh.. edhe vdes.

5. Imazhi *i valës së detit* në fund të poezisë është përdorur për të treguar: **1 pikë**

- A) procesin dinamik të krijimit.
- B) egërsinë dhe butësinë e detit.
- C) misterin që mbart deti në vetvete.
- D) lidhjen e përrjetshme midis valës dhe bregut.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

6. Cili nga vargjet e mëposhtme shërben si lajtmotiv i poezisë? **1 pikë**
- A) O fjalë që më dhimsesh, e që më bën ujem!
B) O këngë pleqërishte! Ti vjersh' e Vendit t'em!
C) Dëgjoju, as dëgjoju! moj këngë pleqërish!
D) O mall! O psherëtimë! O vajë! – O lot i zi!

7. Pse poeti, si dhe te *Vdekja e Nositit*, e përjeton procesin krijues si shumë të dhimbshëm e të mundimshëm? Mendimin tuaj ilustrojeni me detaje nga fragmenti. **2 pikë**
- _____
- _____

8. Shpjegoni si lidhet *kënga pleqërishte* me vetë poetin. Ç'ëndësi ka kjo këngë për të? **3 pikë**
- _____
- _____
- _____

9. Në këtë poezi procesi krijues kalon në tri faza: *ngjitje, pikë kulmore* dhe *zbritje*. Gjeni nga një varg që shënon secilën fazë. **3 pikë**

ngjitja: _____

pika kulmore: _____

zbritja: _____

10. Zbuloni një metaforë emërore dhe një epitet metaforik, që janë përdorur për të cilësuar *këngën pleqërishte*. **2 pikë**

metaforë emërore: _____

epitet metaforik: _____

MATURA SHETËRORE

11. Gjeni në poezi një detaj që krijon efekt pamor dhe një tjetër që krijon efekt dëgjimor. **2 pikë**

pamor: _____

dëgjimor: _____

12. Cila është *mënyra* e foljes në vargun: *Dëgjoju, as dëgjoju! moj këngë pleqërish!?*

Cili është funksioni i këtij përdorimi? **2 pikë**

mënyra: _____

funksioni: _____

13. Mbi cilën figurë të stilistikës ngrihen katër vargjet e fundit? Interpretoni nëntekstin e këtij përdorimi. **3 pikë**

figura: _____

interpretimi: _____

PJESA II

BALZAK

Evgjeni Grande (fragment)

Evgjeninë e kishte regjur vetmia. Ajo ishte në gjendje t'i shikonte dhe t'i gjykonte me sy të mprehtë ngjarjet rreth saj; e mësuar nga plaga e dashurisë dhe nga edukata, ajo i vërente çështjet thellë me intuitë. Ajo pat kuptuar dhe ish bindur se i shoqi dëshironte vdekjen e saj që t'i merrte pasurinë, atë pasuri të madhe që ishte rritur edhe më tepër nga trashëgimi që la noteri, i ungji i kryetarit, si dhe nga ajo e ungjit tjetër, abatit Krysho, të cilin zotit iu shkrep ta thërrasë pranë tij. Vajza buzëplatur dhe e vetmuar pat mëshirë për kryetarin; po zoti ia mori hakun për poshtërsinë dhe indiferencën e një bashkëshorti, i cili respektonte, si garancinë më të fortë, pasionin pashpresë që ushqente Evgjenia. T'i dhuronte një fëmijë, a nuk do të thoshte kjo që t'ia rrëzonte kryetarin të gjitha shpresat e egoizmit të tij, gëzimet dhe ambiciet e tij? Zoti e rrethoi robëreshën e tij me thasë plot me florinj. Po kësaj gruaje nuk i bënte asnjë përshtypje ari. Ajo i kishte varur të gjitha shpresat e saj në qiell. Jetonte e devotshme, pa bërë zhurmë, ndihmonte vazhdimisht dhe fshehurazi fatkeqët.

Kështu zonja De Bonfons mbeti e ve në moshën 33 vjeç, me një pasuri prej tetëqindmijë frangash të ardhura në vit, akoma e bukur ashtu siç mund të jetë një grua që ecën drejt të dyzetave. Fytyra e saj është e bardhë, e qetë, zëri i saj i ëmbël, i butë dhe sjelljet e saj të thjeshta. Në zemrën e saj ka bërë fole fisnikëria që rrjedh prej dhembjes dhe shenjtëria e një njeriu që nuk e ka njollosur kurrë shpirtin në kontakt me botën e jashtme. Po në të njëjtën kohë, ajo ka marrë tiparet e një vajze të plakur dhe zakonet bajate që rrjedhin nga jeta e mbyllur e provincës. Megjithëse ka tetëqindmijë franga të ardhura, ajo vazhdon të jetojë ashtu si jetonte dikur e shkreta Evgjeni Grande. Zjarrin e ndez vetëm ato ditë që e lejonte i ati dhe e shuan sipas programit të ditëve të çupërisë së saj. Vazhdon të vishet si e ëma.

Shtëpia e saj në Somyr, pa diell, pa ngrohtësi, e zymtë, melankolike, është pasqyra e gjallë e jetës së saj. Vazhdon të grumbullojë me kujdes të ardhurat dhe ndofta tek-tuk ka ndonjë që e quan koprrace dhe zemërngushtë. Po këto thashetheme ajo i përgënjeshton me përdorimin fisnik të pasurisë së saj. Ajo ngriti institute mirëbërëse, një azil për pleqtë, hapi shkolla fetare për fëmijët dhe një bibliotekë publike, me gjithë pajisjet. A nuk mjaftonin këto që t'ua mbyllnin gojën atyre që llogotitnin poshtë e lartë për koprracinë e saj? Zonja De Bonfons, që disa me tallje e quanin "zonjushë", frymëzon ndër të gjithë respektin më të thellë. Ajo i zbukuroi kishat e Somyrit... Po megjithatë, në atë zemër fisnike që rrihte vetëm për ndjenjat më ledhatare, tashti nisi të rëndonte pesha e interesit dhe e llogarive. Dhe

MATURA SHTETËRORE

ngjyra e ftohtë e parasë filloi të pasqyrohej në atë jetë qiellore dhe ta bënte të humbiste besimin ndaj ndjenjave, atë grua që ish kokë e këmbë ndjenja.

- Vetëm ti më do në këtë botë, - i thosh Nanosë.

Dora e kësaj gruaje shëron plagët e fshehta të atyre që vuajnë. Evgjenia po ecën në rrugën drejt qiellit, e shoqëruar nga shumë vepra mirëbërëse. Madhështia e shpirtit të saj ia mbulon vogëlsitë, edukatën dhe zakonet e saj të përditshme.

Kjo është historia e kësaj gruaje, e cila, ndonëse jetoi në këtë botë, nuk ish për këtë botë. Ajo qe lindur për të qenë grua e shkëlqyeshme dhe nënë; dhe tashti s'ka as burrë, as familje, as fëmijë.

Shënim:

De Bonfons ~ Në këtë fragment, Evgjeni Grande shpesh prezantohet me mbiemrin De Bonfons, të cilin e ka marrë pas martesës.

Për pyetjet nga 14 deri në 20 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

14.Ç'cilësi e karakterit të bashkëshortit të Evgjenisë zbulohet në marrëdhënien që ai ka me të? **1 pikë**

- A) Egoizmi.
- B) Përlësia.
- C) Vetëmohimi.
- D) Përkushtimi.

15.Evgjenisë nuk i bën më asnjë përshtypje *ari*, sepse: **1 pikë**

- A) ajo e di që s'është i saj.
- B) vlera e tij kishte filluar të binte.
- C) ai nuk ia rikthen dot dashurinë e humbur.
- D) mendon se ai i mjafton për të gjithë jetën që i mbetet.

16.Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur metafora? **1 pikë**

- A) Zjarrin e ndez vetëm ato ditë që e lejonte i ati.
- B) Po kësaj gruaje nuk i bënte asnjë përshtypje *ari*.
- C) Ajo i vërente çështjet thellë me intuitë.
- D) Në zemrën e saj ka bërë fole fisnikëria.

17. Cili është sinonimi i fjalës *regjur* në fjalinë e mëposhtme?

1 pikë

Evgjieninë e kishte *regjur* vetmia.

- A) Nënshtruar.
- B) Stërvitur.
- C) Pushtuar.
- D) Lodhur.

18. Evgjenia mund të përshkruhet si një grua:

1 pikë

- A) cinike dhe egoiste.
- B) e ftohtë dhe indiferente.
- C) fisnike dhe e virtytshme.
- D) e dashur dhe gazmore.

19. Në fragmentin më lart, Evgjenia e ndien se mund të mbështetet vetëm te:

1 pikë

- A) i shoqi.
- B) Nanoja.
- C) abati Krysho.
- D) njerëzit që vuajnë.

20. Në cilën nga alternativat e mëposhtme mbiemri është përdorur me kuptim të drejtpërdrejtë?

1 pikë

- A) Ngjyra e ftohtë e parasë.
- B) Shtëpi melankolike.
- C) Fytyrë e bardhë.
- D) Zakonet bajate.

21. Disa zakone të vjetra mbeten të rrënjosura te Evgjenia, edhe pse është mjaft e pasur. Gjeni në fragment dy të tilla, që dëshmojnë jetën që ajo bën tashmë.

2 pikë

MATURA SHTETËRORE

22.

a) Ku qëndron ndryshimi më i madh midis Evgjenisë dhe të atit? **1 pikë**

b) Evgjenia jeton në një mjedis provincial. Zbuloni një tipar dallues të këtij mjedisi. **1 pikë**

c) Pse Evgjenia i përkushtohet kaq shumë bamirësisë? **1 pikë**

23. Cila është figura e stilistikës që përdor Balzaku, për të përshkruar Evgjeninë?

Me ç'pjesë të ligjëratës krijohet ajo? **2 pikë**

figura: _____

pjesa e ligjëratës: _____

24.

a) Shpjegoni dramën e madhe të jetës së Evgjeni Grandesë. Mbështeteni mendimin tuaj me ilustrime nga fragmenti. **3 pikë**

b) Ç'ndjesi ju shkakton ky fragment, që është edhe mbyllja e romanit? Cili është mendimi i parë që ju lindi, kur e mbaruat së lexuari atë? **2 pikë**

25. A do t'i rekomandonit një mikut tuaj të lexonte romanin "Evgjeni Grande"?

MATURA 2012

PJESA I

Arti i optimizmit

Bota në të cilën jetojmë, është një botë ku e mira dhe e keqja ecin krah për krah. Nëse ajo është kryesisht e mirë ose e keqe, kjo varet nga këndvështrimi ynë. Ta shikosh botën në një mënyrë ku çdo gjë të duket e keqe, është më së shumti arti i pesimizmit. Shikimi i botës në një mënyrë që dallon vetëm të mirën dhe e hedh të ligën tutje, është arti i optimizmit. Në të dyja rastet është e njëjta situatë: pra, është thjesht çështje këndvështrimi. Nëse duam të jemi pesimistë apo optimistë, kjo varet pjesërisht nga tipi, por sidomos nga prirjet apo dëshira e gjithsecilit. Nëse je i lumtur, kjo është më së shumti merita jote. Nëse je fatkeq, ky është faji yt. Dëshiroj t'ju ofroj, secilin për secilin nga ju, një recetë, si për pesimizmin ashtu dhe për optimizmin, kurse juve ju takon të zgjidhni vetë. Të jesh pesimist apo optimist, kjo nuk do të thotë që bota është krejtësisht e mirë ose e keqe. Varet se çfarë pëlqen, çfarë dëshiron dhe çfarë zgjedh që të jesh. Ndoshta ti je njeriu më me fat dhe më i lumtur mes dëgjuesve të mi. Mijëra të tjerë ndofta do të ishin të mjerë, pavarësisht se do të ishin në të njëjtën situatë me ju. Ata do të ndiheshin fatkeq, sepse të tillë janë ndërtuar dhe kjo është mënyra e tyre për t'i parë gjërat. Në jetën tënde të lumtur, për ta pasur zili, tërë shëndet, mirëqenie, darka me miqtë; në interesat e tua të ndryshme, pesimistët prapëseprapë do të gjenin shumë gjëra për t'u ndjerë të mjerë. Nga ana tjetër, mes dëgjuesve të mi, ti mund të jesh një nga ata njerëz që ke kaluar kohë të vështira, ke humbur shokët më të dashur, je përballur fort me skamjen, me armiqtë më të këqij që të rrethojnë, padrejtësitë më mizore; duket se ti, si njeri, ke më pak arsye për të dashur jetën. Por mijëra njerëz të tjerë do të ishin tej mase të lumtur nëse do të gjendeshin në të njëjtat rrethana. Jeta është si oqeani. E mbyjt dikë, sepse i dorëzohet verbërisht së keqes. Por mban në sipërfaqe tjetrin, sepse lufton me forcë dhe energji.

Tashmë dihet se në jetën e kujtdo ka halle, telashe, të këqija që kërkojnë kurajë, përndryshe, ai që priret ta lëshojë veten, do të ndihet i mjerë. Të tërë njohim njerëz që e kanë tavolinën plot, kanë një çati mbi kokë, një krevat të butë, para në bankë për të mbuluar tërë nevojat e jetës, miq të shumtë, pozitë të mirë shoqërore, familje të qëndrueshme, edukim të mirë, madje mund të merren edhe me fe. Megjithatë, jo rrallë ndodh të zmadhojnë diçka jo të mirë që kanë përjetuar kohë më parë ose një situatë që ndoshta mendojnë se do t'iu ndodhë në të ardhmen dhe, duke u ankuar,

ia dalin ta bëjnë veten e tyre dhe këdo tjetër që të ndihet përherë i mjerë dhe në siklet. Këta kanë arritur artin e pesimizmit.

Praktikisht, kushdo mund të jetë pesimist nëse do. Ky art mund të mësohet lehtësisht. Më poshtë po japim rregullat për të.

Jetë në kohën e shkuar, përqendrohu në atë që mund të marrësh dhe jo në atë që mund të bësh. Medito për atë që mund të jetë më shumë, sesa për atë që është. Si në të shkuarën ashtu dhe në të ardhmen, merru gjithmonë me atë që ka ndodhur ose që do të ndodhë dhe mos u përball me faktet e së tashmes. Gjeje gabimin tek të tjerët, në vend që të rregullosh punët e tua. Ndiq parimet e të tjerëve në lidhje me respektin, në vend që të kesh mendimit tënd për atë që është e drejtë dhe e përshtatshme.

Ruaji këto rregulla me besnikëri, gjithmonë duke e matur vlerën e jetës sipas kushteve të kënaqësisë personale, në vend të përpjekjes për t'u rritur si karakter ose për të arritur më të mirën dhe do të jesh pesimist përpara se ta kuptosh. Sepse pesimizmi është një përfundim logjik dhe i pashmangshëm i mënyrës se si e shikojmë jetën.

Njeriu optimist i pranon me kurajë të gjitha *faktet e vështira*, ndërsa pesimisti tamam në këto situata e lëshon veten. Gëzimi është i shpejtë. Asgjë nuk mund të na kënaqë përgjithmonë. Një shkrimtar i madh i tha dikur një artisti, që ankohej se sa i pakënaqur ishte me atë që kishte bërë: "Mendo, po të ishe i kënaqur, do të ishe i kënaqur me shumë pak!". Optimizmi shpall pikërisht paaftësinë tonë për t'u kënaqur me diçka të caktuar dhe përgjithmonë.

Meqë kam dhënë rregulla për artin e pesimizmit, mendoj se jam i detyruar të jem po aq i qartë edhe për sa i përket optimizmit. Janë po ato rregulla apo situata për të cilat u shpreha më lart, por në një *kahje* tjetër; rregullat e optimizmit janë e kundërta e rregullave të pesimizmit.

Jetë në kohën e tashme, përqendrohu në atë që mund të bësh, në vend që të vrasësh mendjen në atë që të ndodh. Shqetësohu për atë që është dhe jo për atë që mund të jetë. Në përditshmërinë tënde përqendrohu tek ajo që ke në duar, pa u penduar për të shkuarën dhe pa u shqetësuar për të ardhmen. Kritikoje veten në vend që të dënosh të tjerët. Këshillohu me vetveten, në vend të miratimit të shumicës.

Kushdo që e jeton jetën në një përkushtim jo egoist ndaj të tjerëve dhe gjithçkaje, është gati për ta parë jetën e tij të plotë, të pasur, të kënaqur dhe të lirë, me fjalë të tjera është gati për të qenë optimist.

MATURA SHTETËRORE

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni alternativën e saktë.

1. Pjesa e mësipërme mund të klasifikohet si: **1 pikë**
- A) fjalim politik.
 - B) fjalim bindës.
 - C) fjalim joformal.
 - D) fjalim miratues.
2. Në këtë pjesë autori i fton lexuesit: **1 pikë**
- A) të japin para për bamirësi.
 - B) të kalojnë kohën në natyrë.
 - C) të jetojnë në të tashmen.
 - D) të ndjekin detyrat e tyre.
3. Autori ndan me lexuesit pikëpamjen se: **1 pikë**
- A) qëllimi kryesor i jetës është kënaqësia.
 - B) është e lehtë të jesh i lumtur, nëse je i shëndetshëm.
 - C) çdo njeri ka fuqinë të kontrollojë cilësinë e jetës së vet.
 - D) njerëzit duhet të injorojnë rregullat shoqërore dhe të bëjnë çfarë iu pëlqen.
4. Në fjalinë e parë të **paragrafit gjashtë**, shprehja “fakte të vështira” nënkupton: **1 pikë**
- A) realitetet e vështira të jetës.
 - B) mësimet që duhen mësuar.
 - C) gjërat që janë të vështira për t’u kuptuar.
 - D) gjërat që një pesimist beson se janë të vërteta.
5. Në fjalinë: “Janë po ato rregulla apo situata për të cilat u shpreha më lart, por në një kahje tjetër”, fjala **kahje** ka kuptimin: **1 pikë**
- A) ide,
 - B) drejtim,
 - C) propozim,
 - D) kuptim.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

6. Në cilën prej alternativave të mëposhtme gjuha e përdorur nga autori bëhet më emocionale dhe figurative? **1 pikë**

- A) Jeta është si oqeani. E mbytet dikë, sepse i dorëzohet verbërisht së keqes.
- B) Jeta në kohën e tashme, përqendrohet në atë që mund të bësh, në vend që të vrasësh mendjen në atë që të ndodh.
- C) Ruaj këto rregulla me besnikëri, gjithmonë duke e matur vlerën e jetës sipas kushteve të kënaqësisë personale.
- D) Nëse duam të jemi pesimistë apo optimistë, kjo varet pjesërisht nga tipi, por sidomos nga prirjet apo dëshira e gjithsecilit.

7. E gjithë kjo pjesë bazohet në një kundërvënie. Zbuloni dy fjalët kyç që japin thelbin e saj. Cili është mjete gjuhësore që realizon këtë kundërvënie? **2 pikë**

fjalët kyç: _____

mjete gjuhësore: _____

8. Sipas autorit, çfarë e përcakton natyrën tonë si *pesimiste* apo *optimiste*?

1 pikë

9. Shikoni me kujdes **paragrafët katër dhe tetë**. Në ç'loj teksti do t'i përfshinit ata? Përcaktoni dy karakteristika gjuhësore, tipike për këtë lloj teksti. **3 pikë**

PJESA II

Sharl Bodler

Albatrosi*

Shpesh, marinarët për t'u zbavitur kapin,
Albatrosët, k'ta zogj viganë që mes kthetrave,
Moskokëçarës u ngjiten anijeve që shkasin,
Përmes thellësive të hidhura të detrave.

Ky sovran i kaltërsisë, pas kuvertës ngjitur,
Si i zënë ngushtë nga pamundësia e tij,
Mjerisht, krahët e bardhë, i lë të zvarritur,
Si një çift rremash të vozitura me ngadalësi.

K'tij udhëtari të plogët, ngordhalaq, qesharak!
Të shëmtuar, po dikur aq të bukur në k'të botë!
Një marinar sqepin me çibuk ia përflak,
Tjetri shpotinë i jep sakatit që s'fluturon dot.

Kështu është dhe poeti, si ky princ resh,
Që me harkëtarët qesh e mes stuhive vërtitet,
Po i mërguar në tokë, me thumbimin i rënë ndesh,
Ashtu penguar nga krahët e gjatë mezi çapitet.

**Albatrosët konsiderohen si shpendët më të hijshëm të deteve. Ata mund të fluturojnë për shumë orë pa i rrahur krahët. Megjithatë, në mot të qetë dhe pa erë, lodhen shpejt, për shkak të trupit të tyre të rëndë. Pikërisht, në momente të tilla, ata kërkojnë të pushojnë diku. Në tokë, ata janë të ngathët dhe shpesh pengohen me këmbët e tyre.*

Për pyetjet nga 11 deri në 14, rrethoni alternativën e saktë.

11.Në vargun *Ky sovran i kaltërsisë*, fjala sovran ka kuptimin:

1 pikë

- A) pushtues,
- B) mbret,
- C) shpend,
- D) mërgimtar.

MATURA SHTETËRORE

12. Në cilin prej vargjeve të mëposhtme është përdorur metafora? **1 pikë**

- A) Ky sovran i kaltërsisë.
- B) Kështu është dhe poeti, si ky princ resh.
- C) Një marinar sqepin me çibuk ia përflak.
- D) Si një çift rremash të vozitura me ngadalësi.

13. Në këtë poezi mizoria shfaqet përmes: **1 pikë**

- A) detarëve,
- B) thellësive të hidhura të detrave,
- C) albatrosit moskokëçarës,
- D) poetit që mezi ecën.

14. Kjo është një poezi ku vendosen përballë: **1 pikë**

- A) jeta dhe vdekja.
- B) e bukura dhe e shëmtuara.
- C) e vërteta dhe gënjeshtër.
- D) indiferenca dhe përkushtimi.

15. Çfarë simbolizon albatrosi në këtë poezi? Në cilin varg shfaqet thelbi i këtij simboli? **2 pikë**

16.

a) Cilat janë dy motivet qendrore të kësaj poezie? **2 pikë**

b) Analizoni një nga motivet e zbuluara më sipër. **1 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

17.

- a) Komentoni thelbin e krahasimit midis poetit dhe albatrosit (*strofa 4*). Mendimin tuaj ilustrojeni edhe me vargje ose detaje nga poezia. **2 pikë**

- b) Identifikoni një kontrast në këtë poezi dhe shpjegojeni atë. **2 pikë**

- c) Interpretoni se ku qëndron tragjizmi te albatrosi. **2 pikë**

PJESA III

Ismail Kadare

Kështjella (fragment)

Tursun pashai psherëtiu padashur. Gjithmonë kur kish qëndruar për herë të parë ballë për ballë kështjellave të rrethuara, që ai duhej t'i merrte, kish ndër frikën dhe turbullirën e së panjohurës me të cilën do të ndeshesh.

Kështjella që ngrihej këtë herë përpara tij, ishte e zyrtë. Kishte diçka të panatyrshme, pothuaj ogurzezë në formën e ndërtimit dhe në vendosjen e kullave. Këtë gjë të panatyrshme ai e kish vënë re qysh dy muaj më parë, kur specialistët, që merreshin me përgatitjet e fushatës, i paraqitën për herë të parë skicën e saj. Këtë skicë ai e kish mbajtur shumë herë mbi gjunjë, në orët e mbasdarkës, kur gjithë njerëzit flinin, atje në shtëpinë e tij të madhe në Brusë. Ai e dinte pothuajse përmendësh çdo detaj të saj, e, megjithatë, tani që më në fund e pa me sytë e tij kështjellën, pamja e saj i zgjoi trishtim në shpirt.

Ai mendoi se ç'arkitekt mund ta kishte projektuar këtë kështjellë dhe si qe e mundur që gjithçka në të ishte ters, duke filluar nga pozicioni i vendit ku ajo ngrihej, gjer te flamuri i saj, i vendosur në kullën e parë, një flamur i frikshëm i kuq, me një zog të zi me dy kokë në mes.

.....
Devetë që ishin shkarkuar, qenë ulur e po pushonin aty-këtu. Tani që mbrëmja kishte rënë plotësisht, siluetat e tyre dukeshin si male të vogla paqësore. Duke i parë ato, Tursun pashanë qysh tani e mori malli për Anadollin. Rrafshirat e tij të qeta e të përgjumura i kishte kujtuar vazhdimisht gjatë rrugës. I kishte kujtuar, sidomos, kur ushtria hyri në vendin e shqiptarëve dhe ai pa për herë të parë malet e tyre të frikshme. Kjo ndodhi një mëngjes herët. Ai ishte duke dremitur mbi kalë kur nga të gjitha anët u dëgjuan fjalët "dagllar, dagllar", të shqiptuara në një mënyrë të veçantë, gati-gati me frikë. Ai pa se si oficerët e tij ngrinin kokën lart, herë nga e majta, herë nga e djathta, për të shikuar më mirë. Edhe ai ngriti kokën dhe i vështroi malet për një kohë të gjatë. Asnjëherë nuk kishte parë male të tilla. Ato i ngjanin një ankthi të rëndë, që të shtyp e të shtyp vazhdimisht dhe nuk të lë të zgjohesh. Toka dhe gurët ishin vërvitur me një furi të tillë drejt qiellit sa që dukej se i kishin thyer të gjitha ligjet e natyrës. Allahu do të ketë qenë i nevrkosur kur krijoi këtë vend, kish menduar ai dhe për të qindtën herë gjatë marshimit e kishte menduar dilema nëse emërimi i tij si kryekomandant i kësaj fushate ishte rezultat i ndërhyrjes së miqve apo armiqve të tij.

Gjatë marshimit kish vënë re se pamja e maleve i bënte nevrkë pothuaj gjithë oficerët e tij. Në bisedat e tyre ata përherë e më tepër flitnin për fushën që duhej t'u dilte përpara, si një pus në shkretëtirë. Ushtria, që lëvizte ngadalë përpara, zvarriste tani bashkë me armët dhe pajimet edhe hijen e rëndë të maleve.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Për pyetjet nga 18 deri në 20 rrethoni alternativën e saktë.

18. Në fragmentin e mësipërm malet hyjnë në kontrast me: **1 pikë**

- A) armët,
- B) fushën,
- C) flamurin,
- D) kështjellën.

19. Kur pashai shikon flamurin, ai kupton se: **1 pikë**

- A) aty jeton një popull i lirë.
- B) ngjyra e kuqe simbolizon vdekjen.
- C) çdo komb përfaqësohet nga flamuri i tij.
- D) zogu në qendër të tij është një shqiponjë.

20.Në fjalinë: "*Kishte diçka të panatyrshme, pothuaj ogurzezë në formën e ndërtimit*", fjala ogurzezë ka kuptimin: **1 pikë**

- A) të akullt,
- B) të trishtë,
- C) të ngurosur,
- D) ndjellakeqe.

21.

a) Kur shikon për herë të parë kështjellën, pashait i bëjnë përshtypje shumë detaje rreth saj. Identifikoni dy prej tyre. **2 pikë**

b) Pse pamja e kështjellës i zgjon trishtim pashait? **1 pikë**

MATURA SHTETËRORE

- c) Cila është ndjesia që ai provon kur shikon malet? Si do ta shpjegonit ju atë? **2 pikë**

- 22.** Zbuloni në *paragrafin e katërt* dy mjete të stilistikës, me anë të të cilave pashai bën dallimin midis Anadollit dhe vendit të shqiptarëve. Analizoni njërin prej tyre. **3 pikë**

- 23.** Çfarë dyshimi e mundon pashain? Shpjegoni burimin e tij. **2 pikë**

- 24.** Zbërtheni anën funksionale të përdorimit të krahasimit në fjalinë e dhënë më poshtë: **1 pikë**

Në bisedat e tyre ata përherë e më tepër flitnin për fushën që duhej t'u dilte përpara, si një pus në shkretëtirë.

- 25.** Për çfarë mendoni se e paralajmëron lexuesin një përshkrim i tillë i mjedisit ku do të zhvillohet ngjarja? **1 pikë**

MATURA 2013

PJESA I

Kur bie shi

Derisa u shpërngula në jug të vendit, nuk dija ndonjë gjë të madhe për shiun. S'më shkonte në mendje se kishte shira të rrëmbyeshëm apo shumë të butë, shira të ftohtë, por edhe të vakët, shira që ia behnin vullshëm dhe shira që vinin ngadalë - ngadalë.

Nuk e dija se shirat mund të jenë të rrallë dhe, atëherë, njerëzit luten e presin, por edhe ardhja e tyre e tepërt nuk i duhet as njeriut e as tokës.

Nuk më kishte shkuar kurrë në mendje se qoftë edhe një shi i lehtë, që vjen në fund të një pasditeje të nxehtë ku temperaturat i kalojnë 38°C, mund ta djegë vërtet grurin, duke bërë që uji të avullojë nga kërcelli.

Jo rrallë, të ndodhur përballë trilleve të natyrës, njerëzit ngurrojnë të mbjellin sërish.

Nuk kisha parë se si shirat e gjatë e të ngadaltë derdheshin mbi të korrat, duke e përkulur grurin sa në një anë në tjetrën dhe, në fund, duke e shkatërruar atë përfundimisht.

Nga stuhitë e befta dhe të dhunshme të breshrit, isha e detyruar të ndërroja dërrasat e çatisë dy herë në pesë vjet. Një mot i tillë më kujtoi gjyshen, e cila kishte rrjeta teli në dritaret e anës perëndimore të shtëpisë së vet.

Nuk i kisha parë trillet e erës, shiut dhe të breshrit, gropat në një fushë gruri, që dukeshin si të ishin gjurmë të rënda këmbësh të një gjiganti që kishte shkelur në ato anë.

Nuk kisha parë breshër të binte nga qielli i kthjellët, blu. Nuk kisha provuar shi që vinte valë-valë dhe shtyhej përpara nga erëra të forta.

Nuk e kisha kuptuar se një shi i butë në pranverë ose në vjeshtë, një shi që bie drejt e poshtë, një shi që spërkat butësisht, është më shumë se një bekim. Është një mrekulli.

Njëherë, një fermer i vjetër na pyeti mua dhe tim shoq se sa kohë kishim në ato anë. "Pesë vjet,- iu përgjigjëm ne. - Epo, atëherë,- tha ai,- keni parë shi."

MATURA SHTETËRORE

Rrethoni alternativën e saktë për pyetjet nga 1 deri në 6.

1. Gjuha e përdorur në këtë tekst i përket ligjërit: **1 pikë**

- A) akademik,
- B) gazetaresk,
- C) letrar,
- D) bisedimor.

2. Autorja e këtij teksti i drejtohet më së shumti: **1 pikë**

- A) specialistëve që studiojnë kushtet e motit.
- B) fermerëve që merren me mbjelljen e grurit.
- C) banorëve që jetojnë në jug të vendit.
- D) punonjësve që matin sasinë vjetore të shirave në jug.

3. Cila nga alternativat e mëposhtme shpreh idenë kryesore të tekstit? **1 pikë**

- A) Në jug të vendit ka shumë gropa për shkak të erozionit.
- B) Në jug të vendit breshri shpesh kthehet në problem për banorët.
- C) Në jug të vendit duket sikur një gjigant ka shkelur fushat me grurë.
- D) Në jug të vendit shiu është i paparashikueshëm dhe njerëzit marrin masa mbrojtëse.

4. Në fjalinë: *Jo rrallë, të ndodhur përballë trilleve të natyrës, njerëzit ngurrojnë të mbjellin sërish; fjala **trillet** ka kuptimin:* **1 pikë**

- A) tekat,
- B) format,
- C) pasojat,
- D) përparësitë.

5. Leksiku i përdorur në paraqitjen e shiut mbizotërohet nga: **1 pikë**

- A) folje,
- B) emra,
- C) mbiemra,
- D) ndajfolje.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

6. Cili burim informacioni do të ishte më i besueshëm për një studim shkencor me titull: "Si ndikon moti në prodhimin e grurit"? **1 pikë**

- A) Një intervistë me një fermer.
- B) Një artikull gazete mbi bujqësinë.
- C) Parashikimi i motit në televizion.
- D) Një broshurë nga Drejtorja e Bujqësisë.

7.

a) Ç'lloj teksti është ky? Zbuloni dy karakteristika gjuhësore tipike të këtij lloji.

3 pikë

Lloji i tekstit: _____

Karakteristika I: _____

Karakteristika II: _____

b) Përcaktoni referentin në këtë tekst.

1 pikë

8. Identifikoni **shqisën kryesore**, me anën e së cilës, autorja ka sjellë ngjarjen.

Shpjegoni pse është kjo shqisa kryesore, duke e ilustruar përgjigjen me shembuj nga teksti.

3 pikë

9. Lexoni pjesën: *Nga stuhitë e befta dhe të dhunshme të breshrit ... deri te... shtyhej përpara nga erëra të forta.* Gjeni një shembull të përshkrimit objektiv dhe një shembull të përshkrimit subjektiv. **2 pikë**

Përshkrimi objektiv: _____

Përshkrimi subjektiv: _____

MATURA SHTETËRORE

- 10.** Në fjalinë e mëposhtme zbuloni dy figura të stilistikës (secila figurë të shoqërohet me ilustrimin përkatës). **2 pikë**

Nuk i kisha parë trillet e erës, shiut dhe të breshrit, gropat në një fushë gruri, që dukeshin si të ishin gjurmë të rënda këmbësh të një gjiganti që kishte shkelur në ato anë.

Figura I: _____

Figura II: _____

11.

- a) Cila kohë e foljes mbizotëron në paragrafin e parë? **1 pikë**

- b) Rishkruani fjalinë e mëposhtme në një këndvështrim objektiv. **1 pikë**

Nuk e kisha kuptuar se një shi i butë në pranverë ose në vjeshtë, një shi që bie drejt e poshtë, një shi që spërkat butësisht, është më shumë se një bekim.

- 12.** Ky tekst është shkruar në vetën e parë. Ç'të veçantë sjell kjo teknikë e rrëfimit? **1 pikë**

- 13.** Si do t'i interpretonit fjalët e fermerit në fund të tekstit? **2 pikë**

*Epo, atëherë, - tha ai, - **keni parë shi.***

PJESA II

Eskili

Prometeu

HERMESI

Me fjalët e tua kryeneçe, të hazdisura,
anijen tënde mbyt në det mjerimesh.

PROMETEU

Dëgjo këtu: s'e ndërroj mjerimin tim
me servilizmin tënd të ulët, kurrë!

HERMESI

Mos të pëlqen më tepër majë shkëmbit
të jesh mbërthyer, se sa lajmëtar i Zeusit?

PROMETEU

Më duket vetja më fisnik në pranga
në shkëmb mbërthyer se sa të jem lake¹
besnik i Zeusit.

.....

HERMESI

Po talle me mua si një fëmijë.

PROMETEU

A s'je ti më naiv se një fëmijë?
Vërtetë besoke se do t'i përgjigjem?
Dëgjo këtu: nuk ka ndëshkim, nuk ka dredhi
që Zeusi të më detyrojë mua

¹ Lake – shërbëtor.

t'i them ato që kanë për t'i ndodhur,
po s'më çliroi nga hekurat mizore.
Le të shkreprijnë flakët e rrufeve,
t'ushtojë me gjëmimet e nëndheshme,
le të pështjellë Tok' e Qiell së bashku
me borën pendëbardhë, le t'i tundë
e shembë të gjitha, por ta dish se kurrë
nuk më përkul dot! Kurrë s'do t'i them
se kush do ta përmbys' atë nga fronti.

HERMESI

Shih mos pendohesh për këto që thua!

PROMETEU

Çdo gjë e kam vendosur që më parë.

HERMESI

Të fola mjaft, por qenka krejt e kotë.
Nga lutjet s'preket zemër si e jotja.
Më kot rropatesh, ti nuk ke shpëtim!
Një trill i çmendur, qoftë dhe krenar,
dobi nuk sjell. Pra, bindju fjalës sime,
përndryshe nuk shpëton nga një stuhi
mjerimesh, që si një tallaz mizor
mbi ty do shembet dhe do të mbulojë,
ky shkëmb do bëhet cop' e thërrime,
kur Zeusi ta godasë me rrufe
dhe shkrepjima. Shkëmb' i zi në gji
të tij do ta varrosë trupin tënd.
Mjaft shekuj do kalojnë, pa të dalësh
prap' ti në dritë. Qeni fluturak
i Zeusit, zhgaba e pangopur kurrë
me gjak, një goxha copë do të shqyejë
me sqep nga trupi yt dhe dit' për ditë
do vijë si një mik krejt i pafuar
të të gërryejë e shqyejë ty mëlçinë!

Prandaj të them: mblidh mendjen! S'janë fjalë
këto prej mburraveci, jo, por dalin
nga goj' e vetë Zeusit të pavdekshëm.
Dhe Zeusi nuk gënjen. Çka thotë ai
vërtet do kryhet. Pra, mendohu mirë,
dhe më beso se je më i fituar
të jesh i urtë, sesa kokëfortë. (*Hermesi largohet*)

PROMETEU

S'qenkan fjalë boshe, se me të vërtetë
toka me rrëmet po trandet dhe dridhet.
Oshijnë bubullimat me gjëmime,
gjarpërojnë rrufetë me vetëtima,
gjuhë flake zigzag bëjnë nëpër qiell,
flakërimat verbojnë çdo gjë përçark!
Era pluhurin e rrugës ngre në ajër,
shqota ulërin, vërshëllen me lemeri!
Tok' e qiell e çdo gjë u përzje në botë!
Ja ç'furtunë dërgoi Zeusi i tërbuar
për të më ndëshkuar, për të më përkulur!
Shih, o mëmë Tokë,
e nderuar nënë,
Shih eter i shenjtë
që me dritë botën
skaj më skaj pështjell,
shihni si po vuaj
krejt pa pasur faj!

MATURA SHTETËRORE

Rrethoni alternativën e saktë për pyetjet nga 14 deri në 20.

14. Figura e Prometeut është marrë nga: **1 pikë**

- A) historia,
- B) mitologjia,
- C) baladat e vjetra,
- D) fantazia e autorit.

15. Gjatë gjithë këtij fragmenti, Prometeu shfaqet: **1 pikë**

- A) i qetë,
- B) i lëkundur,
- C) i vendosur,
- D) i mërzitur.

16. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur metafora? **1 pikë**

- A) Nuk shpëton nga një stuhi mjerimesh.
- B) Më duket vetja më fisnik në pranga.
- C) Po talle me mua si një fëmijë.
- D) Shih mos pendohesh për këto që thua!

17. Në vargun: *Më kot rropatesh, ti nuk ke shpëtim!* fjala *rropatesh* ka kuptimin: **1 pikë**

- A) bërtet,
- B) mërzitesh,
- C) përpiqesh,
- D) shqetësohesh.

18. Në cilin prej vargjeve të mëposhtme, Hermesi i jep një këshillë Prometeut? **1 pikë**

- A) Të fola mjaft, por qenka krejt e kotë.
- B) Nga lutjet s'preket zemër si e jotja.
- C) Një trill i çmendur, qoftë dhe krenar, / dobi nuk sjell.
- D) Më beso je më i fituar/ të jesh i urtë, sesa kokëfortë.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

19. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur një trajtë dialektore? **1 pikë**

- A) Toka me rrëmet po trandet dhe dridhet.
- B) Le të shkreprijnë flakët e rrufeve.
- C) Ky shkëmb do bëhet cop' e thërrime.
- D) Gjuhë flake zigzag bëjnë nëpër qiell.

20. Emri i Prometeut ka domethënien e: **1 pikë**

- A) lajmëtarit të perëndive.
- B) krijuesit të zjarrit.
- C) parathënësit të fatit.
- D) mbrojtësit të arteve.

21.

a) Tregoni shkakun e konfliktit në këtë fragment të tragjedisë. **1 pikë**

b) Cila është, sipas Prometeut, një karakteristikë e Hermesit? Identifikoni në fjalët që ai i thotë Hermesit, një çift antonimik që jep edhe thelbin e kontrastit midis tyre. **2 pikë**

c) Zbuloni një tipar të Prometeut që e bën atë një hero tragjik. **1 pikë**

22. Përcaktoni në vargjet e mëposhtme figurën stilistike që krijohet nga përdorimi i foljeve. Cili është funksioni artistik i këtij përdorimi? **2 pikë**

*...Le të shkreprijnë flakët e rrufeve,
t'ushtojë me gjëmimet e nëndheshme,
le të pështjellë Tok' e Qiell së bashku
me borën pendëbardhë, le t'i tundë
e shembë të gjitha, ...*

MATURA SHKETËRORE

23. Ç'kanë të përbashkët fjalët pendëbardhë dhe kokëfortë nga ana stilistike dhe fjalëformuese (mënyra e ndërtimit)? **2 pikë**

Stilistike: _____

Fjalëformuese: _____

24.

a) Cila është atmosfera që sundon në fund të këtij fragmenti? Përshkruajeni atë, duke theksuar edhe disa nga fjalët kyç që japin thelbin e saj. **3 pikë**

b) Edhe pse Prometeu është i lidhur dhe i torturuar, mendoni se një pjesë e tij mbetet e lirë? Argumentoni mendimin tuaj. **2 pikë**

MATURA 2014

PJESA I

Gjumi dhe shëndeti

Një ndeshje midis klasave në shkollë, studimi disa javor për një provim në kimi, larja e pjatave në shtëpi, lista e punëve dhe e veprimtarive të përditshme që drejtojnë jetën e një njeriu, është e pafund. Si mundet një person t'ia dalë t'i organizojë? Shpesh njerëzit ose qëndrojnë zgjuar deri vonë, ose ngrihen mjaft shpejt në mëngjes dhe humbasin gjumin, pa u shqetësuar shumë për këtë. Megjithatë, studimet tregojnë se kjo mund të jetë një zgjedhje e dëmshme. Nëse njerëzit nuk flenë çdo natë, ata e dëmtojnë seriozisht organizmin e tyre.

Së pari, mungesa e gjumit dëmton sistemin imunitar tek njeriu. Trupi i njeriut nxjerr disa hormone dhe kimikate vetëm gjatë gjumit dhe sistemi imunitar ka nevojë që këto kimikate të funksionojnë ashtu si duhet. Për shembull, një psikiatër studioi sistemin imunitar të 23 njerëzve, të cilët kishin fjetur gjysmë herë më pak se zakonisht. Sipas tij, veprimtaria e "qelizave natyrale vrasëse", të cilat luftojnë infeksionet, ra me 30%. Gjumi është karburanti që e mban sistemin imunitar në punë, me një kapacitet 100% dhe njerëzit që e injorojnë këtë, ka shumë gjasa të jenë më të prekshëm nga viruset, me të cilat ata ekspozohen çdo ditë.

Një mungesë e vazhdueshme e gjumit, mund të jetë përgjegjëse edhe për të shkaktuar disa sëmundje. Për të provuar këtë teori, shtatëdhjetë e dy infermiere morën pjesë në një studim. Ato që fjetën gjashtë orë natën, patën 18% rrezik ndaj sëmundjeve të zemrës, krahasuar me ato që fjetën tetë orë. Pjesëmarrësit që fjetën pesë ose më pak orë gjatë natës, patën një rrezik 37 herë më të lartë ndaj sëmundjeve të zemrës. Studiuesit arritën në përfundimin se, ulja e sasisë së gjumit mund të shkaktojë një presion të lartë të gjakut ose hipertension, i cili dëmton enët e gjakut dhe shkakton probleme si, rrahje të forta të zemrës dhe sëmundje të saj.

Gjumi i pamjaftueshëm gjithashtu ndikon në funksionimin e trurit. Truri ka nevojë për "molekula energjie" të reja, për të zëvendësuar ato që janë përdorur gjatë ditës. Këto molekula energjie prodhohen gjatë gjumit dhe kur nuk zëvendësohen si duhet, trupi automatikisht fillon të ndihet i përgjumur. Një studiues thotë: "Kur kjo ndodh, gjykimi juaj bie, jeni pa gjallëri dhe koha e reagimit ulet ndjeshëm." Si pasojë, një tru i lodhur rrit rrezikun për aksidente serioze, veçanërisht

në një punë ku përgatitja fizike ka rëndësi të madhe, për shembull, ndërtimi. T'i japësh makinës kur je i lodhur, është jashtëzakonisht e rrezikshme.

Një gjumë i pamjaftueshëm dëmton edhe kujtesën. Studiuesit testuan aftësinë e një grupi për të mbajtur mend disa fjalë të vështira dhe aftësitë e këtij grupi u rritën ndjeshëm pas një nate me gjumë të mjaftueshëm. Një natë me gjumin e duhur është e rëndësishme edhe për studentët. Pushimi e ndihmon shumë trurin e tyre për të përpunuar materialin e ri mësimor dhe për ta mbajtur mend atë. Në fakt, studimet tregojnë se studentët që flenë më gjatë, arrijnë rezultate më të mira.

Përfundimisht, mungesa e gjumit shkakton një nivel të rrezikshëm të hormonit të stresit, kortisolit. Normalisht, ky hormon e përgatit trupin për aktivitet dhe në mbrëmje, kur ai nuk nevojitet më, trupi e ndalon prodhimin e tij. Por, kur njerëzit nuk flenë sa duhet, nivelet e kortisolit në gjak ngrihen. Më pas, ky hormon ndalon riparimin dhe rritjen e indit të muskujve. Sipas një reviste shkencore, niveli i lartë i kortisolit, gjithashtu "shkatërron qelizat e trurit, shkakton tkurrjen e hipokampusit, një zonë e rëndësishme e trurit që rregullon të nxënit". Çdo njeri është i programuar nga ana biologjike: të gjithë kanë nevojë të flenë, në mënyrë që hormonet e tyre të funksionojnë si duhet.

Shpesh ne sakrifikojmë gjumin për shkak të veprimtarive të shumta dhe detyrimeve që kemi. Studimet tregojnë se, kufizimi i gjumit nuk është zgjidhja e duhur. Një gjumë i mirë gjatë natës, na sjell dobi të mëdha: një sistem imunitar të fortë, një trup të shëndetshëm dhe një tru që funksionon si duhet.

MATURA SHETËRORE

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

1. Teksti i mësipërm është i llojit: **1 pikë**
- A) rrëfimitar,
 - B) udhëzues,
 - C) përshkrues,
 - D) argumentues.
2. Qëllimi kryesor i këtij teksti është: **1 pikë**
- A) t'i këshillojë njerëzit të ulin stresin në punë.
 - B) t'i informojë të rinjtë rreth sistemit imunitar të njeriut.
 - C) t'i bindë njerëzit mbi rëndësinë e një gjumi të mjaftueshëm.
 - D) të japë informacion për fazat nëpër të cilat kalon gjumi te njeriu.
3. Cilës pyetje i përgjigjet paragrafi i parë? **1 pikë**
- A) A është gjumi i rëndësishëm për të patur një fizik të mirë?
 - B) Si mund t'i përmirësojnë njerëzit zakonet e tyre të të fjeturit?
 - C) Cila është veprimtaria ditore më e kërkuar?
 - D) A duhet të ngrihen njerëzit herët në mëngjes?
4. Cila nga alternativat e mëposhtme do të ishte titulli më i mirë për paragrafin e parë? **1 pikë**
- A) Ulja e stresit
 - B) Koha e gjumit.
 - C) Rritja e rrezikut.
 - D) Vendimmarrja në punë.
5. Njerëzit që **flenë pak**, janë të prekshëm nga viruset, sepse: **1 pikë**
- A) ata kanë nivel të lartë të kortisolit.
 - B) mbrojtja e tyre natyrale dobësohet.
 - C) qelizat e tyre të trurit dëmtohen.
 - D) ata kanë nivel të ulët të molekulave energjike.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

6. Cilin nga burimet e mëposhtme duhet të shikojë lexuesi për të vlerësuar ndikimin e lodhjes kur i jep makinës? **1 pikë**

- A) Një artikull rreth karakteristikave të sigurisë tek automjeti.
- B) Një raport vjetor mbi shkaqet e aksidenteve me makinë.
- C) Një raport për blerësit mbi sigurinë e automjetit.
- D) Një artikull për komoditetin e brendshëm që kanë automjetet në ditët e sotme.

7. Në fund të tekstit, lexuesi arrin në përfundimin se, një gjumë i mjaftueshëm:

- A) ka një ndikim të vogël në sistemin imunitar të trupit. **1 pikë**
- B) shkakton tkurrje të disa zonave të trurit.
- C) ul nivelin e kortisolit në gjakun e njeriut.
- D) ngadalëson rritjen e indit të muskujve.

8. Gjeni **tezën** që shtron autori dhe dy argumente në mbështetje të saj. **3 pikë**

Teza: _____

Argumenti 1: _____

Argumenti 2: _____

9. Identifikoni dy arsye, për shkak të të cilave njerëzit sakrifikojnë gjumin. **2 pikë**

Arsyeja 1: _____

Arsyeja 2: _____

10. Zbuloni në paragrafin e parë raportin **shkak-pasojë**. Shkruani shkakun dhe pasojën, duke treguar me ç'mjet gjuhësor realizohet lidhja midis tyre. **3 pikë**

Shkaku: _____

Pasoja: _____

Mjeti gjuhësor: _____

MATURA SHTETËRORE

11. Cilat janë dy nga teknikat e argumentimit të përdorura nga autori? **2 pikë**

12.

a) Fjalja e parë e paragrafëve 2, 3, 4, 5 dhe 6 është shkruar me shkronja të zeza.

Cila është lidhja midis këtyre fjalive dhe pjesës tjetër të paragrafit përkatës?

1 pikë

b) Përgjatë tekstit, autori ka përdorur disa fjalë ose fjali që i ka futur midis thonjzave. Cila është arsyeja e këtij përdorimi? **1 pikë**

13. Nga se ndryshon paragrafi i fundit nga pjesa tjetër e tekstit? Shpjegoni përgjigjen tuaj. **2 pikë**

PJESA II

Ismail Kadare

Rënia e dëborës

Ty ndoshta nuk të shkoi ndërmend
Se qielli rastësisht s'u mbyll
Se kjo dëborë që shtroi kudo
Në të vërtetë ra për ty.

U projektua çdo kristal
I saj në qiell të madh diku
Dhe nuk pushoi së rëni ajo
Gjersa i gjeti flokët e tu.

Që ti ta shkundje me një gjest
Shkujdesshëm krejt e gjithë gëzim
Një natë të tërë qielli punoi
Me ernat në bashkëpunim.

Dhe në mëngjes i zbehtë ai
I ftohtë hapej madhërisht
Ndërsa shëtisnim ne të dy
Nën altruizmin e tij të hirtë.

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

14. Poezia e mësipërme i përket llojit të lirikës:

1 pikë

- A) filozofike,
- B) intime,
- C) së peizazhit,
- D) shoqërore.

MATURA SHTETËRORE

15. Në poezi përdoret shpesh rendi i përmbysur i gjymtyrëve. Ky përdorim bën që të përftohet figura e: **1 pikë**

- A) inversionit,
- B) metaforës,
- C) shkallëzimit,
- D) enumeracionit.

16. Në këtë poezi ndërthuren: **1 pikë**

- A) bota fantastike me botën reale.
- B) bota reale me botën e ëndrrës.
- C) bota natyrore me botën njerëzore.
- D) bota racionale me botën emocionale.

17. Në cilën prej alternativave të mëposhtme kemi një epitete metaforik? **1 pikë**

- A) Dhe nuk pushoi së rëni ajo.
- B) Nën altruizmin e tij të hirtë.
- C) Një natë të tërë qielli punoi.
- D) Gjersa i gjeti flokët e tu.

18. Në këtë poezi qielli shfaqet: **1 pikë**

- A) mizor,
- B) indiferent,
- C) i zhurmshëm,
- D) ndihmues.

19. Kjo është një poezi lirike, sepse: **1 pikë**

- A) përshkruan një natyrë dimri.
- B) rrëfen një ngjarje serioze.
- C) shpreh emocionet e poetit.
- D) organizohet mbi vargje që rimojnë.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

20. Çfarë sfondi krijohet në këtë poezi? Cila është ngjyra që shfaqet në përfytyrimin tuaj? **2 pikë**

21. Shikoni me kujdes emrin *emat*. Shumësi i kësaj fjale është një thyerje e standardit të gjuhës shqipe. Shkruani shumësin e rregullt dhe shpjegoni arsyen stilistike të kësaj forme të zgjedhur nga poeti. **2 pikë**

Shumësi: _____

Shpjegimi: _____

22. Lexoni me kujdes strofën e dytë. Cila është fjala që krijon efekt të menjëhershëm? Zbërtheni simbolikën që ajo mbart në kontekstin e dhënë. **3 pikë**

23.

- a) Në këtë poezi qielli shfaqet si aleat i bukurisë së vajzës. Shpjegojeni këtë perceptim, duke e ilustruar me shembuj nga poezia. **2 pikë**

- b) Cili është detaji i vetëm fizik që poeti thekson te vajza? Si do ta interpretonit këtë zgjedhje nga ana tije? **3 pikë**

24. A mendoni se kjo është një poezi ku shfaqet kontrasti? Argumentoni mendimin tuaj me shembuj nga poezia. **3 pikë**

MATURA 2015

PJESA I

Liria e fjalës

Më lejoni ta filloj këtë forum, duke marrë në konsideratë dy këndvështrime të ndryshme, në lidhje me lirinë e fjalës. Diskutimi ynë ka marrë formë nga tensioni që shkaktojnë këto pikëpamje.

Këndvështrimi i parë: universiteti ynë duhet ta kufizojë lirinë e fjalës, pasi ne besojmë shumë se idetë kanë rëndësi. Fjalët përcjellin ide dhe idetë mund të jenë të rrezikshme. Ato mund të sjellin përçarje dhe të përmbysin situatën ekzistuese. Idetë mund të sjellin reagime negative, të mbartin urrejtje, të lëndojnë njerëzit dhe të shkaktojnë trauma të mëdha.

Idetë janë të fuqishme. Studentët janë në një fazë formuese të jetës së tyre, prandaj ata mund të mos i kuptojnë mirë disa ide dhe të manipulohen lehtësisht. Në rast se ju besoni në fuqinë e ideve, atëherë duhet të shikoni me kujdes se si ato shpallen në universitetin tonë. Më konkretisht, ne duhet të marrim në konsideratë faktin se një universitet i përkushtuar ndaj fjalës së lirë, në disa situata, mund të duket sikur mbështet një platformë që prodhon gënjeshtër, urrejtje, shtrembërime dhe gabime. Për pasojë, krijohet përshtypja sikur fjalimet ofenduese legjitimohen kur ndodhin në terrenin e një institucioni kërkimor ose kur shqiptohen nga pjesëtarët e tij.

Tani, le të marrim në konsideratë pikëpamjen e dytë se universiteti duhet t'i përkushtohet lirisë së fjalës. Universitetet janë ngritur mbi besimin e patundur që lejon lirinë dhe autonominë më të madhe intelektuale. Gjithashtu, universitetet përkrahin idenë se e vërteta arrihet vetëm me dialog. Kufizimi i dialogut, paraprakisht, tregon një mungesë besimi tek kapacitetet e individit për të zbuluar të vërtetën. Universiteti shërben si katalizatori i konfliktit dhe, sigurisht që do të ketë konflikte. Debati aktiv dhe diskutimi i ideve është në fakt shenja e një komuniteti të shëndetshëm intelektual.

Dy këndvështrime - të dyja të rëndësishme. Për të dyja mund të thuhet argumente shumë të mira.

Një nga çështjet më të rëndësishme, dhe njëherazi më e vështira për universitetin, është përcaktimi i asaj që mund të quhet *fjalim i përshtatshëm*. Ne e ndiejmë këtë tension si komunitet. Në universitetin tonë, vendimi ka qenë për të krijuar një sistem që mbështet forumet publike dhe shprehjen e lirë. Ne kemi zgjedhur të lejojmë një numër fjalimesh që kufizohen vetëm në rrethana të veçanta. Kjo ndodh sepse ne besojmë në tri gjëra: vlerën e kërkimit intelektual, integritetin e

MATURA SHTETËRORE

individëve dhe aftësinë e anëtarëve të këtij komuniteti universitar për të menduar në mënyrë racionale dhe për të punuar fort drejt së vërtetës. Ne nuk mundemi që njëkohësisht t'i përkushtohemi përparimit intelektual dhe, në të njëjtën kohë, të vendosim kufizime në atë që mendohet apo diskutohet.

Politika jonë e lirisë së fjalës ka nisur 14 vjet më parë. Ajo nuk i pengon fjalimet duke u bazuar në personin që i prezanton apo nisur nga përmbajtja e tyre dhe, as ka ngritur ndonjë mekanizëm përmes të cilit institucioni vendos se kush duhet të flasë dhe kush jo. Nuk jemi ne, ata që i miratojnë fjalimet që vijnë këtu. Kjo është diçka që dihet dhe është pranuar gjerësisht.

Në të njëjtën kohë, ne e dimë se fjala e lirë mund të shkaktojë dhimbje. Debat i hapur mund të jetë i vështirë dhe i papërshtatshëm. Në disa raste, edhe mund të abuzohet me besimin tonë.

Ka një element tragjik në çdo kërkim të së vërtetës. Nuk mund ta injorojmë dimensionin tragjik të jetës sonë. Por, sinqerisht, besojmë se duke lejuar një numër të madh diskutimesh, pavarësisht se disa mund të jenë jopopullore dhe disa shqetësuese, ne i shërbejmë zbulimit të së vërtetës.

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

1. Teksti i mësipërm klasifikohet si: **1 pikë**

- A) argumentues,
- B) shpjegues,
- C) udhëzues,
- D) rrëfyes.

2. Cila nga alternativat e mëposhtme është **teza** e këtij fjalimi? **1 pikë**

- A) Më lejoni ta filloj këtë forum, duke marrë në konsideratë dy këndvështrime të ndryshme, në lidhje me lirinë e fjalës.
- B) Më konkretisht, ne duhet të marrim në konsideratë faktin se një universitet i përkushtuar ndaj fjalës së lirë, në disa situata, mund të duket sikur mbështet një platformë që prodhon gënjeshtër, urretje, shtrembërime dhe gabime.
- C) Universitetet janë ngritur mbi besimin e patundur që lejon lirinë dhe autonominë më të madhe intelektuale.
- D) Ka një element tragjik në çdo kërkim të së vërtetës.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

3. Në ç'përfundim arrin lexuesi duke lexuar fjalinë "*Politika jonë e lirisë së fjalës ka nisur 14 vjet më parë*"? **1 pikë**

- A) Ka pasur shumë folës jopopullorë në këtë universitet.
- B) Universiteti ka kufizuar për shumë vjet lirinë e fjalës dhe të shprehjes.
- C) Vetëm kohët e fundit universiteti i ka lejuar studentët të shprehen.
- D) Fjala e lirë ka qenë për një kohë të gjatë shqetësim në universitet.

4. Cilën nga fjalitë e mëposhtme mund të shtonte autori në paragrafin IV për të mbështetur më mirë argumentin e tij se "e vërteta arrihet me dialog"? **1 pikë**

- A) Duke marrë në konsideratë mendimet e të tjerëve, njeriu bëhet i vetëdijshëm mbi anët e forta dhe të dobëta të pikëpamjeve të tjetrit për çështje të caktuara.
- B) Mënyra më e mirë për të zbuluar se ç'besojnë të tjerët është duke i pyetur ata drejtpërdrejt për mendimet dhe shqetësimet e tyre.
- C) Megjithatë, e vërteta nuk ka qenë kurrë diçka, të cilën mund ta theksojmë me bindje të plotë.
- D) E vërteta, siç thonë ata, është një nga produktet më të vlefshme dhe më të rralla, që mund të gjendet në një botë si e jona.

5. Pse ky fjalim do të ishte më efektiv po ta dëgjonim se sa ta lexonim atë në internet? **1 pikë**

- A) Fjalimi do ta lejonte folësin të arrinte një audiencë shumë më të gjerë.
- B) Audienca mund të provojë emocionet e fjalëve të shprehura.
- C) Studentët dhe stafi mund të largohen nëse nuk janë dakord me atë që thuhet.
- D) Mbështetësit e fjalës dhe të shprehjes së lirë mund të gëzojnë pamasë.

MATURA SHTETËRORE

6. Lexoni paragrafin e mëposhtëm, shkruar nga një student i këtij universiteti. Si do ta përcaktoni *tonin* e fjalimit në krahasim me atë të këtij paragrafi? **1 pikë**

Politika e universitetit është plotësisht e papërgjegjshme. Idetë e reja dhe të çmendura sjellin konflikte dhe konfuzion. Të gjithë duhet ta dinë këtë! Çfarë ndodh kur nxënësit fillojnë të mendojnë gjëra që janë të gabuara?

- A) Toni i fjalimit është i përmbajtur; toni i paragrafit është i pakënaqur.
B) Toni i fjalimit është i ftohtë; toni i paragrafit është sarkastik.
C) Toni i fjalimit është emocional; toni i paragrafit është i mërzitshëm.
D) Të dy tonet janë të njëjta.
7. Cili nga imazhet e mëposhtme do ta përforconte më mirë pikëpamjen e universitetit për lirinë e fjalës dhe të shprehjes? **1 pikë**
- A) Një folës që tallet nga auditori i universitetit.
B) Një pedagog që gris posterat nga stenda e studentëve.
C) Një grup studentësh që bërtasin në sallën e ngrënies.
D) Një student që shpërndan fletushka në godinat studentore.

8.

- a) Pse autori mendon se duhet mbështetur fjala e lirë? Shkruani argumentin kryesor që ai përdor në gjykimin e tij. **2 pikë**

- b) Është ky një argument objektiv apo subjektiv? Pse? **2 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

9. Interpretoni fjalinë “*Ka një element tragjik në çdo kërkim të së vërtetës*”. Çfarë të veçante fiton paragrafi përmbyllës në këtë kontekst? **3 pikë**

10. Gjeni në tekst dy mbiemra që cilësojnë idetë. **2 pikë**

11. Identifikoni dy nga pasojat negative që sjell ushtrimi i lirisë së shprehjes në universitet, të prezantuara në kundërtëzë. **2 pikë**

12. Pse autori mendon se me besimin që mund t'u japim të tjerëve edhe mund të abuzohet? Argumentoni mendimin tuaj me ilustrime nga pjesa. **3 pikë**

PJESA II

Markez

Njëqind vjet vetmi (fragment)

Duke i shtrënguar për dore të dy djemtë e vet që të mos i humbte mes asaj rrëmuje të tmerrshme, duke u përplasur pas marifetçinjve me dhëmbë floriri dhe pas magjistarësh të tjerë që shfaqeshin secili me nga gjashtë krahë të përdredhur dhe, duke iu marrë fryma nga përzierja e erës së djersës me kundërmimin e vajrave aromatike që shpërndante turma, Hose Arkadio Buendia kërkonte gjithandej, me sy të çakërritur si një i ndërkrjer, mikun e tij Melhiades, që ky t'ia zbulonte të fshehtat e pakufishme të atij spektakli të mrekullueshëm. Ai iu drejtua shumë arixhinjve, por ata nuk ia kuptonin gjuhën. Më së fundi arriti tek sheshi, ku Melhiadesi e ngrinte zakonisht çadrën e vet, dhe aty gjeti një arixhi armen fjalëpakë, por që i foli spanjisht për t'i ofruar një lloj shurupi që të bënte të padukshëm. Ai sapo kishte zbrazur me fund një kupë me atë lëngun në ngjyrën e qelbarit, kur Hose Arkadio Buendia, duke e hapur rrugën me bërryla mes turmës që po e ndiqte e nemitur atë veprim, arriti ta pyeste për Melhiadesin. Arixhiu e përfshiu me një vështrim misterioz dhe sakaq u shndërrua i tëri në një pellg zifti, të qelbur dhe avullues, mbi të cilin u ngrit pezull jehona e përgjigjes së tij.

- Melhiadesi ka vdekur.

I pikëlluar nga mandata, Hose Arkadio Buendia ngriu në vend, duke u munduar të mposhte dhimbjen, derisa turma e kureshtarëve u shpërnda për të ndjekur një tjetër mrekulli dhe pellgu i armenit fjalëpakë u avullua në hiç. Ca më vonë, disa arixhinj të tjerë ia vërtetuan lajmin e kobshëm që Melhiadesi kishte vdekur në ranishtat e Singapurit nga një palë ethe të forta dhe që kufoma e tij ishte lëshuar në vendin më të thellë të Gjirit të Javës.

Për të dy djemtë ky lajm ishte krejt i papërfillshëm; ata mezi prisnin që babai t'i merrte tani dhe t'i çonte tek zbulimi aq i lëvduar i Dijetarëve të Memfisit. Siç ishte shpallur, ky zbulim qe ekspozuar në një çadër, e cila, në lashtësi, pat qenë gjoja e mbretit Solomon. Fëmijët këmbëngulën aq shumë, saqë Hose Arkadio Buendia e zgjidhi më së fundi qesen, duke paguar të tridhjetë *reale*² e hyrjes dhe duke i shpënë në mesin e çadrës, ku një vigan me gjoks leshtor e me kokë të rruar, me një alamet unaze bakri të shkuar tejpertej hundës e me vargonj të rëndë në kyçet e këmbëve, bënte roje pranë një sënduku piratësh. Sapo vigani e ngriti kapakun, nga sënduku vërshoi një gulç i acartë. Brenda ndodhej vetëm një kallëp shumë i madh e i tejdukshëm, i përshkuar nga damarë të panumërt, brenda të cilëve drita e mugët

² Reale - lloj monedhe

përthyej në qindra yje të larmishëm. Duke e ditur fort mirë që djemtë po prisnin prej tij një përgjigje të menjëhershme, Hose Arkadio Buendia, në hutim e sipër, arriti të murmuriste vetëm këto fjalë:

- Ky është më i madhi diamant i botës!
- Jo, - e ndreçi arixhiu. – Ky është një akull!

Hose Arkadio Buendia, i turbulluar, e zgjati dorën drejt kallëpit të akullit, por vigani ia shtyu mënjane.

- Për ta prekur, duhet të tundësh edhe pesë *reales* të tjera! – i tha.

Hose Arkadio Buendia ia pagoi. Pastaj vuri dorën mbi akull dhe e la disa minuta përmbi të, teksa zemra i rrihte si çekan nga frika dhe nga gëzimi që ndjeu gjatë prekjes së atij misteri. Pa ditur çfarë të thoshte, pagoi edhe dhjetë *reales* të tjera, që edhe djemtë të njiheshin me atë përvojë të mrekullueshme. Hose Arkadioja, djali më i madh, kundërshtoi ta prekte akullin, kurse vogëlushi Aureliano bëri një hap para, vuri dorën mbi të dhe e tërhoqi menjëherë.

- Po zien! – thirri ai i trembur.

Porse i ati nuk ia vari fare. I dehur nga ajo provë e qartë e mrekullisë, ai harroi në atë çast dështimet e sipërmarrjeve të tij të krisura si dhe kufomën e Melhiadesit, që u ishte hedhur përbindëshave të detit për t'ua shuar babëzinë e tyre të madhe. Pagoi edhe pesë *reales* të tjera dhe, duke e mbështetur dorën përmbi akull, bërtiti, a thua se po betohej mbi Dhjatën e shenjtë:

- Kjo është shpikja më e madhe e botës!

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

13. Ç'cilësi të Hose Arkadio Buendias zbulojmë në këtë fragment?

1 pikë

- A) Krenarinë,
- B) Bujarinë,
- C) Kuriozitetin,
- D) Përkushtimin.

14. Pse Hose Arkadio e ka të vështirë në fillim të mesojë për fatin e Melhiadesit?

1 pikë

- A) Melhiadesin nuk e njeh askush.
- B) Melhiadesi i takon një fisi tjetër arixhinjsh.
- C) Arixhinjtë nuk e kuptojnë gjuhën e tij.
- D) Arixhinjve iu vjen keq t'i japin lajmin e dhimbshëm.

MATURA SHTETËRORE

15. Si reagojnë dy djemtë e Hose Arkadios ndaj vdekjes së Melhiadesit? **1 pikë**

- A) Trishtohen ashtu si babai i tyre.
- B) Janë indiferentë nga ajo që marrin vesh.
- C) Frikësohen nga ideja e vdekjes së një njeriu.
- D) Nuk e kuptojnë se çfarë do të thotë vdekje.

16. Kur autori thotë: “*I pikëlluar nga mandata, Hose Arkadio Buendia ngriu në vend*”, nënkupton se ai: **1 pikë**

- A) mbeti i shtangur pa fjalë.
- B) filloi të qante me të madhe.
- C) humbi ndjenjat nga tronditja.
- D) u nervozua nga lajmi i keq.

17. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur gjuha e figurshme? **1 pikë**

- A) Hose Arkadio Buendia e zgjati dorën drejt kallëpit të akullit.
- B) I foli spanjisht për t'i ofruar një lloj shurupi që të bënte të padukshëm.
- C) Vogëlushi Aureliano bëri një hap para, vuri dorën mbi të dhe e tërhoqi menjëherë.
- D) Sapo vigani e ngriti kapakun, nga sënduku vërshoi një gulç i acartë.

18. Nisur nga konteksti, në fjalinë “*Duke e hapur rrugën me bërryla mes turmës që po e ndiqte e nemitur atë veprim*”, fjala e nemitur ka kuptimin: **1 pikë**

- A) e shqetësuar,
- B) e habitur,
- C) e ekzaltuar,
- D) e interesuar.

19. Ç'marrëdhënie ka pasur mes Hose Arkadio Buendias dhe Melhiadesit? Shpjegoni përgjigjen tuaj duke e ilustruar me një shembull nga fragmenti.

3 pikë

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- 20.** Përse autori ka ndërthurur realen me fantastiken? Identifikoni dy momente të tilla në fragment. **3 pikë**

- 21.** Zbuloni dy karakteristika të stilit të Markezit në këtë fragment. **2 pikë**

22.

- a) Çfarë nënkupton ardhja e arixhinjve në Makondo (vendi ku ndodh ngjarja)? **1 pikë**

- b) A mendoni se arixhinjtë janë ndryshe nga banorët e këtij vendi? Argumentoni mendimin tuaj. **2 pikë**

- 23.** Çfarë ka të veçantë në faktin se akulli konsiderohet nga Hose Arkadio Buendia si shpikja më e madhe e botës? Ç'kuptojmë për vendin apo kulturën e tij nëpërmjet kësaj të veçante? **2 pikë**

- 24.** Analizoni mënyrën e rrëfimit në këtë fragment, veçanërisht pozicionin e narratorit. **2 pikë**

MATURA 2016

PJESA I

Prindërit dhe shkolla

Shpesh mësuesit fajësohen kur nxënësit nuk kanë rezultate të larta, për mungesën e pjesëmarrjes në veprimtaritë shkencore, për punën e tyre të dobët dhe mënyrën se si mësojnë. Megjithatë, kohët e fundit, vëmendja është zhvendosur për ta gjetur gjetkë fajin. Këta janë prindërit e atyre nxënësve, të cilët marrin nota të dobëta ose sillen keq në klasë apo në ambientet e shkollës. Ideja mund të duket qesharake, por shumë qytete, anembanë vendit, po ndërtojnë politika, të cilat i bëjnë prindërit përgjegjës për arritjet e fëmijëve të tyre në shkollë. Kjo është një ide e keqe dhe rajoni ku është shkolla jonë, nuk duhet ta ndjekë atë për tri arsye: ajo e largon përgjegjësinë nga nxënësi, dëmton marrëdhëniet midis shkollës dhe familjes dhe është thuajse e pamundur për t'u zbatuar.

Nuk ka asgjë të keqe që prindërit të kontrollojnë nëse fëmijët i kanë bërë detyrat e shtëpisë. Gjithashtu, është mirë që ata t'i ndihmojnë fëmijët kur kanë nevojë. Prindërit mund të kontrollojnë se sa kohë kalojnë fëmijët duke parë televizor, duke dërguar mesazhe apo luajtur në kompjuter. Megjithatë, kur fëmijët kalojnë në adoleshencë, është koha që ata të marrin përgjegjësi për veten e tyre. Nëse prindërit vazhdojnë t'i kontrollojnë detyrat e tyre me idenë e ndëshkimit, atëherë kjo padyshim do t'u shkaktoje adoleshentëve shumë vuajtje. Ata kurrë nuk do të mësojnë të përmbushin afatet apo të përballen me pasojat që vijnë, nëse nuk kanë realizuar detyrimet që kanë. A nuk do të shqetësoheshit shumë nëse në vend që të ndëshkoheshit ju kur nuk bëni detyrat e shkollës, të ndëshkoheshin prindërit tuaj? Kur adoleshentët përfundojnë shkollën e mesme, një pjesë e tyre vazhdon shkollën e lartë, një pjesë shkon në punë dhe disa në ushtri. Është e pamundur që profesorët, shefat apo komandantët e tyre të pranojnë mungesën e përgjegjësive personale apo një etikë të dobët pune.

Suksesi i një nxënësi në shkollë, në një pjesë të madhe, varet nga marrëdhëniet e shëndetshme midis tij dhe shkollës. Prandaj është shumë i rëndësishëm një respekt dhe komunikim i mirë midis stafit të shkollës, nxënësve dhe prindërve. Për këtë qëllim, shkolla gjithnjë e ka nxitur përfshirjen e prindërve. Virtualisht, gjithkush e kupton se sa e rëndësishme është përfshirja e prindërve. Shkollat, që kanë arritur rezultate të larta në provimet kombëtare, kanë nxënës me prindër jashtëzakonisht të përfshirë. Kjo ka bërë që disa rajone të pyesin: "Pse të mos u kërkojmë prindërve të shpenzojnë vullnetarisht kohë në shkollë dhe t'i penalizojmë ata që nuk përfshihen?" Megjithatë, nëse shkollat penalizojnë prindërit

MATURA SHTETËRORE

për dështimet e fëmijëve, qofshin këto akademike apo të sjelljes, atëherë të dyja palët mund të kthehen lehtësisht në kundërshtarë të njëri-tjetrit. Nëse kjo ndodh, ata që do të vuajnë, janë nxënësit.

Edhe nëse sistemi që i bën prindërit të përgjegjshëm, duket i arsyeshëm, prapë nuk është shumë e qartë se cilat janë pasojat që ata duhet të kenë, nëse nuk marrin përgjegjësitë e duhura. Ka shtete që i penalizojnë prindërit, nëse fëmijët e tyre largohen nga shkolla pa arsye. Në disa vende të tjera, nëse fëmijët bëjnë shumë mungesa pa arsye, atëherë prindërit mund të akuzohen në gjyq për neglizhencë. Mungesat e pajustificuara shoqërohen me gjoba nga më të ndryshmet. Nëse prindërit nuk i paguajnë dhe mungesat vazhdojnë, atëherë ata mund të dënohen edhe me burg. Këto masa duken ekstreme. Nëse prindërit sigurohen që fëmijët të arrijnë në kohën e duhur në shkollë çdo mëngjes, ata nuk mund ta dinë se fëmijët dalin nga dera e pasme e shkollës dhe largohen. Për më tepër, veç gjobave, nuk ka realisht rrugë efikase për ndëshkimin e prindërve. Një shtet ka propozuar vendosjen e një note për përfshirjen e prindërve, si një mënyrë për t'u marrë me nxënësit që shkojnë vonë në shkollë, bëjnë mungesa pa arsye dhe kanë arritje të dobëta në mësim. Kjo notë më pas vendoset në dëftesën e nxënësit. Megjithatë, ky plan, ashtu si të tjerët, nuk duket se përmirëson ndonjë gjë të madhe.

Si përfundim, unë nuk jam përkras i idesë që i bën prindërit përgjegjës për arritjet e fëmijëve të tyre në shkollë.

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

1. Teksti i mësipërm ka qëllim: **1 pikë**
 - A) të rrëfejë mbi raportet e fëmijëve me shkollën.
 - B) të bindë mbi një çështje që lidhet me problematikat e shkollës.
 - C) të informojë mbi situatën e përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës.
 - D) të përshkruajë situata konkrete të marrëdhënieve prindër-nxënës.

2. Cila nga fjalitë e mëposhtme shpreh më mirë **tezën** e këtij teksti? **1 pikë**
 - A) Suksesi i nxënësve në shkollë varet nga marrëdhëniet që ata kanë me mësuesit.
 - B) Autoritetet nuk duhet t'i ndëshkojnë prindërit për mungesat e fëmijëve të tyre.
 - C) Prindërit duhet të mbajnë përgjegjësi për arritjet e fëmijëve në shkollë.
 - D) Më shumë se prindërit, duhet të fajësohen mësuesit për dobësitë e nxënësve.

3. Ç'illoj argumentesh e mbizotërojnë këtë tekst? **1 pikë**

- A) Argumente logjike.
- B) Argumente shkencore.
- C) Argumente të autoriteteve të fushës përkatëse.
- D) Argumente të mbështetura në të dhëna statistikore.

4. Cila nga fjalitë e mëposhtme është një **fakt**? **1 pikë**

- A) Nuk ka asgjë të keqe që prindërit të kontrollojnë nëse fëmijët i kanë bërë detyrat e shtëpisë.
- B) Ka shtete që i penalizojnë prindërit, nëse fëmijët e tyre largohen nga shkolla pa arsye.
- C) Megjithatë, ky plan, ashtu si të tjerët, nuk duket se do të përmirësojë ndonjë gjë të madhe.
- D) Virtualisht, gjithkush e kupton se sa e rëndësishme është përfshirja e prindërve.

5. Cila nga fjalitë e mëposhtme shpreh më qartë opinionin e autorit? **1 pikë**

- A) Një shtet ka propozuar vendosjen e një note për përfshirjen e prindërve.
- B) Prindërit mund të kontrollojnë se sa kohë kalojnë fëmijët duke parë televizor.
- C) Kur adoleshentët përfundojnë shkollën e mesme, një pjesë e tyre vazhdon shkollën e lartë.
- D) Kjo është një ide e keqe dhe rajoni ku është shkolla jonë, nuk duhet ta ndjekë atë për tri arsye.

6. Në zhvillimin e këtij teksti autori mbështetet më shumë në: **1 pikë**

- A) fakte dhe detaje.
- B) dialog dhe histori.
- C) fantazi dhe humor.
- D) pyetje dhe përgjigje.

7. Tonet e komunikimit në këtë tekst janë të natyrës së: **1 pikë**

- A) entuziazmit,
- B) lutjes,
- C) sugjerimit,
- D) urdhrit.

8. Zbuloni një argument në mbështetje të tezës që mbron autori, së bashku me një shembull, në funksion të tij. **2 pikë**

MATURA SHTETËRORE

Argumenti: _____

Shembulli: _____

9. Gjeni antitezën në këtë tekst, si dhe një kundërgument në mbështetje të saj.

2 pikë

Antiteza : _____

Kundërgumenti: _____

10. Duke iu referuar paragrafit II, identifikoni dy nga përgjegjësitë për të cilat nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm në veprimtarinë e tyre të përditshme (pa ndikimin e prindërve).

2 pikë

11.

- a) Cili është qëllimi i përdorimit të fjalisë pyetëse në paragrafin II? **1 pikë**

- b) Pse autori (paragrafi III) u referohet rezultateve shkollore në provimet kombëtare? **1 pikë**

- c) Cila është koha e foljeve që mbizotëron në këtë pjesë? Shpjegoni një nga arsyet e këtij përdorimi. **2 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Koha e foljeve: _____

Arsyeja e përdorimit: _____

- 12.** Pse autori mendon se, nëse prindërit dhe shkolla kthehen në kundërshtarë të njëri-tjetrit, ata që do të vuajnë, do të jenë fëmijët? Arsyetoni mendimin tuaj.

2 pikë

- 13.** Shpjegoni **dy** tipare të paragrafit V që lidhen me strukturën e këtij teksti.

2 pikë

PJESA II

Homeri

Iliada (*Kënga VI- fragment*)

E me fjalë t'ëmbra iu suall Elena:

“Kunat i mirë i mua të poshtrës bushtër
dhe të urryer. Oh! Atë ditë që nëna
posa më lindi të më kishte flakur
nga prehri i saj, duhia e rreptë e erës
të më përplaste pas shkëmbinjve a dallgët
e detit shungulluese të më përpinin,
sesa të ndodhnin këto mynxyra.

Por meqë zotat këto punë të liga
kështu i shestuan, unë të kisha t'paktën
një burrë trim e që në shpirt të ndiente
turp e mëri si burrat. Ky s'ka zemër
as shpirt kreshnik e as do të ketë në të ardhmen,
e shpejt besoj se ka për t'i larë gjynahet.

Por ti, kunat, urdhëro në këtë fron ulu,
se ty më fort po ta ndrydh shpirtin brenga
për sherrin e mua bushtrës, e për fajin
e Lek Paridit, se të dyve Zeusi
këtë fat të zi na e preu, e turpi ynë
do të këndohet në breznitë e ardhshme”.

la priti i madhi Hektor tarogzëtundësi:

“Mos m'u lut t'ulëm, moj Elenë fisnike,
nuk mund t'ri dot, se po më digjet shpirti
me padurim t'u shkoj në ndihmë trojanëve
shumë të brengosur për mungesën time.
Por tunde këtë*, që të nxitojë edhe vetë
e të më zejë pa dalë jashtë prej qytetit,
e unë po shkoj vrik deri në shtëpinë time,
me njerëzit t'piqem dhe me gruan e dashur,
e me vogëlushin, e nuk di a kthehem
ndër ta prapë e gjallë, apo e shkrojtën zotat
nga duart e akejve shpejt të bie i vdekur”.

Kështu tha, e jashtë tarogzëtundësi doli,
e fluturim n'pallat të vet u ngjit.

Por tunde këtë- e ka fjalën për Paridin, i cili i ka kthyer krahët luftës.*

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

14. Në fragmentin e mësipërm Elena shfaqet: **1 pikë**
- A) e penduar,
 - B) mashtruese,
 - C) indiferente,
 - D) armiqësore.
15. Në fjalët e Hektorit ndihet padurimi: **1 pikë**
- A) për të folur më Paridin.
 - B) për të biseduar sa më parë me Elenën.
 - C) për të qenë pranë ushtarëve të tij.
 - D) për të folur sa më parë me zotat.
16. Për të theksuar cilësi të personazheve, i gjithë fragmenti karakterizohet nga përdorimi i: **1 pikë**
- A) epiteteve,
 - B) simboleve,
 - C) metonimive,
 - D) krahasimeve.
17. Çfarë nënkupton fjala **mynxyra** në vargjet e mëposhtme? **1 pikë**
- a dallgët
e detit shungulluese të më përpinin,
sesa të ndodhnin këto mynxyra.*
- A) sëmundje,
 - B) shqetësime,
 - C) fatkeqësi,
 - D) luftëra.
18. Në këtë skenë, në lidhje me Paridin, Elena ndien: **1 pikë**
- A) respekt,
 - B) adhurim,
 - C) dashuri,
 - D) zhgënjim.

MATURA SHTETËRORE

19. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur metafora e shprehur me folje? **1 pikë**

- A) por ti, kunat, urdhëro në këtë fron ulu.
- B) se ty më fort po ta ndrydh shpirtin brenga.
- C) e unë po shkoj vrik deri në shtëpinë time.
- D) as shpirt kreshnik e as do të ketë në të ardhmen.

20. Identifikoni në këtë këngë dy motive. Ilustroni me shembuj nga fragmenti njërin prej tyre. **3 pikë**

21.

a) Bazuar në këtë këngë, tregoni si shfaqet gjendja shpirtërore e Elenës. Çfarë e ka shkaktuar atë? Ilustroni mendimin tuaj me vargje ose detaje nga fragmenti. **3 pikë**

b) Figura e Paridit, në portretizimin që i bën Elena, shfaqet në kontrast me atë të Hektorit. Shpjegojeni këtë kontrast. Cili është funksioni i këtij përdorimi? **3 pikë**

Figura e Paridit: _____

Figura e Hektorit: _____

Funksioni i përdorimit: _____

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- 22.** Komentoni, përmes figurave të sintaksës poetike, vargjet e mëposhtme.
Përqendrohuni në imazhin që krijohet. **2 pikë**

*“Kunat i mirë i mua të poshtrës bushtër
dhe të urryer.*

- 23.** Analizoni si shfaqet në këtë këngë koncepti i grekëve të vjetër në lidhje me fatin.
Mendimin tuaj mbështeteni me të paktën dy ilustrime nga fragmenti. **3 pikë**

- 24.** Nëse Hektori është i destinuar të vdesë, pse ai është kaq i papërmbytur për të
mbrojtur qytetin e tij? **1 pikë**

MATURA 2017

PJESA I

Ajsbergët

- 0 Ju s' do të mundeshit kurrë ta harronit momentin kur keni parë ajsbergun e parë.
- 2 Ajo masë lundruese akulli, që e bën të duket aq të vogël anijen tuaj, është kaq e bukur dhe njëkohësisht kaq e pabesueshme, sa ju thjesht do të përhumbeshit duke e parë. Duket sikur kjo *asgjë* kaq e madhe, nuk mund të jetë natyrore, por më pas, e kuptoni se një gjë e tillë, s' mund të jetë *veç* natyrore.
- 3 Një tjetër perceptim shfaqet sakaq: këto male lundruese janë të rrezikshme. Mendoni jo vetëm për mbytjen e Titanikut në 1912, por edhe për qindra aksidente të tjera, ku i fundit (për fat të mirë asnjë nuk e humbi jetën) ishte mbytja e anijes Explorer në nëntor të 2007, në Antarktidë.
- 4 Tashmë, teksa ndryshimet në klimë po çojnë në rritje të temperaturave globale, ajsbergë të rinj po krijohen: Antarktida krijon shumë më tepër se Groenlanda. Ajsbergët e Antarktidës janë shumë më të mëdhenj, ndonjëherë duke arritur përmasat e shteteve të vogla. Të dhënat e fundit tregojnë se në Antarktidën Perëndimore, që nga viti 1940, temperatura është rritur me -15.2°C , duke e bërë këtë zonë, së bashku me veriperëndimin e Amerikës Veriore dhe Siberinë, një ndër rajonet që po ngrohen më shpejt në tokë. Si rezultat i gjithë këtij procesi, *kanë lindur me mijëra* ajsbergë.
- 5 Teksa po krijohen kaq shumë ajsbergë, shkencëtarët po mësojnë se këto bukuri të rrezikshme nuk janë, as sterile dhe as masa inerte akulli. Në fakt, ata e ndryshojnë mjedisin e tyre nga pikëpamja biologjike, kimike dhe fizike, duke u shndërruar në ishuj ku zhvillohet jeta. Kohët e fundit është bërë i njohur roli i rëndësishëm i ajsbergëve në ekosistemin e Antarktidës. Vëzhguesit në det kanë vërejtur prej kohësh se ajsbergët tërheqin fokat, pinguinët, zogjtë e detit, ndërsa zhytësit kanë vënë re se peshqit janë më të shumtë pranë ajsbergëve, sesa në zonat e tjera në det. Tashmë shkencëtarët po mësojnë se çfarë i tërheq kafshët tek ajsbergu.
- 6 Në varësi të përmasave, vendndodhjes dhe stinës, ajsbergët mund të jenë shkatërrues ose mbrojtës. Në mënyrë tipike, ajsbergët gjatë ekzistencës së tyre, që nga shkëputja nga akullnajat e Antarktidës apo të Groenlandës, e deri tek shkrirja e tyre graduale, shërbejnë si mbrojtës për kafshët, madje e bëjnë këtë edhe brenda fortesës së tyre të magjishme. Ata e pasurojnë oqeanin me lëndë ushqyese, duke shtuar prodhimin e planktonit.

MATURA SHTETËRORE

- 7 Ajsbergët e shtrirë deri në tokë, i mbrojnë gjallesat që jetojnë në fund të shtratit të oqeanit, nga ajsbergët e lirë që lundrojnë në sipërfaqe. Këta të fundit, veprojnë si plaçkitës në fund të sipërfaqes së tokës, duke hapur brazda si parmenda gjigante në shtratin e oqeanit, në thellësi deri mbi njëmijë këmbë e duke shkatërruar kështu jetën e të gjitha gjallesave ujore që nuk mund të largohen nga drejtimi i tyre. Gjithashtu, ajsbergët e mëdhenj mund të pengojnë akujt e oqeanit nga shkëputja e tyre vjetore. Për më tepër, mungesa e rrezeve të diellit ndalon formimin e mikroorganizmave që krijohen nga algat, e kështu, shkëput zinxhirin ushqimor që në lidhjen e parë.
- 8 Nga përvoja personale, mendoj se ajsbergët do të vazhdojnë të habisin dhe të magjepsin vizitorët në rajonet polare, me përmasat dhe bukuritë e tyre qiellore. Pikërisht tani, kur këto ekosisteme janë në shkrirje të shpejtë për shkak të ndryshimeve klimaterike globale, këto masa të ngrira akulli po marrin një dimension të ri mrekullie. Ndërkohë, gjithnjë e më shumë, ne po zbulojmë rolin e tyre të rëndësishëm në jetën biologjike dhe metabolizmin e zonave polare. Pra, nuk duhet t'i shikojmë më ajsbergët thjesht si bukuri; ata janë faktorë aktivë të ndryshimit, ku secili prej tyre, si një oazë akulli në rrugëtimin e jetës, lëviz i paepur në udhëtimin e tij oqeanik drejt shkrirjes.

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

1. Sipas kësaj pjese, sot shkencëtarët po zbulojnë se disa ajsbergë janë në gjendje: **1 pikë**
- A) të prodhojnë fuqi.
 - B) të prodhojnë jehona.
 - C) të ndihmojnë jetën.
 - D) të paralajmërojnë detarët.
2. Dy paragrafët e parë shërbejnë: **1 pikë**
- A) për të listuar çështjet.
 - B) për të ballafaquar zgjidhjet.
 - C) për të tërhequr vëmendjen.
 - D) për të theksuar një kontradiktë.
3. Kjo pjesë na tregon se ajsbergët e Antarkidës, krahasuar me ata të Groenlandës, janë: **1 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- A) më dominues,
- B) më të mëdhenj,
- C) më pak tërheqës,
- D) më të rrumbullakët.

4. Paragrafi i fundit tregon se ajsbergët vazhdojnë të jenë burim: **1 pikë**

- A) i ndotjes,
- B) i çlodhjes,
- C) i magjepsjes,
- D) i paragjykimeve.

5. Në zhvillimin e kësaj pjese, autori mbështetet shumë: **1 pikë**

- A) në dialog dhe histori,
- B) në fakte dhe detaje,
- C) në fantazi dhe humor,
- D) në pyetje dhe përgjigje.

6. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon më mirë **opinionin e autorit** në lidhje me ajsbergët? **1 pikë**

- A) Në Antarktidën Perëndimore temperatura është rritur me -15.2°C .
- B) Vëzhguesit në det kanë vërejtur prej kohësh se ajsbergët tërheqin fokat, pinguinët, zogjtë e detit.
- C) Teksa ndryshimet në klimë po çojnë në rritje të temperaturave globale, ajsbergë të rinj po krijohen.
- D) Ajo masë lundruese akulli, që e bën të duket aq të vogël anijen tuaj, është kaq e bukur dhe njëkohësisht kaq e pabesueshme, sa thjesht do të përhumbeshit duke e parë.

7. Cila nga fjalitë e mëposhtme përmbledh më saktë **mesazhin** e pjesës? **1 pikë**

- A) Tashmë shkencëtarët po mësojnë se çfarë i tërheq kafshët tek ajsbergu.

MATURA SHTETËRORE

- B) Ata e pasurojnë oqeanin me lëndë ushqyese, duke shtuar prodhimin e planktonit.
- C) Pra, nuk duhet t'i shikojmë më ajsbergët thjesht si bukuri; ata janë faktorë aktivë të ndryshimit.
- D) Në varësi të përmasave, vendndodhjes dhe stinës, ajsbergët mund të jenë shkatërrues ose mbrojtës.

8. Lexoni me kujdes fjalinë hyrëse të kësaj pjese. Cila është e veçanta e saj nga pikëpamja strukturore dhe gjuhësore? **2 pikë**

Strukturore: _____

Gjuhësore: _____

9.

a) Cila është ndjesia që përpiqet të na përçojë autori, në paragrafin e dytë? Çfarë e shkakton atë? **2 pikë**

b) Në paragrafin e tretë, autori sjell shembuj nga përvoja njerëzore. Identifikoni dy prej tyre dhe zbuloni funksionin që ato luajnë. **3 pikë**

Shembujt: _____

Funksioni: _____

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- 10.** Përgjatë tekstit, gjuha e autorit shpesh shfaqte figurshme. Gjeni një rast të tillë dhe tregoni cilat janë, sipas jush, dy arsytet e kësaj zgjedhjeje nga ana e autorit. **3 pikë**

Shembull: _____

Arsyet: _____

- 11.** Ku qëndron, sipas autorit, thelbi i madhësisë së ajsbergëve? Interpretoni këtë këndvështrim. Mendimin tuaj ilustrojeni me shembuj nga pjesa. **3 pikë**

PJESA II

IBSEN

Shtëpi kukulle (fragment)

NORA- Kur diçka duhet të ndodhë, është më mirë të ndodhë pa shumë fjalë, apo jo, Torvald?

HELMERI – (*Duke bërë ecejake*). Ishim kaq miq të ngushtë! Duheshim kaq shumë me njëri-tjetrin! As që mund ta marr me mend se nuk do ta shoh më. Ai me vuajtjen e tij, me vetminë e tij, i sillte një si farë kurore të mjegulluar resh lumturisë sonë të qartë si drita e diellit... Po, kushedi, mbase kështu është më mirë. (*E përqafton*). Gruaja ime e dashur... Gjithmonë më duket sikur nuk të shtrëngoj shumë, aq sa dua. E di, Nora? Ngandonjëherë dua, bile, që të të kanoset ndonjë rrezik, në mënyrë që unë të kem rast të rrezikoj jetën për ty, të sakrifikoj çdo gjë për ty.

NORA – (*Çlirohet prej tij dhe thotë me forcë dhe e vendosur*). Tani lexo letrat e tua, Torvald.

.....
HELMERI- Nora!

NORA - (*Duke thirrur me të madhe*). Ah!

HELMERI- Ç'është kjo? E di ti ç'skruhet në këtë letër?

NORA- Po, e di. Më lër të shkoj! Më lër të iki!

HELMERI- (*Duke e ndalur*). Ku kërkon të shkosh?

NORA- (*Përpiqet të çlirohet*). Ti nuk duhet të më shpëtosh, Torvald.

HELMERI- (*Duke u zbrapsur*). E vërtetë?! Domethënë, të vërteta janë këto që shkruhen në letër? ...

O, tmerr! ... Jo, jo, jo! Është e pamundur, nuk mund të jetë e vërtetë.

NORA- Është e vërtetë. Të kam dashur më tepër se çdo gjë tjetër në botë.

HELMERI - Lëri këto arsyetime të kota!

NORA - (*Duke iu afruar*). Torvald! ...

HELMERI - E zeza ti... Ç'ke bërë kështu?!

NORA - Më lër të shkoj. Ti nuk duhet të vuash për mua... Mbi ty nuk duhet të bjerë asgjë...

HELMERI - Lëri skenat. (*Mbyll me çelës derën e hyrjes*). S'ke ku shkon, po nuk m'i the këtu, të më japësh llogari për të tëra një nga një. A e kupton se çfarë ke bërë? ... Fol! ... A e kupton? ...

NORA - (*la ngul sytë dhe e vëren pa lëvizur asnjë muskul të fytyrës*). Po, tani po filloj ta kuptoj.

HELMERI - (*Duke shkuar ec e jakë nëpër dhomë*). O, çfarë ëndërr e tmerrshme! Për tetë vjet rresht, ajo që ishte gëzimi, krenaria ime, nuk paska qenë veçse një

hipokrite, një gënjeshtare... më keq, më keq... një kriminele! Oh, çfarë llum i ndyrë! Tmerr! ... Ptu! Ptu! ...

(Nora hesht dhe e shikon kurdoherë me sytë ngulur).

HELMERI - *(Ndalet përpara saj)*. Duhej ta kisha kuptuar se do të ndodhte kështu. Duhej ta dija. Parimet e lehta të tyt eti, mos ma pre fjalën! Parimet e lehta të tyt eti ti i ke trashëguar të gjitha! As fe, as moral, as ndonjë ndjenjë detyre... Oh, ky është ndëshkimi që po marr ngaqë atëherë mbylla një sy me ... babanë tënd! Për ty e bëra... vetëm për ty! Kurse ti po ma shpërblen kështu.

NORA - Po, kështu.

HELMERI - Ma shkatërrove lumturinë! Ma prishe të ardhmen! Ah më vjen tmerr ta mendoj! Në duart e një njeriu që s'di ç'është ndërgjegjja! Ai mund të bëjë me mua ç'të dojë! Mund të kërkojë nga unë çfarë të dojë! E unë duhet t'i duroj të tëra... E ta mbyll gojën! Ta humbas në këtë mënyrë tërë ç'kam... të shkas e të bie gjer në fund për shkak të një gruaje mendjelehtë! ...

NORA - Por, duke mos qenë unë, ti je i lirë!

HELMERI - Ah, lëri këto gjepura! Edhe yt atë i kishte kurdoherë gati fjalë të tilla! E ç'fitim kam unë, në qoftë se ti "nuk do të jesh më", si thua ti? Asgjë, asgjë! Ai prapëseprapë mund ta zbulojë çështjen... E, në qoftë se do ta bëjë këtë gjë, të gjithë do të thonë se edhe unë kam pasur dijeni për aktin tënd, për krimin tënd. Do të thonë bile se unë kam qenë nxitësi, shtytësi, me një fjalë do të më quajnë bashkëpunëtorin tënd. E për këtë duhet të ta di faleminderit ty, ty, që të kam mbajtur në pëllëmbë të dorës gjatë tërë kohës që kemi jetuar bashkë. A e kupton, a s'e kupton se çfarë ke bërë?

NORA - *(Me qetësi, ftohtë)*. Po.

HELMERI – Kaq e çuditshme më duket, saqë akoma s'po arrij do ta kuptoj! Por s'kemi ç'presim, duhet të marrim një vendim. *(Heshtje)*. Hiqe shallin! Hiqe, të them... *(Heshtje)*. Në një mënyrë a në një tjetër, atij i duhet mbyllur goja. Këtë nuk duhet ta marrë vesh asnjëri. Por mos pandeh se midis nesh çdo gjë ka mbetur si më parë. Domosdo, sa për sytë e botës ne do të vazhdojmë si më parë, ti do të rrih këtu, kjo kuptohet. Por fëmijët, ama, nuk mund t'i lë më në duart e tua... Oh, o zot, e këto duhet t'ia them asaj që kam dashur shumë e që akoma... Pëh, tani çdo gjë mori fund! Këndeje e tutje, nuk është më fjala për të shpëtuar lumturinë tonë, por për të shpëtuar mbeturinat, gërmadhat ... formën!

MATURA SHTETËRORE

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

12. Një nga elementet që e bën fragmentin e mësipërm pjesë të një drame realiste është se: **1 pikë**

- A) personazhet kryesore janë heronj tragjikë.
- B) personazhet kryesore janë njerëz të zakonshëm.
- C) personazhet kryesore kanë një të kaluar aristokratike.
- D) personazhet kryesore shfaqen në rrethana të jashtëzakonshme.

13. Nisur nga konteksti, në dialogun e mëposhtëm, çfarë kupton realisht Nora? **1 pikë**

HELMERI - Lëri skenat. (Mbyll me çelës derën e hyrjes). S'ke ku shkon, po nuk m'i the këtu, të më japësh llogari për të tëra një nga një. A e kupton se çfarë ke bërë? ... Fol! ... A e kupton? ...

NORA - (Ia ngul sytë dhe e vëren pa lëvizur asnjë muskul të fytyrës). Po, tani po filloj ta kuptoj.

- A) Të vërtetën mbi martesën e saj.
- B) Të drejtën e Helmerit për të reaguar ashpër.
- C) Veprimin e pamatur që ajo ka kryer ndaj të shoqit.
- D) Pasojat që do të shkaktojë në karrierën e të shoqit ky veprim.

14. Në cilën prej alternativave të mëposhtme toni merr karakter urdhërues? **1 pikë**

- A) Ma shkatërrove lumturinë!
- B) Por fëmijët, ama, nuk mund t'i lë më në duart e tua...
- C) Kurse ti po ma shpërblen kështu.
- D) Hiqe shallin! Hiqe, të them...

15. Cili është vendimi që merr Helmeri, në lidhje me martesën e tyre (fondi i fragmentit)? **1 pikë**

- A) Ai do ta refuzojë si grua dhe si nënë.
- B) Se ajo duhet të largohet menjëherë nga familja.
- C) Ai do të mundohet të zgjidhë gjithçka me maturi.
- D) Se ajo duhet të largohet për ca kohë, sa të qetësohet gjendja.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- 16.** Kur Helmeri thotë: “Ah, lëri këto gjepura”, me fjalën *gjepura* ai nënkupton: **1 pikë**
- A) arsyetime,
B) gjykime,
C) dokrra,
D) komente.
- 17.** Në fund të kësaj skene, Nora shfaqet: **1 pikë**
- A) e shqetësuar për fëmijët e saj.
B) e tensionuar për fatin e të dyve.
C) e trembur nga e ardhmja që e pret.
D) e akullt ndaj çdo fjale të rëndë që Helmeri i thotë.
- 18.** Cili është reagimi i Helmerit kur zbulon të vërtetën mbi atë që ka bërë Nora dikur? **1 pikë**
- _____
- 19.** Në pjesën më poshtë, identifikoni dy mjete stilistike (bashkë me ilustrimin përkatës) dhe zbërtheni nëntekstin që ato mbartin. **3 pikë**
- O, çfarë ëndërr e tmerrshme! Për tetë vjet rresht, ajo që ishte gëzimi, krenaria ime, nuk paska qenë veçse një hipokrite, një gënjeshtare... më keq, më keq... një kriminele! Oh, çfarë llum i ndyrë! Tmerr! ... Ptu! Ptu! ...*
- Mjeti i stilistikës: _____ Ilustrimi: _____
- Mjeti i stilistikës: _____ Ilustrimi: _____
- Nënteksti: _____
- _____
- 20.** Pse Helmeri e përmend disa herë babanë e Norës? **1 pikë**
- _____

MATURA SHTETËRORE

21. Qëndrimi i Norës, në këtë fragment, kalon në disa faza. Analizojini ato bashkë me ilustrimet përkatëse. **3 pikë**

22. Në fillim të kësaj skene, Helmeri i thotë Norës: “*Ngandonjëherë dua, bile, që të të kanoset ndonjë rrezik, në mënyrë që unë të kem rast të rrezikoj jetën për ty, të sakrifikoj çdo gjë për ty.*”

Zbërtheni ironinë dramatike që mbartin këto fjalë, parë në tërësinë e këtij fragmenti. **2 pikë**

23.

- a) Vini në dukje (nga fragmenti) një moment ku shfaqet raporti i individit me shoqërinë. Cili është mendimi juaj në lidhje me këtë raport? **2 pikë**

- b) Identifikoni në këtë skenë një të dhënë që paralajmëron vendimin që do të marrë Nora më vonë, prishjen e martesës dhe largimin e saj nga shtëpia. **1 pikë**

24. Shpjegoni thelbin e marrëdhënies midis Norës dhe të shoqit. Mendimin tuaj mbështeteni me ilustrimet përkatëse. **3 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- 25.** Një filozof ka thënë: *“Karakteri yt është diçka që ti zgjedh vetë ta krijosh”*.
 A i ndërtojmë ne vetë cilësitë e karakterit apo ai formohet nga ndikime që
 s’mund t’i kontrollojmë dot? Po ju si mendoni?
 Argumentoni zgjedhjen tuaj.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë

MATURA 2018

PJESA I

Kur shkruajmë

Një copë e bardhë letre mund të jetë ngacmuese dhe e frikshme. Ndoshta çdo shkrimtar i njeh mirë të dyja këto ndjesi. Unë e besoj këtë. Do të dëshiroja që, në këtë libër me poezi, të përfshija edhe një letër për ju, pasi dëshiroj t'ju flas individualisht. Do të dëshiroja t'ju thosha: dëgjoni brenda vetes zërin tuaj të brendshëm. Respektoni mendimet, ndjenjat dhe idetë tuaja. Luani me fjalët. Eksploroni bashkë me gjuhën kënaqësinë e të qenit gjallë.

Jeta ndonjëherë është e dhimbshme dhe kjo bën që shpesh të shkruajmë për takime të trishtuara, për një mik që na ka tradhtuar apo vdekjen e njërit prej prindërve. Ka ditë kur jemi plot gëzim dhe ndihemi si në ajër. Mund të fluturojmë! Nëse shkruajmë sinqerisht, zbulojmë vetveten. Nuk është kurrë e thjeshtë. Nuk është e thjeshtë të shfaqim vetveten në shkollë, por, mos harroni, se të shkruarit është praktikë. Pa u praktikuar, ju nuk do të arrini kurrë të dëgjoni dhe të këndonit këngën tuaj unike.

Gjithnjë kam qenë lexuese. Kjo në fakt është edhe përgatitja më e mirë për t'u bërë një shkrimtar. Kur isha në shkollë, lexoja shpesh libra komikë, libra me mistere, si dhe revista dhe libra nga biblioteka e qytetit. Isha deri në grykë e mbushur me fjalë.

Gjithnjë më ka pëlqyer të shkruaj, por u bëra nënë përpara se të vendosja për të shkruar. A mos ishte kjo për shkak të faktit se mendoja që nuk kisha asgjë për të thënë? A mos vallë nuk besoja se mund ta shprehja gjithçka si duhet? Apo mos ndodhi për shkak se në shkollë nuk dëgjova kurrë për një shkrimtar që të ishte si unë, pra të fliste në dy gjuhë njëkohësisht, dhe, në një farë mënyre, arrita në përfundimin se "njerëzit si unë" nuk mund të bëheshin dot shkrimtarë?

Kam në dhomë, tamam përballë tavolinës sime, fotografinë e një shkrimtari, që gjithnjë e kam pëlqyer. Kush është i juaji? Dëshironi të bëheni shkrimtar? A do të dëshironit t'i shkruanit, vizatonit apo këndonit historitë tuaja?

Unë u bëra shkrimtare, sepse fjalët më jepnin aq shumë kënaqësi, sa që gjithnjë kam pasur dëshirën t'i zhys duart dhe zemrën brenda tyre, të shikoj se çfarë mund të krijoj, çfarë mund të shkruaj në një fletë të bardhë. Kam mësuar se disa shkrimtarë janë të qetë dhe të ndrojtur, të tjerët të zhurmshëm, disa thjesht të padurueshëm. Disa shkruajnë shpejt dhe disa ngadalë, si një i moshuar, i cili përpiqet të ngjisë kodrën në një ditë me erë.

Dëshiroj të ndaj me ju disa nga sekretet tona.

I pari është se ne të gjithë lexojmë. Disa nga ne pëlqejnë misteret dhe disa të tjerë pëlqejnë kujtimet, por shkrimtarët janë lexues. Ne jemi kureshtarë të mësojmë se çfarë bëjnë të tjerët me fjalët, por ajo që është më e rëndësishme, na pëlqen ajo që ndodh me ne, kur hapim një libër, mënyra si udhëtojmë nëpër fletët e tij.

Një sekret tjetër është se shkruajmë shpesh. Nuk po flas vetëm për procesin e të shkruarit. Ne qëndrojmë me veten, shkruajmë në aeroporte apo tavolinën e kuzhinës apo edhe tek peceta e bukës.

Zakonisht jemi të zhurmshëm. Pyesni për këtë fëmijët e mi. Shkrimtarët janë edhe koleksionistë. Ne grumbullojmë fakte, fraza dhe histori: emrat e kaktusit apo ç'emër ka *djathi* në disa gjuhë.

Në njëzet vitet e fundit, unë kam shpenzuar gjithnjë e më tepër kohë duke shkruar libra për fëmijë dhe të rritur. Kam marrë shumë kundërshtime dhe ndoshta do të marr edhe shumë të tjera. Po kush e vret mendjen! Thjesht kam vazhduar të shkruaj dhe të rishikoj gjithçka. Rishikimi është tashmë një nga pjesët më të parapëlqyera të të qenit shkrimtare, megjithëse nuk jam ndierë gjithnjë kështu. Më pëlqen të merrem me atë që kam shkruar, një pikturë, një libër apo një poemë dhe të përpiqem ta shkruaj atë sa më mirë, duke ndryshuar fjalët apo ritmin. Ndonjëherë duke ia nisur nga e para.

Të shkruarit është mënyra ime për ta njohur veten më mirë apo për të dëgjuar dhe zbuluar se çfarë është e rëndësishme për mua, çfarë më trishton, çfarë më bën të ndryshme, çfarë më bën të jem unë, të zbuloj emrin tim të vërtetë. Të shkruarit më bën të ndihem më pak e vetmuar. Unë kam gjithë këto fjalë në të dyja gjuhët e mia, që më pëshpëritin e ndonjëherë më bërtasin dhe që presin t'i fus në punë, t'i kombinoj, kështu ato mund t'u ngjiten maleve në këmbë apo të zbresin poshtë në fundin e detit të qetë.

Po ju? Ndoshta këto poezi, të marra nga përmbledhjet e mia: *Lartësitë*, *Kufijtë*, *Bashkësia*, bashkë me disa poezi të reja, të shkruara për këtë libër, për ju, do t'ju nxisin të shkruani poezitë tuaja për një person apo vend të veçantë, për një frikë gri apo lumturi të gjelbër. Cilat janë lulet tuaja, gjembat, rrënjët?

Mos harroni miqtë e mi, mos flisni kurrë keq për shkrimet tuaja. Mos bëni kurrë shaka me to. Nxirreni jashtë zërin tuaj të brendshëm dhe na lejoni ta dëgjojmë. Hajdeni, bashkohuni me familjen serioze dhe kaq të pazakontë të shkrimtarëve.

MATURA SHTETËRORE

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

1. Autorja e tekstit të mësipërm e konsideron një faqe të bardhë letre si: **1 pikë**
- A) argëtuese,
 - B) misterioze,
 - C) tërheqëse,
 - D) sfiduese.
2. Si janë organizuar nga autorja paragrafët 8 deri në 10? **1 pikë**
- A) Duke listuar praktika të zakonshme të përdorura nga shkrimtarët.
 - B) Duke krahasuar strategjitë që shkrimtarët përdorin për të zhvilluar idetë e tyre.
 - C) Duke deklaruar strategjitë që shkrimtarët shmangin si të papërshtatshme.
 - D) Duke identifikuar problemet që shkrimtarët ndeshin, ndërsa rishikojnë veprën e tyre.
3. Cila nga fjalitë e mëposhtme mbështet më mirë pohimin e autores se leximi i ndihmon shkrimtarët të zhvillojnë aftësitë e tyre? **1 pikë**
- A) Pa u praktikuar, ju nuk do të arrini kurrë të dëgjoni dhe të këndonni këngën tuaj unike.
 - B) Rishikimi është tashmë një nga pjesët më të parapëlqyera të të qenit shkrimtare, megjithëse nuk jam ndierë gjithnjë kështu.
 - C) Ne jemi kureshtarë të mësojmë se çfarë bëjnë të tjerët me fjalët, por ajo që është më e rëndësishme, na pëlqen ajo çfarë ndodh me ne kur hapim një libër, mënyra si udhëtojmë nëpër fletët e tij.
 - D) Në njëzet vitet e fundit, unë kam shpenzuar gjithnjë e më tepër kohë duke shkruar libra për fëmijë dhe të rritur.
4. Bazuar në fjalinë e dhënë më poshtë, lexuesi arrin në përfundimin se autorja beson se: **1 pikë**
- Të shkruarit është mënyra ime për ta njohur veten më mirë apo për të dëgjuar dhe zbuluar se çfarë është e rëndësishme për mua, çfarë më trishton, çfarë më bën të ndryshme, çfarë më bën të jem unë, të zbuloj emrin tim të vërtetë.*
- A) kërkimi i ideve në vende të ndryshme e përmirëson procesin e të shkruarit.
 - B) procesi i të shkruarit zhvillon tek njeriu ndjenjën e unit.
 - C) shprehja e mendimeve me gojë është më e lehtë se sa me shkrim.
 - D) procesi i të shkruarit i ndihmon të tjerët të zgjidhin konfliktet e tyre.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

5. Sipas autores, përgatitja e parë dhe më e mirë për të qenë shkrimtar, është:
1 pikë

- A) të fitosh kënaqësi nga fjalët.
- B) të ndash sekretet e tua me të tjerët.
- C) të shkruash shpejt dhe zhurmshëm.
- D) të jesh një lexues i mirë.

6. Cila nga fjalitë e mëposhtme përmbledh më saktë mesazhin e pjesës?

1 pikë

- A) Ne të gjithë duhet të lexojmë.
- B) Shkrimtari i vërtetë grumbullon fakte, fraza, histori...
- C) Nxirreni jashtë zërin tuaj të brendshëm dhe na lejoni ta dëgjojmë!
- D) Rishikimi është një nga pjesët më të parapëlqyera të shkrimtarëve.

7. Në cilën prej alternativave të mëposhtme toni merr karakter sugjerues?

1 pikë

- A) Po kush e vret mendjen!
- B) Cilat janë lulet tuaja, gjembat, rrënjët?
- C) Një sekret tjetër është se shkruajmë shpesh.
- D) Eksploroni bashkë me gjuhën kënaqësinë e të qenit gjallë.

8.

a) Renditni dy nga “*të fshehtat*” që autorja ndan me lexuesit saj.

2 pikë

b) Për t’u bërë shkrimtar, sipas autores, duhen pasur parasysh dy **procese** mjaft të rëndësishme. Cilat janë ato?

2 pikë

MATURA SHTETËRORE

9. Zbërtheni kuptimin e shprehjes: ... *gjithnjë kam pasur dëshirën t'i zhys duart dhe zemrën brenda tyre, të shikoj se çfarë mund të krijoj, çfarë mund të shkruaj në një fletë të bardhë.*

Cila është figura stilistike që mbart peshën e kësaj fjalie?

3 pikë

10. Sipas autores, të shkruarit e ka ndihmuar atë të zbulojë emrin e saj të vërtetë (paragrafi 12). Bazuar në këtë pjesë, shpjegoni domethënien e këtij pohimi.

2 pikë

11.

- a) Interpretoni qëndrimin që ka autorja, në lidhje me rishikimin e një vepre. Pse është e rëndësishme kjo etapë për procesin e të shkruarit?

2 pikë

- b) Në ç'mënyrë një shkrimtar siguron që vepra që po shkruan, të ketë **përmbajtjen** dhe **formën** e duhur (sipas autores)?

2 pikë

12. Identifikoni dy nga teknikat e shkrimit në dy paragrafët përmbyllës të kësaj pjese.

2 pikë

PJESA II

Albert Kamy

I huaji (fragment)

Edhe kur je në bankën e të akuzuarve është gjithmonë interesante të flasin për ty. Gjatë akuzës së prokurorit dhe mbrojtjes së avokatit tim, mund të them se u fol më shumë për mua se sa për krimin tim. Për më tepër, a ndryshonin nga njëra-tjetra akuzat dhe mbrojtja? Avokati ngrinte duart dhe më bënte fajtor, por me arsye. Prokurori zgjaste duart dhe nxirrte në shesh fajësinë, por pa arsye. Diçka më ngacmonte përbrenda. Megjithë shqetësimet e mia, nganjëherë më vinte të ndërhyja dhe atëherë avokati më thoshte: “Pushoni, është më mirë për ju”. Dukej sikur në një farë mënyre kjo çështje trajtohej e shkëputur nga unë. Çdo gjë zhvillohej pa ndërhyrjen time. Përcaktohej fati im pa marrë mendimin tim. Herë pas here, më vinte t’u prisja fjalën të gjithëve e t’u thosha: “Por, ta marrim vesh, kush është i akuzuari. Ka rëndësi të jesh i akuzuari. Edhe unë kam diçka për të thënë.” Por, pasi mendohesha, s’kisha asgjë për të thënë. Për më tepër, duhet ta pranoj se dëshira që ke për t’u hapur punë njerëzve nuk zgjat shumë.

.....

Mbrojtja e avokatit tim dukej sikur nuk do të mbaronte kurrë. Megjithatë një çast dëgjova tek thoshte: “Është e vërtetë që kam vrarë.” Pastaj ai vazhdoi me të njëjtin ton duke thënë “unë” sa herë fliste për mua. U çudita shumë. U përkula drejt një xhandari dhe e pyeta përse. Ai më tha të heshtja dhe pas një çasti shtoi: “Të gjithë avokatët kështu bëjnë.” Kurse unë mendova se e bënte për të më mënjeluar nga çështja, për të më kthyer në hiç dhe në një farë mënyre, të më zëvendësonte. Por tashmë më dukej se isha shumë larg nga kjo sallë. Për më tepër avokati im m’u duk qesharak. Ai kundërshtoi shpejt e shpejt provokimin që u bë dhe pastaj foli edhe ai për shpirtin tim. Por m’u duk se kishte shumë më pak talent se prokurori. “Edhe unë, tha ai, kam vështruar mbi këtë shpirt, por ndryshe nga përfaqësuesi i shquar i prokurorisë, unë kam zbuluar diçka dhe mund të them se kam lexuar aty me lehtësi”. Ai kishte lexuar aty se unë isha njeri i ndershëm, një punonjës i rregullt, i palodhur, besnik ndaj qendrës së punës, i dashur nga të gjithë dhe zemërdhembshur ndaj halleve të të tjerëve. Për të unë isha një djalë shembullor, që e kishte mbajtur t’ëmën sa kishte patur mundësi. Së fundi kisha shpresuar se një azil do t’i jepte gruas plakë rehatinë që mundësitë e mia nuk arrinin t’ia siguronin. “Habitem, zotërinj, shtoi ai, që u bë zhurmë kaq e madhe rreth këtij azili. Sepse tek e fundit, nëse duhet dhënë një provë e dobisë dhe rëndësisë së këtyre institucioneve duhet thënë se ato subvencionohen nga vetë shteti.” Vetëm se ai nuk foli për varrimin dhe ndjeva se kjo mungonte në fjalën e tij të mbrojtjes. Por për shkak të gjithë këtyre ligjëratave të

MATURA SHTETËRORE

gjata, këtyre ditëve dhe orëve pambarim, gjatë të cilave u fol për shpirtin tim, pata përshtypjen se çdo gjë kthehej në një ujë të pangjyrë që më turbullonte mendtë.

Më në fund më kujtohet vetëm se, ndërsa avokati im vazhdonte të fliste, tingujt e borisë së një akulloreshitësi që vinin nga rruga, përshkonin gjithë hapësirën e korridoreve, të sallës së gjyqit dhe arrinin deri tek unë. Më mbërthyen kujtimet e një jete që s'më përkiste më, por ku unë kisha gjetur gëzimet më të vogla e më të forta: aromat e verës, lagjen e dashur, qiellin e veçantë të mbrëmjeve, të qeshurën dhe fustanet e Maries. Mendoja sa e kotë qe prania ime në këtë vend e një lëmsh m'u bë në grykë dhe prisja me ngut të merrte fund e gjithë kjo e të gjeja përsëri qelinë time dhe gjumin. Dëgjova turbullt avokatin tim të çirrej duke përfunduar se gjyqtarët nuk do të dënonin me vdekje një punonjës të ndershëm që gabon në një çast hutimi dhe të kërkonte rrethana lehtësuese për një krim që do të më rëndonte përjetë në ndërgjegje, e ky do të qe ndëshkimi më i sigurt. Trupi gjykues e pezulloi seancën dhe avokati u ul i rraskapitur.

.....
Ne pritëm një kohë shumë të gjatë, afër treçerek ore, më duket. Më në fund tringëlliu një zile. Avokati im u largua duke thënë: "Kryetari i jurisë do të lexojë përgjigjet. Juve do t'ju fusin brenda vetëm për formulimin e vendimit." U përplasën dyert. Njerëzit vraponin nëpër shkallë dhe nuk e kuptoja në ishin afër apo larg. Pastaj dëgjova një zë të mbytur që lexonte diçka në sallë. Kur zilja ra përsëri dhe u hap dera, heshtja e sallës u ngrit drejt meje, heshtja, dhe me të ndjenja e veçantë që më pushtoi kur vura re se gazetari i ri i kishte hequr sytë nga unë. Nuk vështrova nga Maria. Nuk pata kohë, sepse kryetari tha në mënyrë që disi më habiti se do të më prisnin kokën në mes të një sheshi në emër të popullit francez. Atëherë m'u duk se kuptova ndjenjën që lexoja tek të gjitha fytyrat. Mendoj se ishte respekt. Avokati e vuri dorën mbi dorën time. Nuk mendoja më për asgjë. Por kryetari më pyeti nëse kisha gjë për të shtuar. U mendova. Thashë: "Jo." Atëherë më morën.

Për pyetjet me alternativa rrethoni alternativën e saktë.

13. Pse Mersoi nuk ndërhyt dot në gjyq?

1 pikë

- A) Ai beson tek aftësitë e avokatit.
- B) Avokati i tij mendon se mund të dëmtojë çështjen.
- C) Kështu janë rregullat e gjyqit.
- D) Nuk e lejon turma e irrituar të flasë.

14. Avokati thotë "unë" sa herë flet për Mersoin, sepse:

1 pikë

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- A) është në stilin e avokatëve një përdorim i tillë.
B) kështu kanë rënë dakord të dy që në fillim.
C) kërkon të shfaqë një shenjë solidariteti kundrejt Mersoit.
D) kërkon ta përjashtojë atë përfundimisht nga procesi gjyqësor.
- 15.** Karakteristikë e stilit të Kamysë, në këtë fragment, janë: **1 pikë**
- A) abstragimet e shumta teoriko-filozofike.
B) analizat e thella psikologjike.
C) tonet e larta emocionale.
D) qartësia dhe thjeshtësia e rrëfimit.
- 16.** Çfarë e bën jurinë që të vendosë dënimin e Mersoit me vdekje? **1 pikë**
- A) Pamja e tij prej fajtori.
B) Veprimi i tij kriminal.
C) Sjellja e tij prej indiferenti.
D) Paaftësia e Mersoit për t'u mbrojtur në gjyq.
- 17.** Cili është mendimi që Merso ka për avokatin e tij mbrojtës? **1 pikë**
- A) Avokati po e saboton gjyqin e tij.
B) Avokati është i paaftë dhe qesharak.
C) Avokati po bën më të mirën për ta mbrojtur.
D) Avokati është një njeri serioz dhe i respektueshëm.
- 18.** Cila nga alternativat e mëposhtme pasqyron më mirë mendimin e Mersoit se jeta është absurde? **1 pikë**
- A) Edhe kur je në bankën e të akuzuarve është gjithmonë interesante të flasin për ty. Gjatë akuzës së prokurorit dhe mbrojtjes së avokatit tim, mund të them se u fol më shumë për mua se sa për krimin tim.
B) Avokati im u largua duke thënë: "Kryetari i jurisë do të lexojë përgjigjet. Juve do t'ju fusin brenda vetëm për formulimin e vendimit."
C) Njerëzit vraponin nëpër shkallë dhe nuk e kuptoja në ishin afër apo larg. Pastaj dëgjova një zë të mbytur që lexonte diçka në sallë.
D) Kur zilja ra përsëri dhe u hap dera, heshtja e sallës u ngrit drejt meje, heshtja, dhe me të ndjenja e veçantë që më pushtoi kur vura re se gazetari i ri i kishte hequr sytë nga unë.
- 19.** Kujtimi i momenteve të së kaluarës nga ana e Mersoit luan një rol të dyfishtë. Shpjegojeni këtë rol. Cili është efekti që kanë tek Merso këto kujtime? **3 pikë**

MATURA SHTETËRORE

Shpjegimi: _____

Efekti: _____

20.

- a) Ku qëndron paradoksi në paragrafin e fundit? Çfarë e bën qesharak vendimin e marrë nga juria? **2 pikë**

- b) Në fund të procesit Mersoit thotë vetëm "Jo". Interpretoni reagimin e tij. **1 pikë**

- 21.** Procesi gjyqësor, që po zhvillohet kundër Mersoit, shfaqet fals, joracional dhe i pashpresë. Arsyetoni rreth këtij fakti, duke u mbështetur në skenën e dhënë. **2 pikë**

- 22.** Lexoni me kujdes fjalinë e mëposhtme. Krahasuar me hyrjen e fragmentit, shpjegoni ku qëndron absurdi në të. **2 pikë**

Mendoja sa e kotë qe prania ime në këtë vend e një lëmsh m'u bë në grykë dhe prisja me ngut të merrte fund e gjithë kjo e të gjeja përsëri qelinë time dhe gjumin.

- 23.** Çfarë ka të veçantë mënyra e të rrëfyerit në këtë fragment? Identifikoni në pjesën e dhënë dy karakteristika të veçanta të rrëfimit. **2 pikë**

- 24.** Cili është efekti që ka kjo mënyrë të rrëfyeri tek lexuesi? Argumentoni përgjigjen tuaj. **2 pikë**

- 25.** ... tek e fundit, ambienti ku jetojmë, ndërton tek ne tiparet psikologjike dhe morale. Ai ndikon në jetën dhe në karakterin tonë po aq sa fati dhe rastësitë.

PJESA I

Pëshpërimita e tokës

Në ditët më të errëta të dimrit, ngjyrat gjithsesi janë kudo rreth nesh. Na duket sikur mungojnë, nuk presim t'i shohim, e prandaj, nuk i shohim.

Në agim ato lundrojnë së bashku me retë që shtrihen në juglindje të horizontit, dhe në mesditë rrinë mbi të çarat e kodrave. Në mbrëmje horizonti perëndimor, i veshur me ngjyrë të trëndafilte, të artë dhe vjollcë, me të tëra nuancat e vjollcës, fillon dhe lëviz.

E vërteta është se ne përqendrohemi më pak tek hareja e ngjyrave dhe më shumë në gjërat e zymta. Nëse mendjet tona kanë rënë pre e mendimeve të zymta e pa ngjyra, sytë tanë kanë një mundësi të vogël për të parë më tej.

Për t'i shpëtuar verbërisë sime ndaj ngjyrave, kam kaluar shumë kohë nëpër kopshtet dhe zonat përreth. Aty gjej vetminë që më duhet për të studiuar jetën dhe ngjyrat e tokës. Kam bërë rrugë të gjata mbi këtë tokë, kur ishte e ngrirë, kur ishte përmbytur nga shiu, kur ishte e thatë e me pluhur dhe kur bimët, pemët dhe lulet e egra gjelbëronin.

Çdo gjë që shikoj dhe kuptoj, e shënoja në bllokun tim; mbaja shënime të detajuara për gjithçka që vëreja. Mësova të mos hamendësoja. Nuk mund të mbështetesh në kujtime për të rikthyer me saktësi pamjen e një luleshtrydheje të egër dhe e dija që do të dukej krejt ndryshe, pasi të kalonte një javë.

Çdo ditë dhe çdo shëtitje kishte diçka të re. Gjërat e pabesueshme që ndodhnin, nuk mund të mos mbaheshin shënim: si shndriste livadhi nga pikat e vesës, si vraponte një dre vetëtimthi përmes fushës dhe se si tymi i degëzave të djegura nga dengu i një fermeri dredhonte drejt qiellit.

Gjërat kanë jetë për një kohë shumë të shkurtër. Pamja duhet të jetë po aq e rëndësishme, kur ta lexoj në bllokun tim, sa ç'ishte kur ndodhi. Duhet të jetë e aftë të jetojë përsëri në faqen e letrës, edhe pse në një stinë tjetër.

Blloqet e dimrit vijnë me mua në pranverë dhe shënimet e pranverës mbushen shpejt me pamje verore. Shënoje e shënoj, sepse çdo imazh duhet të ketë mundësinë për t'u prekur dhe kuptuar, në mënyrë që të jetojë në letër.

Fjala është vetëm një pjesë e shpirtit, por ushqen ata që nuk mund të ndalojnë për të parë, për të përjetuar ngjyrat vjollcë të tokës. Nuk mundem të hamendësoj që lexuesit do ta dinë se ç'kam parë: si çel një lule, si fluturon një zog ose çfarë është aroma. Të ngacmosh imagjinatën e dikujt për të kërkuar vetveten, është si të bësh një rrethrotullim të plotë drejt rizgjimit.

Ndonjëherë, kur bie borë dhe trumcakët ushqehen në dritaren time, mbyll sytë dhe shikoj manushaqet që lulëzojnë përgjatë brigjeve të lumit në një stinë tjetër.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Mund të shoh gjethet e gjelbra, të ngopura me lëngun jetëdhënës, përshkruar nga damarë të bardhë, aq të hollë e delikatë, por që mbajnë jetën brenda. Ato janë kaq të kadifenjta, sa mbajnë çdo pikë uji që bie mbi to.

Askush nuk duhet të humbasë ngjyrën vjollcë që hijeshon natyrën. Ne që shënojmë pëshpërimën e tokës, duhet të jetojmë në të, ta nuhasim dhe ta çojmë përpara.

Të gjithë kemi shumë pyetje. Por shpirtrat tanë duhet të ndizen për të parë dhe për të ndjerë. Më pas, kur të jemi lodhur, kur të gjitha ngjyrat të jenë shterur nga shpirtrat tanë, mund të hidhemi sërish në jetën e tokës dhe të gjejmë qetësi shëruese.

Për pyetjet 1-4 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

1. Çfarë simbolizon ngjyra vjollcë në këtë pjesë?

1 pikë

- A) Çudinë dhe bukurinë e natyrës.
- B) Forcën dhe mençurinë e fjalës së shkruar.
- C) Fuqinë e ndryshimit të stinëve dhe motit.
- D) Aftësinë e njerëzve për të anashkaluar ngjarjet e rëndësishme.

2. Cila nga fjalitë e mëposhtme demonstroi qëllimin e autorit për t'i dhënë shkrimin të tij nuanca bindëse?

1 pikë

- A) Ato janë kaq të kadifenjta sa mbajnë çdo pikë uji që bie mbi to.
- B) Por shpirtrat tanë duhet të ndizen për të parë dhe për të ndjerë.
- C) Për t'i shpëtuar verbërisë sime ndaj ngjyrave, kam kaluar shumë kohë nëpër kopshtet dhe zonat përreth.
- D) Në mbrëmje horizonti perëndimor, i veshur me ngjyrë të trëndafiltë, të artë dhe vjollcë, me të tëra nuancat e vjollcës, fillon e lëviz.

3. Si do të ndryshonte kjo pjesë, nëse do të shkruhej në mënyrë objektive nga perspektiva e vetës së tretë?


1 pikë

MATURA SHTETËRORE

- A) Do të kishte një përmbajtje më pak emocionale.
- B) Do të përmbante më pak detaje në lidhje me ngjyrat.
- C) Do të përfshinte më shumë informacion në lidhje me rrëfyesin.
- D) Do të fokusohet më shumë në të tashmen se në të shkuarën.

4. Shikoni tabelat e mëposhtme.

1 pikë



Cila është pasoja e shkakut të dhënë më sipër?

- A) Autori ecën për kilometra të tërë.
- B) Autori i plotëson shënimet e tij me piktura.
- C) Autori kujton se si duken lulet e dimrit.
- D) Autori është në gjendje të përqendrohet tek e bukura.

5. Vëreni me kujdes organizimin e tekstit nga pikëpamja strukturore. Zbuloni dy karakteristika të paragrafit hyrës, që lidhen me strukturën e tekstit. **2 pikë**

Karakteristika: _____

Karakteristika: _____

6.

a) Në paragrafin **e parë dhe të tretë** autori krijon një kundërvënie. Cila është ajo? **1 pikë**

b) Sipas autorit, cila është arsyeja që ne nuk i shohim ngjyrat rreth nesh? **1 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

7. Paraqitni një nga ndjesitë që shkakton tek ju si lexues kjo pjesë, duke shpjeguar se në **ç'mënyrë** ka arritur autori të ngacmojë ndjeshmërinë tuaj.

2 pikë

8. Bazuar në tekstin e dhënë, **interpretoni** se cila është pesha që autori i jep fjalës. Pse ajo ka kaq shumë rëndësi për të?

2 pikë

9.

- a) Titulli i kësaj pjese është figurativ. Emërtoni figurën stilistike që e organizon atë dhe shpjegoni përmes saj raportin që krijohet mes autorit dhe tokës. **2 pikë**

Figura: _____

Shpjegimi: _____

- b) Komentoni forcën shprehëse të metaforës në fjalinë e mëposhtme, marrë në kontekstin e të gjithë fragmentit. **2 pikë**

*Për t'i shpëtuar **verbërisë sime ndaj ngjyrave**, kam kaluar shumë kohë nëpër kopshtet dhe zonat përreth.*

Teksti i dhënë më poshtë nuk është i saktë nga ana gjuhësore.

Lexojeni atë dhe qarkoni përgjigjen që ju mendoni si të saktë.

Gjergj Fishta

[1] Përkujtojmë një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe “Lahuta e Malcis”, në 82-vjetorin e botimit të plotë të saj (8 prill 1937).

[2] Poema madhore epike “Lahuta e Malcis”, e poetit kombëtar at Gjergj Fishta, është jo vetëm kryevepra e tij, por ndër më të rëndësishmet e letërsisë shqipe, me jehonë ndërkombëtare.

[3] Fishta e nisi kryepunën e tij rreth viteve 1900, kur atdheu ishte nën Perandorinë Osmane dhe e mbaroi më 1937, kur Shqipëria ishte shtet i pavarur, dy vjet para se të niste Lufta e Dytë Botërore. [4] Pesë këngët e para të saj u botuan si libër më vete në Zara të Kroacisë me shpenzimet e Faik Konicës. [5] Ky ishte një shembull i shkëlqyer i mbështetjes patriotiko-kulturore të intelektualëve të lartë shqiptarë. [6] Intelektualët më të shquar të kohës ishin Konica, Koliqi e Noli.

[7] Më vonë u botua dhe libri tjetër me këngë derisa u bënë plot 30 këngë ose krerë të një eposi madhështor. [8] Kështu në vepër janë bashkuar sipas kronologjisë ngjarje dhe bëma shqiptare nga gjysma e dytë e shekullit të XIX-të deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe në Konferencën e Londrës, më 1913. [9] Fryma e fuqishme popullore ka diktuar dhe vargun popullor, gjithë rropama dhe ortekë metaforash, duke dhënë kështu “Iliadën” e shqiptarëve, sipas albanologëve, duke e quajtur Fishtën “Homerin e fundit të Ballkanit”.

[10] Kjo kryevepër, e futur tashmë në tekstet shkollore, edhe pse tejet e vështirë për t’u përkthyer, ka botime të pjesshme në italisht, në gjermanisht (nga albanologu Maximilian Lambertz) dhe, së fundmi, në anglisht.

[11] Përkthyesi i saj, albanologu i njohur Robert Elsie, në parathënie thotë se, me botimin anglisht të poemës “Lahuta e Malcis”, u përplotësua eposi evropian. [12] Edhe pse u flak shpeshherë, vepra e Fishtës doli përsëri në dritë për t’i folur Shqipërisë e botës.

Për pyetjet 10-19 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

10. Cila nga fjalitë e mëposhtme do të ishte më e saktë nga ana kuptimore e gramatikore, për t'u përdorur si fjali hyrëse e paragrafit të parë? **1 pikë**

- A) Rikthejmë nga harresa një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe "Lahuta e Malcis", në 82-vjetorin e botimit të plotë të saj (8 prill 1937).
- B) Kemi nderin të përkujtojmë sot, në 82-vjetorin e botimit të plotë të saj (8 prill 1937), një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe, poemën "Lahuta e Malcis".
- C) Memorizojmë në 82-vjetorin e botimit të plotë të saj (8 prill 1937) një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe "Lahuta e Malcis".
- D) Përkujtojmë një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe "Lahuta e Malcis", në 82-vjetorin e botimit të plotë të saj (8 prill 1937).

11. Cili është ndryshimi që duhet bërë në fjalinë [2], në mënyrë që ajo të jetë në koherencë me fjalinë e parë? **1 pikë**

- A) Duhet shkruar me shkronjë të madhe fjala "epike".
- B) Duhet hequr presja pas togut "Lahuta e Malcis".
- C) Duhet shtuar lidhëza "edhe" përpara togut "ndër më të rëndësishmet" dhe pjesëza "madje" përpara togut "me jehonë ndërkombëtare".
- D) Nuk ka nevojë për asnjë ndërhyrje në fjali.

12. Gabimi drejtshkrimor në fjalinë [8] qëndron: **1 pikë**

- A) në shkrimin e emrave të përveçëm.
- B) në shkrimin e numrit romak.
- C) në përdorimin e njëjës së përparme në togun "në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë".
- D) nuk ka probleme drejtshkrimore.

MATURA SHTETËRORE

13. Në cilën nga alternativat e mëposhtme, fjalitë [4] dhe [5] janë lidhur në një fjali të vetme, pa e ndryshuar kuptimin e tekstit? **1 pikë**

- A) Pesë këngët e para të saj u botuan si libër më vete në Zara të Kroacisë me shpenzimet e Faik Konicës, çka ishte një shembull i shkëlqyer i mbështetjes patriotike-kulturore të intelektualëve të lartë shqiptarë.
- B) Meqenëse pesë këngët e para të saj u botuan si libër më vete në Zara të Kroacisë me shpenzimet e Faik Konicës, ky ishte një shembull i shkëlqyer i mbështetjes patriotike-kulturore të intelektualëve të lartë shqiptarë.
- C) Pesë këngët e para të saj u botuan si libër më vete në Zara të Kroacisë me shpenzimet e Faik Konicës, ndaj ky ishte një shembull i shkëlqyer i mbështetjes patriotike-kulturore të intelektualëve të lartë shqiptarë.
- D) Kur pesë këngët e para të saj u botuan si libër më vete në Zara të Kroacisë me shpenzimet e Faik Konicës, ishte një shembull i shkëlqyer i mbështetjes patriotike-kulturore të intelektualëve të lartë shqiptarë.

14. Një nxënëse dëshiron të shtojë detajet e mëposhtme në tekst. **1 pikë**
Poema e plotë nuk ka një subjekt ose një ngjarje të veçantë, por aty çdo këngë është një ndodhi më vete. Qëllimi i autorit mbetet i qartë: ai ka synuar të tregojë që historinë nuk e bën një njeri i vetëm dhe ajo nuk përbëhet nga një ngjarje e vetme, përkundrazi historinë e bën i gjithë populli, i prirë nga bijtë e tij të shquar. Pas cilës nga fjalitë e mëposhtme duhet shtuar ky informacion?

- A) Pas fjalisë [2],
- B) Pas fjalisë [4],
- C) Pas fjalisë [7],
- D) Pas fjalisë [9].

15. Cila fjali në paragrafin e tretë përmban informacion të tepërt, i cili nuk është në të njëjtën linjë logjike me përmbajtjen e tij? **1 pikë**

- A) Fjalia [3],
- B) Fjalia [4],
- C) Fjalia [5],
- D) Fjalia [6].

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

16. Në rast se në fjalinë [9], *“Fryma e fuqishme popullore ka diktuar vargun popullor, gjithë rropama dhe ortekë metaforash”*, theksi logjik do të binte te kundrinori i drejtë, duhet: **1 pikë**

- A) të shprehet kundrinori i drejtë me emër me parafjalë.
- B) të shprehet kundrinori i drejtë me gjymtyrë homogjene.
- C) të shprehet kundrinori i drejtë me pjesë të nënrenditur fthiluese.
- D) të zhvendoset kundrinori i drejtë në fillim të fjalisë.

17. Në qoftë se pjesët e fjalisë [10], do të kishin marrëdhënie shkakore, alternativa e saktë do të ishte: **1 pikë**

- A) Kjo kryevepër, e futur tashmë në tekstet shkollore, edhe pse tejet e vështirë për t’u përkthyer, ka botime të pjesshme në italisht, në gjermanisht (nga albanologu Maximilian Lambertz) dhe, së fundmi, në anglisht.
- B) Kjo kryevepër, e futur tashmë në tekstet shkollore, ndonëse është tejet e vështirë për t’u përkthyer, ka botime të pjesshme në italisht, në gjermanisht (nga albanologu Maximilian Lambertz) dhe, së fundmi, në anglisht.
- C) Kjo kryevepër, e futur tashmë në tekstet shkollore, është tejet e vështirë për t’u përkthyer, prandaj ka botime të pjesshme në italisht, në gjermanisht (nga albanologu Maximilian Lambertz) dhe, së fundmi, në anglisht.
- D) Kjo kryevepër, e futur tashmë në tekstet shkollore, ngaqë është tejet e vështirë për t’u përkthyer, ka botime të pjesshme në italisht, në gjermanisht (nga albanologu Maximilian Lambertz) dhe, së fundmi, në anglisht.

18. Si duhet shkruar fjalia [11], nëse do të kthehet në ligjëratë të drejtë? **1 pikë**

- A) Përkthyesi i saj, albanologu i njohur Robert Elsie, në parathënie thotë: - Me botimin anglisht të poemës “Lahuta e Malcis” u përplotësua eposi evropian.
- B) Përkthyesi i saj, albanologu i njohur Robert Elsie, në parathënie thotë: “Me botimin anglisht të poemës “Lahuta e Malcis” u përplotësua eposi evropian”.
- C) Përkthyesi i saj, albanologu i njohur Robert Elsie, në parathënie thotë: “se me botimin anglisht të poemës “Lahuta e Malcis” u përplotësua eposi evropian”.
- D) Përkthyesi i saj, albanologu i njohur Robert Elsie, në parathënie thotë se “me botimin anglisht të poemës “Lahuta e Malcis” u përplotësua eposi evropian”.

MATURA SHTETËRORE

19. Nëse fjalisë [12] do t'i shtonim të dhëna plotësuese në ligjërim e sipër, cili nga variantet e mëposhtme do të ishte më i saktë nga ana kuptimore dhe gramatikore? **1 pikë**

- A) Edhe pse u flak shpeshherë, ç'është e vërteta, vepra e Fishtës doli përsëri në dritë për t'i folur Shqipërisë e botës.
- B) Edhe pse u flak shpeshherë, për fat të keq, vepra e Fishtës doli përsëri në dritë për t'i folur Shqipërisë e botës.
- C) Edhe pse u flak shpeshherë - dhe këtë të vërtetë e dinë të gjithë - vepra e Fishtës doli përsëri në dritë për t'i folur Shqipërisë e botës.
- D) Edhe pse u flak shpeshherë, me sa kam dëgjuar, vepra e Fishtës doli përsëri në dritë për t'i folur Shqipërisë e botës.

PJESA II

Migjeni “...Bukën tonë të përditshme falna sot...” (fragment)

Ulet Kola në një karrigë. Po t'ishte këtu me shërbim nuk do të mund të rrinte, tashti barem n'at privilegj e ka (o sa dëshronte Kola të mos ta kishte). Ndej në karrigë, brryllin e mbështeti në tavolinë e ftyrën në shplakë. Prap mendime. O mendime, fundi ju daltë! Se asgja s'po qitni në dritë. Pesë vjet punë në kët kafe. E për pesë vjet trajtat e të gjitha këtyne sendeve lanë vragë të pashlyeshme. E bajnë dhe shpirtin e njeriut që t'u shëmbëllejë. E shpirti i Kolës asht coptue, asht shpërnda grima-grima. Pak nga ai asht futë nëpër vrima të karrigave e të tryezave, të cilat Kola i njofti një nga një tue i kërkue, e pak nga shpirti i tij asht futë, asht ngjitë, asht ngjeshë nëpër paçavra të ndyeta dhe mshisa të lagta. Atje n'at tryezë - i kujtohej Kolës - kishte gjithmon ma shum bishta cigaresh dhe gjithmon mbi të ose ishte zhgarravitun diçka e pakuptueshme, ose vizatuem ndoj ftyrë, ndoj trup grueje me tjera. E ai mbasi e shikonte mirë e mirë, e hapte paçavrën e lagtë dhe me aq fuqi e fërkonte, saqë tryeza lonte vendit. Duhej mshi mirë se qortimi i kërcnueshëm i zoti Filipit nuk mungonte. Pesë vjet kësi pune. Dhe mandej në rrugë të madhe. Po as zoti Filipi s'ka faj. Punë s'ka. - Po kush ka faj? - Askush. Nana që më lindi, - mendonte Kola. Paskam qenë i tepërm në kët botë - unë me shokët e mi që apim të gjitha fuqitë e veta për një krodhe buke - dhe këto fuqitë tona askuej s'i duhen.

.....
Pse të mos qaj? Po fort! - mendonte Lili me vete.

- Pse s'më nep, pra, bukë të bardhë? E, pse s'më nep?- i sillej s'amës, e cila i kish mendët e

humbuna - dhe vazhdonte të qajë.

Pau e ama se si Lili u zverdh si drita e bishtukut e ethet nuk po e lenë. Dhe e dinte se duhet me thirrë mjekun, me ble barna, me i ba Lilit minestër për me hangër, me pimë limonadë në vend t'ujit kur ka zjarmi, me u veshë trashë kur del përjashta, të gjitha këto i din e ama e Lilit, i ka msue te zotnia kur, si vajzë ishte shërbëtore, por...

Dhe një ditë, kur Lilin, mbas etheve të forta e zu gjumi, e ama e ndryni shtëpinë dhe shkoi te grueja që i kish dhanë uha dhetë lekë. Shkoi shpejt, pa kthye djathtas e majtas dhe pa u mendue ma gjatë, por me vendim të premë, si dhe burri i saj, për me gjetë të hollat e nevojshme që i duheshin për mjekimin e Lilit.

Për pyetjet 20-22 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

MATURA SHTETËRORE

20. Çfarë trajton në këtë prozë Migjeni?

1 pikë

- A) Ironinë dhe mllefin personal.
- B) Njeriun, në kushtet e mbijetesës.
- C) Reagimin shoqëror kundër mjerimit.
- D) Revoltën individuale kundër sistemit të padrejtë.

21. Në fjalinë: “E për pesë vjet trajtat e të gjitha këtyne sendeve lanë vragë të pashlyeshme.” fjala **vragë** ka kuptimin:

1 pikë

- A) dhimbje,
- B) humbje,
- C) ngjyra,
- D) shenjë.

22. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan më mirë natyrën e Kolës në këtë fragment?

1 pikë

- A) Ai është i gatshëm të punojë për të dëshmuar vlerat që ka.
- B) Ai shpreson se dikush mund ta ndihmojë.
- C) Ai ndihet i pafuqishëm përballë situatës në të cilën ndodhet.
- D) Ai vepron me zemërgjerësi në raport me të tjerët.

23.

a) Identifikoni një detaj, në pjesën e dytë të këtij fragmenti, që dëshmon modestinë e jetesës në familjen e Kolës dhe shpjegoni pse ju duket i tillë.

2 pikë

Detaji: _____

Shpjegimi: _____

b) Cila është një nga të veçantat e **sintaksës poetike** në fjalinë: “... e pak nga shpirti i tij asht futë, asht ngjitë, asht ngjeshë nëpër paçavra të ndyeta dhe

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

mshisa të lagta”? Interpretoni forcën e shprehësisë që fiton fjalia përmes këtij përdorimi. **2 pikë**

E veçanta: _____

Interpretimi: _____

24.

a) Nëna e Lilit është e paemër, ajo quhet thjesht e **ama e Lilit** (dhe përgjatë novelës ajo quhet *grueja*). Ç’funktion artistik ka kjo zgjedhje? **1 pikë**

b) Identifikoni dy të dhëna në këtë fragment që paralajmërojnë për vendimin që do të marrë gruaja më vonë. Pse mendoni se ato janë vendimtare? **3 pikë**

25. Kola dhe e shoqja janë konsideruar nga kritika si dy figura tragjike. Bazuar në fragmentin e dhënë, shpjegoni se ku qëndron thelbi i tragjizmit tek ata. **2 pikë**

Homeri

Iliada – Kënga XXIV (fragment)

MATURA SHTETËRORE

Karroca me trupin e Hektorit arrin në Kalanë e Trojës. E para që e shikon, është Kasandra, një nga bijat e Priamit.

I plasi vaji e vuri ulërimën,
duke u lëshuar përmes gjithë qytetit:
“Trojës e trojane, ecni e shihni Hektorin,
ju që dikur kreshnikut para i dilnit,
dhe ju gufonte zemra prej gëzimit,
kur gjallë ai kthehej nga beteja e gjakshme,
pse ishte mburrja e fisit dhe e qytetit”.
Kështu thërriste e askush n’qytet nuk mbeti,
as burrë, as grua, të gjithë u pikëlluan,
i madh e i vogël jashtë prej porte u derdhën,
për t’i dalë para Priamit me kufomën.
E mira grua dhe nëna e përnderuar
në krye të gjithëve përmbi qerre u turrën,
dhe shkulnin leshrat duke i puthur kokën,
dhe turma rrotull me dënësë vajtonte.
Të tërë atë ditë gjersa të falej dielli,
duke derdhë lot do të vajtonin burrin
përpara portash mos t’u fliste Priami
lart prej koçie turmave të popullit:
“Lëshomëni rrugën, të kaloj me mushkë,
me vaj e gjëmë ju keni për t’u ngopur,
sapo ta shpie në saraj tim kufomën.”
Foli, dhe u hapën e i bënë rrugë karrocës,
E, kur mbërritën në shtëpinë mbretërore,
vendosën trupin në një shtrat të gdhendur,
Të kryet e shtratit i vunë gjëmataret,
që zunë përvajshëm këngën e përmotshme.

Për pyetjet 26-28 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

26. Në ç’mënyrë vdes Hektori?

1 pikë

- A) E goditi një shigjetë, kur ishte në krye të ushtrisë.
- B) E goditi perëndesha e arsyes dhe mbrojtësja e arteve, Athinaja.
- C) E vrau Akili, heroi grek.
- D) E vrau Patrokli, luftëtar dhe mik i Akilit.

27. Kur Kasandra thotë: “*dhe ju gufonte zemra prej gëzimit*”, me fjalën **gufonte** ajo ka parasysh:

1 pikë

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- A) çmendej,
- B) mpihej,
- C) pushonte,
- D) rrihte.

28. Pse Priami, kur vjen trupi i pajetë i Hektorit, i ndalon njerëzit që ta qajnë atë?

1 pikë

- A) Dëshiron që atë ta qajë vetëm familja e tij.
- B) Kërkon që ai të respektohet siç i ka hije, brenda pallatit.
- C) Nuk dëshiron të dëgjojë vaj dhe ulërime.
- D) Nuk do që grekët të dëgjojnë vajin trojan.

29. Çfarë tregon mënyra se si pritet trupi i pajetë i Hektorit, në lidhje me raportin që ai ka patur me popullin?

1 pikë

30. Komentoni dy vargjet e para të këtij fragmenti dhe tregoni në ç'mënyrë ato përcaktojnë tonin e të gjithë pjesës.

3 pikë

31.

a) Gjeneroni në fragmentin e dhënë dy vargje që krijojnë kontrast midis tyre. **1 pikë**

b) Identifikoni në këtë pjesë një rit të respektimit të të vdekurit. **1 pikë**

32. Bazuar në këtë skenë si dhe në veprën në tërësi, a mendoni se Hektori e arriti lavdinë e tij? Argumentoni mendimin tuaj.

2 pikë

33. "Iliada" është një poemë epike. Çfarë fiton ajo nga kjo formë rrëfimi, në krahasim me rrëfimin në prozë?

2 pikë

34. Në pjesën "**Pëshpërime e tokës**" autori ka krijuar një komunikim të veçantë me natyrën, gjë që shpaloset që në titull.

MATURA SHTETËRORE

Vendoseni veten në një situatë komunikimi me natyrën. Cilat janë fjalët që ajo "ju pëshpërit"? Përshkruani marrëdhënien tuaj me natyrën që ju rrethon.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (34a)	Organizimi dhe struktura (34b)	Stili dhe origjinaliteti (34c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (34d)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë

Kurrikula e vjetër

PJESA I

Koha

[1] “Do të dëshiroja të kisha më tepër kohë.”

“Sa pak orë ka dita!”

“Nuk kam kohë!”

Sa herë i keni dëgjuar këto fjalë? Sa herë ia keni përsëritur vetes? A nuk jemi të gjithë duke kërkuar pak më shumë kohë?

[2] Imagjinoni se si do të kishte qenë java që shkoj, nëse do të kishit pasur pak më tepër kohë, le të themi tridhjetë orë. Nëse do të kishit pasur këto orë shtesë, mund të kalonit më shumë kohë me miqtë dhe njerëzit e familjes. Mund t'i merrnit pak më qetë detyrat e shkollës, pasi do të kishit më tepër kohë për t'i bërë ato. Ju mund të kishit bërë kaq shumë gjëra që kishit menduar t'i bënit, nëse do të kishit pasur pak më shumë kohë. Mund të nisnit një veprimtari të re, të lexonit librat për të cilët keni dëgjuar kaq shumë, të bënit ndonjë ekskursion apo diçka tjetër. Dhe, me tridhjetë orë të tjera shtesë, ju mund të kishit kursyer kohë.

[3] Tridhjetë orë shtesë duken si ëndrra të bukura në diell, por janë tuajat nëse i merrni. E vetmja gjë që duhet të bëni, është të shuani televizorin gjatë javës. Javën tjetër është *Java pa televizor*, një lëvizje mbarëkombëtare, e cila synon të nxisë njerëzit të shqyrtojnë të gjitha mundësitë e përmirësimit të kohës së nevojshme. Nëse merrni pjesë në këtë lëvizje, ju do të keni javën tjetër tridhjetë orë shtesë.

[4] Një adoleshent shpenzon një sasi të jashtëzakonshme kohe duke ndjekur televizorin. Sipas një studimi, një adoleshent shpenzon rreth katër orë e gjysmë duke parë televizor çdo ditë. Kjo do të thotë se, në një javë, ai shikon televizor rreth tridhjetë orë e gjysmë. Në një vit, ky total arrin në 1642 orë. Pra në një vit, janë 68 ditë, më shumë se dy muaj, që shpenzohen përpara televizorit.

[5] Edhe pse televizori është bërë kaq dominues në shoqërinë tonë, sërish shumë njerëz nuk shqetësohen për të parë pasojat e shpenzimit të kaq shumë orëve përpara tij. Megjithatë, ka pasur kërkime pafund për të studiuar pasojat e televizorit. Rezultatet janë mjaft të qarta. Njerëzit që kalojnë shumë kohë para televizorit, mund të kenë shqetësime gjatë gjumit. Ndoshta për shkak të kësaj, nxënësit që shohin më shumë televizor, priren të kenë nota më të dobëta, se ata që shohin më pak. Për shkak të dhunës që përhapet virtualisht në çdo program televiziv, njerëzit shpesh bëhen të pandjeshëm ndaj saj. Dhe më e rëndësishmja, televizori është një nga faktorët që ndikon shumë në rritjen e obezitetit.

[6] Megjithatë, unë besoj se ndikimi më negativ i televizorit është koha që ai “vjedh” nga ne. Koha që kalojmë para tij, është një kohë që e humbasim përgjithnjë dhe asgjë nuk mund të na e rikthejë më. Ajo është një kohë që nuk e kalojmë me miqtë dhe familjen. Është një kohë që nuk e kalojmë duke ndjekur ëndrrat dhe qëllimet. Është një kohë që nuk e kalojmë duke mbrojtur shëndetin tonë përmes

krijimit të një stili jete. Çdo minutë e investuar për të ndjekur këto qëllime dhe ëndrra do të na shpërblehet, pasi në të ardhmen do të kemi një shoqëri më të fortë, jetë më të mirë dhe trupa më të shëndetshëm.

[7] Shumë njerëz kanë frikë se, pa televizor, do të mërziten. Ata pyesin: “Çfarë mund të bëjmë në darkë pa televizor?” Këta njerëz shpesh harrojnë se televizori është bërë një burim kënaqësie vetëm këto gjashtëdhjetë vitet e fundit. Për mijëra vjet, njerëzit gjithnjë kanë gjetur mënyra argëtimi. Ata kalonin kohën me miqtë dhe familjen, lexonin libra, i binin veglave muzikore dhe merreshin me art, luanin dhe kalonin shumë kohë jashtë në natyrë. Ata gjenin mënyra të këndshme për të kaluar kohën, por edhe sot ne kemi shumë mundësi për ta bërë këtë. E vërteta është se kjo kërkon më shumë energji sesa dikur. Megjithatë, përfshirja në një veprimtari që ju pëlqen, do t’ju jepte më shumë energji se sa çdo program televiziv që do të ndiqnit.

[8] Duke u bërë pjesë e *Javës pa Televizor*, ju mund të eksploroni mundësitë e një jete që nuk zotërohet nga programet komerciale. Në vend që të shikoni programe të tilla, dilni jashtë dhe shijoni natyrën. Merruni me kopshtari ose bëni një shëtitje të gjatë nëpër kodrat rrotull. Në vend që të shikoni këngëtarët apo kërcimtarët e fundit, është më mirë të merrni disa mësimë vallëzimi apo kënge ose të ndiqni një shfaqje në skenë. Mos e ndiqni atë program gatimi, por krijoni diçka nga imagjinata juaj. Në vend që të shikoni finalen e basketbollit, bëni një ndeshje të tillë me miqtë tuaj ose merruni më një sport të ri. Në vend që të ndiqni dramën njerëzore në një telenovelë, bëni një bisedë me familjen. Dëgjoni historitë e tyre, komeditë dhe dramën e vërteta që ata kanë. Duke e mbyllur televizorin për shtatë ditë, ju do të zbuloni se përfshirja në jetë është shumë më interesante se të parët e një versioni të saj në televizor.

Për pyetjet 1-7 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

1. Cila nga fjalitë e mëposhtme mbështet **tezën** e këtij fjalimi? **1 pikë**

- A) Shumë njerëz kanë frikë se, pa televizor, do të mërzhiten.
- B) Megjithatë, ka pasur kërkime pafund për të studiuar pasojat e televizorit.
- C) Javën tjetër është *Java pa televizor*, një lëvizje mbarëkombëtare, e cila synon të nxisë njerëzit të shqyrtojnë të gjitha mundësitë e përmirësimit të kohës së nevojshme.
- D) Duke e mbyllur televizorin për shtatë ditë, do të zbuloni se përfshirja në jetë është shumë më interesante se të parët e një versioni të saj në televizor.

2. Cila nga fjalitë e mëposhtme hedh poshtë argumentin kryesor të autorit? **1 pikë**

- A) Disa programe televizive janë edukuese dhe sfiduese.
- B) Televizori është bërë dominues në jetën tonë.
- C) Televizori ndikon tek disa njerëz më shumë se tek disa të tjerë.
- D) Adoleshentët e ndjekin televizorin për të ulur nivelin e tensionit dhe të ankthit.

3. Cila nga fjalitë e mëposhtme jep informacion më të besueshëm mbi ndikimet negative të televizorit? **1 pikë**

- A) Njerëzit që kalojnë shumë kohë para televizorit, mund të kenë shqetësime gjatë gjumit.
- B) Ndoshta për shkak të kësaj, nxënësit që shohin më shumë televizor, priren të kenë nota më të dobëta se ata që shohin më pak.
- C) Dhe më e rëndësishmja, televizori është një nga faktorët që ndikon shumë në rritjen e obezitetit.
- D) Koha që kalojmë para tij, është një kohë që e humbasim përgjithnjë dhe asgjë nuk mund të na e rikthejë më.

4. Cila është arsyeja që autori trajton një çështje të tillë në fjalimin e tij? **1 pikë**

- A) Televizori është një shpikje relativisht e re.
- B) Televizori ndikon në pjesët më të rëndësishme të jetës.
- C) Njerëzit dëshirojnë të kenë më shumë kohë të lirë.
- D) Njerëzit janë të pavëmendshëm ndaj zakoneve të tyre të të shikuarit.

MATURA SHTETËRORE

5. Bazuar në informacionin e dhënë, në cilin nga konkluzionet e mëposhtme përdoret në mënyrë të saktë arsyetimi deduktiv? **1 pikë**

- A) Meqenëse njerëzit e kanë argëtuar veten pa televizion për mijëra vjet, atëherë edhe ne mund ta argëtojmë veten pa televizor.
- B) Meqenëse shumë shfaqje televizive paraqesin dhunën, ndjekja e çdo shfaqjeje televizive do t'i bënte njerëzit të pandjeshëm ndaj dhunës.
- C) Meqenëse çdo adoleshent shikon tridhjetë orë televizor çdo javë, çdo adoleshent që do të ndalonte së pari televizor, do të fitonte tridhjetë orë si kohë e lirë.
- D) Meqenëse nxënësit që shikojnë shumë televizor, marrin nota të dobëta në shkollë, çdo nxënës që merr nota të dobëta në mësim, shikon shumë televizor.

6. Përgjatë këtij fjalimi, duhet të ketë qenë shumë e rëndësishme për autorin të tërhiqte vëmendjen e auditorit edhe përmes: **1 pikë**

- A) përdorimit të gjesteve dramatike.
- B) leximit të drejtpërdrejtë të shënimeve të tij.
- C) shmangies së kontaktit me sy.
- D) përshtatjes së ritmit të të folurit.

7. Si do të ndryshonte kjo pjesë, nëse do të shkruhej në vetën e tretë njëjës? **1 pikë**

- A) Ajo do të përmbante më pak detaje rreth të rinjve.
- B) Ajo do të kishte një përmbajtje më pak emocionale.
- C) Ajo do të përfshinte më shumë informacion rreth autorit.
- D) Ajo do të fokusohet më shumë tek dëmet që shkakton televizori.

8. Identifikoni në pjesën e dhënë dy nga pasojat negative, të provuara me fakte, që shkakton qëndrimi i tepruar përpara televizorit. **2 pikë**

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

9. Çfarë ka të veçantë mënyra se si fillon ky tekst? Shpjegoni arsyen e këtij përdorimi. **2 pikë**

E veçanta: _____

Arsyeja: _____

10. Gjeni në paragrafin [4] dy momente ku sillen elemente të tekstit informues. Cili është funksioni që luajnë ato? **3 pikë**

Momentet: _____

Funksioni: _____

11. Sipas mendimit të autorit, cili është dëmi më i madh që na shkakton televizori? Pse? **2 pikë**

12.
a) Bazuar në tekstin e dhënë, shpjegoni pse shumë njerëz e përjetojnë me frikë mungesën e televizorit. **2 pikë**

- b) Çfarë do të thotë të krijosh, sipas autorit, një stil unik jete? Pse është kaq i rëndësishëm ai për jetën e njerëzve? Mbështeteni përgjigjen tuaj edhe me ilustrime nga pjesa. **3 pikë**

PJESA II

Petro Marko

Nata e Ustikës (fragment)

Bukaporta u hap. Ne u ngritëm në këmbë, kthym kokat lart e pamë qiellin plot dritë. Pamë shumë ushtarakë e marinarë që na dukeshin... - si dukeshin ashtu? Këmbë të mëdha e kokë të vogla... sikur ishin gati për të na shtypur... Pamë litarin dhe direkun... Po ç'thoshin? Qeshnin me ne që u dukeshim si miza?

Pritëm e pritëm. Heshtjen tonë e prishi lloja:

- Këtu kushedi se ku jemi e kushedi ku do na shpien... Lart kokën, si shqiptarë që jemi...

Vinçi me magjen e madhe në formë vagoni minierash u fut në bukaportë, u ul poshtë gjer në

dyshe-menë e hambarit tonë. Ne bëmë mënjanë. Zbritën me të shpejtë nga shkalla disa karabinierë.

Na urdhëruan të futeshim në atë magje. Ne ngurruam. Po ata na kërcënuan e na thanë se ashtu do të dilnim më kollaj. Me njëmijë mundime u futëm, gati njëri mbi tjetrin. Ata lart vazhdonin të qeshnin.

Vinçi ngrihej. Ne tundeshim në erë. Iu afruam bukaportës. Pastaj na kthyen nga bankina. E, kur ishim mbi bankinën, na lanë aty në erë.

Përposh nesh britma. Hodha sytë, e, ç'të shikoje! Mijëra njerëz me grusht na kërcënonin.

- Spie! Spie!
- A morte le spie che hanno causato miliaia di morti.
- Traditori! Spie di un cane!

Po kjo? Ç'është kjo pritje në tokën italiane? Ne vareshim në erë e lëkundeshim si kufoma e

Hamidit...

Një fishkëllimë e gjatë bilbili... Turma sikur deshi të na hante. Po ja që ne ishim lart. Vareshim e tundeshim në ajër.

- Pushoni! Pushoni...- Vala zemërake e turmës sikur ra në bunacë. – Pushoni! Këta shqiptarë të

mallkuar, këta banditë, këta spiunë na morën në qafë... Morën më qafë mijëra e mijëra bij të Italisë, se kapërcenin vijën e parë e i tregonin grekut pozitat tona... Pastaj na sulmonin nga shpina..., - bërtiste me sa kishte në kokë një oficer aty mbi vapor.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Ata poshtë sikur do të na hanin me dhëmbë. Ne lart këndonim. I pari ia nisi lloja:

Avanti, popolo,
alla riscossa
bandiera rossa
triumfera.

Kënga ngrihej më lart se ne. Përhapej më tej vaponit nga shikonim si të shastisur. Turma kishte heshtur e na shikonte gjithashtu si e shastisur....

Ne tundeshim në erë duke kënduar.

Për pyetjet 13-18 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

13. Në këtë fragment, përballja me një trajtim të tillë çnjerëzor i çon të burgosurit shqiptarë drejt: **1 pikë**

- A) bjerrjes së vlerave të tilla, si: dashuria, dhimbja, mirëkuptimi.
- B) dramës së depersonalizimit dhe nënshtrimit ndaj kundërshtarit.
- C) qëndresës individuale heroike përballë dhunës së kundërshtarit.
- D) rezistencës solidare ndaj formave të tilla të dhunës.

14. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar në **vetën I shumës?** **1 pikë**

- A) Hodha sytë, e, ç'të shikoje!
- B) Ata lart vazhdonin të qeshnin.
- C) Vala zemërake e turmës sikur ra në bunacë.
- D) Me njëmijë mundime u futëm, gati njëri mbi tjetrin.

15. Cila nga fjalitë e mëposhtme ndërtohet mbi figurën e elipsës? **1 pikë**

- A) Pritëm e pritëm.
- B) Vinçi ngrihej.
- C) Përposh nesh britma.
- D) Po ç'thoshin?

MATURA SHTETËRORE

16. Në fjalinë: “Përhapej më tej vaporit nga shikonim si të shastisur”, fjala të **shastisur** ka kuptimin: **1 pikë**

- A) të bezdisur,
- B) të trullosur,
- C) të mërzhitur,
- D) të lënduar.

17. Të burgosurit shqiptarë, të varur mbi majën e anijes, dhe turma që mallkon, kanë të përbashkët: **1 pikë**

- A) fatin: ata janë njëlloj viktime, përballë një lufte të pakuptimtë.
- B) kombësinë: ata janë të kombësisë shqiptare.
- C) mënyrën e trajtimit: edhe njerëz të tjerë nga turma do të trajtoheshin po njësoj.
- D) ndëshkimin: të dy palët do të vdisnin nga e njëjta mënyrë ekzekutimi.

18. Në cilën nga alternativat e mëposhtme kemi një metaforë mbiemërore?

1 pikë

- A) Hanin me dhëmbë.
- B) Vala zemërake.
- C) Qeshnin me ne.
- D) Magjen e madhe.

19. Në një moment, të burgosurit ngurrojnë të lëvizin.

Cilat janë dy nga arsyet që e nxisin këtë reagim?

2 pikë

20. Identifikoni një rast ku shfaqet antiteza mes veprimeve të turmës dhe të të burgosurve.

Cila është vlera e këtij kontrasti?

2 pikë

Antiteza: _____

Shpjegimi: _____

21.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- a) Në mbyllje të fragmentit, lloja shpërthen në një këngë, e cila ndiqet edhe nga të burgosurit e tjerë.

Cila është arsyeja e këtij reagimi?

1 pikë

- b) Këngën e fillon i pari lloja. Ç'tregon kjo për karakterin e tij? Pse ai këndon në gjuhën italiane?

Ku e gjen ai fuqinë për të reaguar në këtë formë, në rrethana tejet të pafavorshme për të?

3 pikë

22. Zbuloni në fragment një rast të përdorimit të pyetjes retorike. Shpjegoni gjendjen shpirtërore të personazhit, që shpaloset përmes saj. Çfarë fiton pjesa përmes kësaj ligjërate komunikimi me lexuesin?

3 pikë

Shembulli: _____

Shpjegimi: _____

Vlera: _____

23. Cilës pjesë të ligjëratës i takon fjala që mban peshën kryesore në fjalinë: “*Ne tundeshim në erë*”?

Interpretoni imazhin e përftuar përmes përdorimit të saj.

2 pikë

Pjesa e ligjëratës: _____

Interpretimi: _____

24. Zbërtheni nëntekstin e fjalisë: “*Kënga ngrihej më lart se ne*”. Ç’domethënie merr raporti krahasues që vendoset mes këngës dhe të burgosurve (ne)?

2 pikë

SEKSIONI 4

**SKEMAT TË VLERËSIMIT TË TESTEVE TË
MATURËS SHETËRORE NË VITE**

(2011-2019)

MATURA 2011

PJESA I

Lasgush Poradeci

Kënga pleqërishte

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Për poetin procesi i krijimit është i dhimbshëm dhe i mundimshëm, pasi dhimbja e krijimit buron nga përkushtimi për artin. Akti i krijimit është shumë i bukur por edhe i dhimbshëm në të njëjtën kohë.
- Për poetin dhimbja prodhon të bukurën, poezinë dhe kjo e fundit është pjesë e shpirtit të tij. Shkëputja e një cope shpirti është njëkohësisht dhimbje dhe kënaqësi. Është një proces që kërkon shumë mund, përkushtim dhe mbi të gjitha dashuri.
- **Ilustrime:** *Mjerimi-i vetvetes të thjevi mes për mes:* Këtu vuajtja del në shkallën më të lartë, një vuajtje madhështore që lidhet me misionin e poetit.
- Detaje të tjera mbështetëse: *të thjevi dhembja jote, si lot i përvëlur..., më bën ujëm!*
ti ngrihesh dyke vuar, vaj, lot i zi, mall, psherëtimë.

1 pikë Nëse shpjegon pse poeti e përjeton procesin krijues shumë të dhimbshëm e të mundimshëm.

DHE

1 pikë Nëse e ilustron mendimin me detaje nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 8

3 pikë

Model përgjigjeje

- Poeti njëjtësohet me këngën. Ai ka nevojë për të pasi ajo është burim frymëzimi dhe modeli mbi të cilin ndërtohet poezia e tij. Kjo shfaqet që në vargun e parë: (*O këngë pleqërishte! Ti vjersh' e Vendit t'em!*) Kjo lidhje është në fakt një identifikim i poetit me vendin, me qenësinë e tij.
- *Rëndësia*: poeti identifikohet me të dhe thekson vlerën e saj, sepse e di se, pa të, nuk do të ekzistonte as kënga e tij origjinale. Thirrjet: *këngë, vjershë, mall, psherëtimë, vaj, shpirt i përvëluar*, janë pikërisht shembull i frymëzimit personal të kënga pleqërishte.
Kjo këngë është bërë kënga e re e vetë poetit.

2 pikë

Nëse shpjegon plotësisht lidhjen midis poetit dhe këngës pleqërishte.

OSE

1 pikë

Nëse shpjegon pjesërisht lidhjen midis poetit dhe këngës pleqërishte.

DHE

1 pikë

Nëse tregon rëndësinë që kënga pleqërishte ka për poetin.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Pyetja 9 **3 pikë**

Model përgjigjeje

Faza e ngjitjes: *Pastaj fillon të ngrihesh, e nis e ja thërret*

OSE *Rënkimi –i zemrës s’ate ronitet më të ngjitur...*

Pika kulmore: *që nga lartësira ku vate fluturoj...,*

Faza e zbritjes: *Me sulm e ulërimë këputet si përroj... e rrjedh tatëpjetë*

OSE *Pastaj të shuhet zëri...e rrihesh... edhe vdes:*

1 pikë Nëse gjen vargun që shënon fazën e ngjitjes.

1 pikë Nëse gjen vargun që shënon pikën kulmore.

1 pikë Nëse gjen vargun që shënon fazën e zbritjes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **2 pikë**

Model përgjigjeje

• **Metafora emërore:** *këngë pleqërishte, mall, psherëtimë, vajë, lot,...*

• **Epitet metaforik:** *shpirt i përvëluar, këngës magjiplotë, zë të përpalitur, dëshir’ e varfëruar.*

1 pikë Nëse gjen një metaforë emërore.

1 pikë Nëse gjen një epitet metaforik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

MATURA SHTETËRORE

Pyetja 11 2 pikë

Model përgjigjeje

- Detaj që krijon efekt pamor: *mal, lartësi, hije e kasolles, fluturon përroi, breshër, kulmit, qielluar.*
- Detaj që krijon efekt dëgjimor: *zë të shtruar, me të qarë, mërmëruar, më të ngjirur, ulërimë, shuhet zëri, thërret.*

1 pikë Nëse gjen në poezi një detaj që krijon efekt pamor.

1 pikë Nëse gjen në poezi një detaj që krijon efekt dëgjimor

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Nxënësi nuk do të marrë pikë, nëse detajet e gjetura nuk krijojnë efekte të tilla.

Pyetja 12 2 pikë

Model përgjigjeje

- Mënyra urdhërore.
- ***Funksioni:*** Në këtë përdorim ndihet qartë një thirrje, një përgjërim, një lutje, që kënga të dëgjohet kudo, të përhapet kudo.

1 pikë Nëse gjen mënyrën urdhërore.

1 pikë Nëse shpjegon funksionin e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 13 3 pikë

Model përgjigjeje

- **Figura e stilistikës:** krahasim i zgjatur, similitudë.
- **Interpretimi:** Kënga pleqërishte është bërë këngë e poetit, gjiri i saj është zemra; ajo del nga fundi i zemrës, ngrihet dhe kthehet në thellësinë e saj, për t'u bërë përfundimisht këngë e zemrës. I gjithë ky fenomen është dhënë përmes përqasjes me lëvizjen e valës së detit, e cila del nga thellësitë e detit (zemra e detit) dhe ngrihet përpjetë, për t'u përplasur sërish në thellësitë e tij.

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës.

DHE

2 pikë Nëse interpreton në mënyrë të plotë nëntekstin e këtij përdorimi.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në mënyrë të pjesshme nëntekstin e këtij përdorimi, pra tregon vetëm imazhin e krahasimit me dukurinë e natyrës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

PJESA II

Balzak

Evgjeni Grande

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	C	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

Pyetja 21 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Zakone që dëshmojnë jetën që Evgjenia bën:

- *Zjarrin e ndez vetëm ato ditë që e lejon i ati,*
- *Vazhdon të vishet si e ëma,*
- *Shtëpia e saj, pa diell, pa ngrohtësi, e zymtë, e zbrazët,*
- *Në atë zemër nisi të rëndonte pesha e interesit dhe e llogarive,*
- *Zjarrin e shuan sipas programit të ditëve të çupërisë së saj.*

2 pikë Nëse gjen dy zakone të vjetra, që tregojnë jetën që ajo bën.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një zakon të vjetër, që tregon jetën që ajo bën.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë kur citon momente nga fragmenti ose kur parafrazon.

Pyetja 22 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- a) Ndryshimi më i madh midis Evgjenisë dhe të atit qëndron se Evgjenia ka shpirt fisnik, bujar, ndihmon të tjerët dhe kryen shumë vepra bamirësie.
- b) Tipari dallues i mjedisit në të cilin jeton Evgjenia është: provincializmi, të marrurit me jetën të tjerëve, thashethemet, jeta e mbyllur.
- c) Evgjenia i përkushtohet shumë bamirësisë, pasi e ka në natyrën e saj të ndihmojë të tjerët.

OSE

- Evgjenisë pasuria nuk i solli asgjë të mirë në jetë, asaj s'i bën më përshtypje ajo, nuk është qëllimi i jetës së saj, ndaj e përdor për qëllime fisnike.

OSE

- Evgjenia i është përkushtuar bamirësisë për të harruar dramën e saj, humbjen e dashurisë. Gjen ngushëllim në veprën që bën.

OSE

- Ai ar i solli shumë trishtim në jetë, ndaj është më mirë ta përdorë të paktën në mënyrën e duhur.

1 pikë Nëse tregon ku qëndron ndryshimi midis Evgjenisë dhe të atit.

1 pikë Nëse tregon një tipar dallues të mjedisit ku jeton Evgjenia.

1 pikë Nëse shpjegon pse Evgjenia i përkushtohet kaq shumë bamirësisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Figura e stilistikës: epiteti (*buzëplasur, zëri i saj i ëmbël, i butë; sjelljet e saj të thjeshta; zakonet bajate; e shkreta Evgjëni; koprrace dhe zemërngushtë; zemër fisnike etj.*)

Pjesa e ligjëratës: mbiemri

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës, bashkë me shembullin ilustrues.

1 pikë Nëse gjen pjesën e ligjëratës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (a) 3 pikë

Model përgjigjeje

Drama e madhe e jetës së Evgjëni Grandesë qëndron në faktin se ajo humbi gjithçka në këtë jetë: dashurinë dhe të qenit nënë. Mjedisi i shkatërroi dëshirat dhe ëndrrat e saj. Në fillim ajo humbi dashurinë e jetës, më pas, martesën me interesin e shkatërroi përfundimisht ëndrrat e saj. Ajo mbetet e vetme në këtë jetë, pa askënd pranë që ta kuptojë dhe dojë, si grua, nënë dhe bashkëshorte.

Ilustrimi: *Kjo është historia e kësaj gruaje, e cila, ndonëse jetoi në këtë botë, nuk ish për këtë botë. Ajo që lindur për të qenë grua e shkëlqyeshme dhe nënë; dhe tashti s'ka as burrë, as familje, as fëmijë.*

Vajza buzëplasur dhe e vetmuar,

Zoti e rrethoi robëreshën e tij me thasë plot me florinj.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë dramën e jetës së Evgjëni Grandesë.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht dramën e jetës së Evgjëni Grandesë.

DHE

1 pikë Nëse i mbështet mendimet me ilustrime nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 24 (b) 2 pikë

Përgjigje e lirë

Nxënësi duhet të tregojë ndjesinë që i shkaktoi ky fragment (dhimbje, keqardhje, etj).

Nxënësi duhet të shprehë mendimin e parë që i lind, sapo e mbaroi së lexuari fragmentin, por që lidhet me thelbin e fragmentit ose të romanit.

1 pikë Nëse tregon ndjesinë që i lindi nga leximi i fragmentit.

1 pikë Nëse shkruan mendimin e parë që i lindi kur e përfundoi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton nëse do t'ia rekomandonte ose jo një miku ta lexonte romanin "Evgjeni Grande",
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra,
- përdor detaje mbështetëse,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:

hyrjen zhvillimin përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë
(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

MATURA 2012

PJESA I

Arti i Optimizmit

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Fjalët kyç: optimizmi – pesimizmi

Mjeti gjuhësor: antonimi

1 pikë Nëse zbulon dy fjalët kyç.

DHE

1 pikë Nëse tregon mjetin gjuhësor që realizon këtë kundërvënie.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 8 **1 pikë**

Model përgjigjeje

➤ Natyrën tonë si optimiste apo pesimiste e përcakton **këndvështrimi** që kemi.

OSE

➤ Nëse dikush është optimist apo pesimist varet nga *prirjet apo dëshira e gjithsecilit ose pjesërisht nga tipi* (perifrazim).

1 pikë Nëse tregon se çfarë e përcakton natyrën tonë si optimiste apo pesimiste.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **3 pikë**

Model përgjigjeje

Lloji i tekstit: udhëzues, shpjegues

Karakteristikat gjuhësore:

- foljet në mënyrën urdhërore,
- foljet në mënyrën lidhore,
- përdorimi i vetës II, (njëjës),
- gjuha standarde, e qartë dhe e thjeshtë,
- leksiku i jetës së përditshme,
- përdorimi i foljes me vlerë modale **mund**, e ndjekur nga folja në mënyrën lidhore.

1 pikë Nëse gjen llojin e tekstit (udhëzues, ose shpjegues, ose të dyja bashkë).

DHE

2 pikë Nëse zbulon dy karakteristika gjuhësore, tipike për këtë lloj teksti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **8 pikë**

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se cili nga përfundimet e autorit përafrohet më shumë me pozicionin e vet, në lidhje me të qenit optimist apo pesimist,
- mban qartë një pozicion të dukshëm, por bazuar në pjesën e dhënë,
- përdor detaje mbështetëse, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

1 pikë **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 hyrjen,
 zhvillimin,
 përfundimin.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë**
(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

PJESA II

Sharl Bodler		<i>Albatrosi</i>
Pyetja 11	B	1 pikë
Pyetja 12	A	1 pikë
Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë

Pyetja 15 2 pikë

Model përgjigjeje

Albatrosi si simbol:

- Albatrosi simbolizon natyrën e dyfishtë të çdo qenie njerëzore, që është: ***çdo njeri mbart në vetvete si cilësitë pozitive ashtu edhe ato negative (si mbartës i mëkatit fillestar).***

Vargu:

- *Të shëmtuar, po dikur aq të bukur në k'të bot'!*

1 pikë Nëse përcakton se ç'simbolizon albatrosi.

DHE

1 pikë Nëse zbulon vargun ku shfaqet thelbi i këtij simboli (vetëm vargu i dhënë më sipër).

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 16 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

Dy motivet kryesore:

- shëmtia dhe bukuria e jetës,
- mizoria.

2 pikë Nëse identifikon dy motivet bazë të poezisë.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një motiv.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 (b) 1 pikë

Analiza

Motivi I: ***shëmtia dhe bukuria e jetës***

- Kur fluturon në qiell, albatrosi të huton me madhësinë, hijeshinë dhe bukurinë e tij. Kur zbret në tokë ose në anije (si në poezi), ai ecën në mënyrë qesharake, lëkundet majtas e djathtas si një i pirë dhe në këtë mënyrë bëhet objekt i përqeshjes. Kur poeti shkruan vargjet e tij të frymëzuara, “*që ngjiten lart në qiell*”, hijeshia dhe bukuria e tyre e mrekullojnë lexuesin që e njuh dhe e ndjen poezinë (njeriun e kulturuar dhe të arsimuar). Por kur poeti prek tokën dhe e vendos veprën e tij në duart e dokujtudo, këtij të fundit poeti i duket i çuditshëm, i paqartë, që edhe kur ecën “*lëkundet*”. ***Në këtë moment, ai bëhet si albatrosi: qesharak, i shëmtuar dhe i përqeshur.***

Motivi II: ***mizoria***

- Ka njerëz që injorojnë dhe mohojnë mirësinë të njeriut (ose kafshës) dhe përqendrohen në anën e dobët apo të keqe, me qëllim që të shprehin mizorinë përmes përqeshjes dhe talljes. Ka nga ata që kënaqen kur zbulojnë të meta të një artisti të famshëm apo kushdo tjetër. Ata i kritikojnë pa mëshirë për këto të meta. ***Detarët të “Albatrosi” janë shembulli i këtyre njerëzve mizorë.***

1 pikë Nëse analizon njërin nga motivet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

Koment:

- Poeti e krahason veten me albatrosin, këtë zog të mahnitshëm, i cili mund të fluturojë për orë të tëra, pikërisht ashtu siç konsiderohet një poezi për njerëzit që e lexojnë dhe përfshihen brenda saj, por, kur ti e merr këtë poezi mahnitëse dhe përpiqesh ta analizosh, ta kuptosh, ta zbërthesh, ajo e humbet madhështinë e saj dhe shfaqet e shëmtuar, e plogët dhe e humbet origjinën e saj hyjnore. ***Duket sikur poeti thotë: mos e analizoni poezinë, por shijojeni atë, pikërisht për bukurinë e fjalëve të saj.***

OSE

- Duke i quajtur këta zogj “ *sovrani*”, poeti habitet nga shëmtia që ata shfaqin në tokë, krahasuar me hijeshinë që tregojnë në qiell. Poeti e krahason veten me imazhin e përmbysur të albatrosit, duke theksuar se poetët janë si të huaj dhe të përqeshur në tokë. Bukuria që ata shfaqin në qiell, nuk ka më kuptim përpara turmave përqeshëse.

OSE

- Ashtu si *sovrani i kaltërsisë*, albatrosi, artet janë forma të krijimeve të bukura. Por vetëm pak njerëz mund ta kuptojnë dhe vlerësojnë artin. Mjerisht, kur vepra e një poeti bie në duart e një lexuesi të keq, ai bëhet si albatrosi: i shëmtuar dhe qesharak.

Ilustrimet

- Do të jenë në funksion të këndvështrimit, me të cilin do të komentohet thelbi i krahasimit.

1 pikë Nëse komenton thelbin e krahasimit midis albatrosit dhe poetit.

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me vargje ose detaje nga poezia.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 17 (b) 2 pikë

Model përgjigjeje

Kontraste

- Dikur sovran i qiejve – tani i qullët, qesharak, ngordhalaq,
- Dikur madhështor – tani zvarritet,
- I shëmtuar – i bukur (shëmtia dhe bukuria),
- Qielli i pafund – kuverta e anijes (hapësira – izolimi).

Shpjegimi

- Kontrasti shërben për të theksuar dy gjendjet e albatrosit (poetit), në qiell dhe në tokë dhe në këtë mënyrë rrit ngarkesën emocionale të poezisë. Imazhi i albatrosit të lirë, madhështor, të bukur, kur endet në qiell, hyn në kontrast me imazhin që ai na shfaq në tokë, i shëmtuar, i ngathët, qesharak.

1 pikë Nëse identifikon një kontrast në këtë poezi.

1 pikë Nëse shpjegon kontrastin e identifikuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 17 (c) 2 pikë

Model përgjigjeje

Përgjigje e plotë

- I gjithë thelbi i tragjizmit të albatrosi qëndron në **transformimin** e albatrosit: nga një shpend madhështor në një krijesë qesharake, të plogët, të tallur dhe përqeshur.

Përgjigje e pjesshme

- Thelbi i tragjizmit qëndron te **transformimi** i albatrosit.

- Thelbi i tragjizmit qëndron të **përmbysja** e imazhit të tij.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë **të plotë** tragjizmin të albatrosi.

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë **të pjesshme** tragjizmin të albatrosi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA III

Ismail Kadare

Kështjella

Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	D	1 pikë

Pyetja 21 (a) **2 pikë**

Detajet:

- forma e ndërtimit,
- vendosja e kullave,
- pozicioni i saj,
- flamuri i kuq,
- kulla e parë,
- pamje e zymtë,
- pamje ogurzezë.

2 pikë Nëse tregon dy detaje (nga të mësipërmet).

OSE

1 pikë Nëse tregon vetëm një detaj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (b) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Pamja e kështjellës i zgjon trishtim, pasi pashai e kupton se nuk do ta ketë të lehtë ta pushtojë.

OSE

- Pamja e kështjellës i zgjon trishtim, pasi pashai e kupton se beteja do të jetë e ashpër dhe shumë nga ushtarët e tij do të humbasin jetën aty (*në nëntekst*).

OSE

- Pamja e kështjellës i zgjon trishtim, pasi pashai thellë në veten e tij e kupton se njerëzit që e kanë ndërtuar duhet ta kenë shumë të shtrenjtë lirinë (*flamuri që valëvitet*) dhe do të luftojnë deri në fund për ta mbrojtur atë.

1 pikë Nëse tregon pse pamja e kështjellës i zgjon trishtim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (c) 2 pikë

Model përgjigjeje

- **Ndjesia:** habi (*asnjëherë nuk kishte parë male të tilla*), ankth, angështi, nervozizëm (pranohet edhe një nga këto ndjesi).

Shpjegimi:

- Malet janë të larta, hijerënda dhe e befasojnë pashain. Ai s'ka parë ndonjëherë male të tilla dhe është normale kjo frikë dhe ky ankth. Me madhësinë dhe lartësinë e tyre ato sikur e shtypin.

OSE

- Thellë në vetvete ai sikur e parandien rrezikun që mund të vijë prej tyre. Vend i ashpër, njerëz të ashpër.

1 pikë Nëse tregon ndjesinë që provon pashai kur shikon malet.

1 pikë Nëse shpjegon këtë ndjesi të pashait.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22

3 pikë

Model përgjigjeje

Mjetet e stilistikës:

- **krahasimi:** *si male të vogla paqësore,*
- **epitetet:** *të qeta, (Anadoli) – të rënda, të frikshme (malet shqiptare),*
- **epiteti metaforik:** *rrafshirat e tij të përgjumura,*
- **metaforat:** *i ngjanin një ankthi, që të shtyp, toka dhe gurët ishin vërvitur.*

Analiza

- Mjetet e stilistikës theksojnë dallimin midis dy vendeve: epitete, që japin karakteristikat e secilit prej tyre, theksojnë pikërisht këtë dallim. Po e njëjta logjikë vlen edhe për metaforat apo krahasimet.

OSE

- Vendi nga vjen pashai (Anadoli) është ***i qetë, i përgjumur, i paqtë*** (epitetet, krahasimi). Devetë i kujtojnë pikërisht këtë. Kurse vendi që kërkon të pushtojë është ***i frikshëm*** (epiteti për malet), që të shtyp, që të shkakton ankth (metaforat). Çdo gjë këtu është e gurtë dhe shtypëse.

2 pikë

Nëse identifikon dy mjete të stilistikës.

DHE

1 pikë

Nëse analizon njëren prej tyre.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Dyshimi që e mundon pashain është se emërimi i tij si kryekomandant i kësaj fushate ishte rezultat i ndërhyrjes së miqve apo armiqve të tij. (Mund të perifrazohet ose të merret si citim nga fragmenti).

Burimi i dyshimit

- Pashai e kupton se pushtimi i kësaj kështjelle do të jetë shumë i vështirë, në mos i pamundur. Pozicioni i saj i papërshtatshëm, terreni i egër, me male të larta, ku në çdo çast mund të sulmohesh, i lënë atij të kuptojë se karriera e tij është seriozisht e rrezikuar, në mos më shumë.

1 pikë Nëse tregon dyshimin që e mundon pashain.

1 pikë Nëse shpjegon burimin e këtij dyshimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 **1 pikë**

Model përgjigjeje

Ana funksionale e përdorimit të krahasimit:

- Përmes tij shfaqet padurimi i ushtarëve për të dalë nga ai mjedis mbytës në hapësirë.
- Fusha shfaqet po aq e dëshirueshme sa pusi në shkretëtirë.

1 pikë Nëse shpjegon anën funksionale të përdorimit të krahasimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

1 pikë

Model përgjigjeje

- Një përshkrim i tillë i mjedisit paralajmëron se gjithçka që do të vijojë më pas do të jetë e zymtë, plot ankth, të papritura. Rrit shumë ngarkesën emocionale për atë që pritet të vijë më pas.

OSE

- Ushtria kuptohet që ka ardhur për ta pushtuar këtë vend, por kjo nuk do të jetë aspak e lehtë, pasi ashtu si vendi që shfaqet i ashpër, armiqësor, i egër edhe ndeshja, që do të zhvillohet në të, do të jetë e tillë.

OSE

- Pashai ende s'i ka ndeshur shqiptarët. Ata ende nuk janë shfaqur. Takimi i parë është bërë me vendin, i cili shfaqet i egër dhe shumë armiqësor. Në nëntekst kuptohet që edhe njerëzit, të cilët jetojnë në të, janë të tillë, si ky vend. Ndaj pushtimi duket shumë i vështirë.

1 pikë Nëse shpjegon se për çfarë shërben një përshkrim i tillë i mjedisit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

MATURA 2013

PJESA I

Kur bie shi

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë

Pyetja 7 (a) **3 pikë**

Lloji i tekstit: përshkrues

Karakteristikat gjuhësore:

- Përdorimi i gjuhës së figurshme,
- Mbizotërimi i mbiemrave,
- Mbizotërimi i fjalive me detaje të hollësishme,
- Përdorimi i foljeve që tregojnë gjendje dhe emocione,
- Mbizotërimi i kohës së tashme dhe të pakryer.

1 pikë Nëse përcakton llojin e tekstit.

DHE

2 pikë Nëse zbulon **dy** karakteristika gjuhësore, tipike për llojin e tij.

OSE

1 pikë Nëse zbulon vetëm **një** karakteristike gjuhësore, tipike për llojin e tij.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 7 (b) **1 pikë**

Referenti: shiu

1 pikë Nëse përcakton referentin në tekst.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8

3 pikë

Model përgjigjeje

Shqisa kryesore: të parit, të vështruarit, të shikuarit.

Shpjegimi:

- Të parit është shqisa kryesore, pasi në raport me shqisat e tjera, ajo është mbizotëruese.

OSE

- Të parit është shqisa kryesore, pasi gjithçka që paraqitet, vjen nëpërmjet saj. Autorja e ka parë shiun në të gjitha fazat dhe format e tij dhe ndjesinë që ai i ka shkaktuar duke e parë, përpiqet t'ia përcjellë edhe lexuesit.
- **Ilustrimet:** *shi i lehtë, shi i butë, uji që avullon nga kërcelli, shirat e gjatë, të ngadaltë derdheshin mbi të korrat, duke e përkulur grurin, nuk i kisha parë trillet e erës, që dukeshin si gjurmë të rënda këmbësh, nuk kisha parë breshër, që shtyhej përpara nga erëra të forta, një shi që bie drejt e poshtë, një shi që spërkat, keni parë shi.*

1 pikë

Nëse identifikon shqisën kryesore.

DHE

1 pikë

Nëse shpjegon pse është, pikërisht, kjo shqisa kryesore.

DHE

1 pikë

Nëse përgjigjen e ilustron me shembuj nga teksti.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 **2 pikë**

Shembull përshkrimi objektiv:

- *isha e detyruar të ndërroja dërrasat e çatisë dy herë në pesë vjet,*
- *kishte rrjeta teli në dritaret e anës perëndimore të shtëpisë së vet,*
- *nuk kisha parë breshër të binte nga qielli i kthjellët, blu,*
- *nuk i kisha parë gropat në një fushë gruri.*

Shembull përshkrimi subjektiv:

- *stuhitë e befta dhe të dhunshme të breshrit,*
- *nuk i kisha parë trillet e erës, shiut dhe breshrit,*
- *si të ishin gjurmë të rënda këmbësh të një gjiganti,*
- *nuk kisha provuar shi që vinte valë - valë dhe shtyhej përpara nga erëra të forta.*

1 pikë Nëse gjen një shembull të përshkrimit objektiv.

1 pikë Nëse gjen një shembull të përshkrimit subjektiv.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **2 pikë**

Figurat e stilistikës:

- **Metafora:** *trillet e erës, shiut dhe të breshrit.*
- **Krahasimi (ose similituda):** *si të ishin gjurmë të rënda këmbësh të një gjiganti*
- **Epitet:** *gjurmë të rënda.*

2 pikë Nëse zbulon dy figura të stilistikës, të shoqëruara me ilustrimet përkatëse.

1 pikë Nëse zbulon një figurë të stilistikës, të shoqëruar me ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 (a) **1 pikë**

Koha që mbizotëron: e pakryera

- 1 pikë** Nëse identifikon kohën e foljes që mbizotëron në paragrafin e parë.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 11 (b) 1 pikë

Rishkrimi i fjalisë sipas këndvështrimit objektiv:

*Nuk e **kishte kuptuar** se një shi në pranverë ose në vjeshtë, një shi që bie drejt e poshtë, një shi që spërkat, është më shumë se një bekim.*

- 1 pikë** Nëse e rishkruan fjalinë, duke ndryshuar vetën e rrëfimit, nga e para në të tretë dhe duke hequr fjalët e figurshme.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim, mungon njëra nga ndryshimet e duhura ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 12 1 pikë

E veçanta e rrëfimit në vetën e parë:

- theksohet subjektivizmi,
- theksohet emocionaliteti,
- rrëfimi bëhet më i besueshëm.
- përmbajtja është më shumë emocionale.

- 1 pikë** Nëse tregon të veçantën që sjell rrëfimi në vetën e parë.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim, mungon njëra nga ndryshimet e duhura ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 13

2 pikë

Interpretimi:

Përgjigjja e plotë

- Nëse ke qenë në jug, atëherë e ke parë shiun si fenomen natyror. Por, shiu në jug është diçka më shumë se kaq. Nëse ke qenë në jug, jo vetëm e ke parë shiun, por edhe e ke përjetuar, e ke shijuar, e ke vëzhguar në të gjitha fazat, duke e njohur më mirë *fizionominë* e tij. Ai të ka zgjuar shumë kujtime dhe nostalgji. Shiun në jug i jep kuptim këtij vendi dhe e bën të veçantë.

Përgjigjja e pjesshme

- Nëse ke qenë në jug, e ke parë shiun të bjerë.

OSE

- Nëse ke qenë në jug, ke vënë re që bie shumë shi.

2 pikë

Nëse interpreton në mënyrë të plotë fjalët që fermeri thotë në fund të këtij teksti, duke theksuar të dy anët: **shiun si fenomen** (1 pikë) dhe **shiun si pjesë emocionale e vendi** (1 pikë).

OSE

1 pikë

Nëse interpreton në mënyrë të pjesshme fjalët që fermeri thotë në fund të këtij teksti, duke u përqendruar kryesisht te shiu, thjesht si fenomen.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II

Eskili		<i>Prometeu</i>
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

Pyetja 21 (a) 1 pikë

Model përgjigjeje

➤ **Shkaku i konfliktit në këtë fragment:**

- Mosbindja e Prometeut ndaj Zeusit.
- Refuzimi i Prometeut ndaj ligjeve arbitrare të Zeusit.
- Refuzimi i Prometeut që t'i tregojë Zeusit parashikimin e fatit, sekretin e rrëzimit nga fronti.

1 pikë Nëse zbulon shkakun e konfliktit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (b) 2 pikë

Karakteristika e Hermesit:

- servil,
- frikacak,
- lake (shërbëtor)

Çifti antonimik: fisnik - lake (shërbëtor)

OSE

*Më duket vetja më **fisnik** në pranga
në shkëmb mbërthyer se sa të jem **lake...***

1 pikë Nëse zbulon një karakteristikë të Hermesit.

1 pikë Nëse gjen çiftin antonimik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (c) 1 pikë

Model përgjigjeje

Tipari i heroit tragjik:

- Të qénit i vetëdijshëm për atë që e pret.
- Nuk e braktis idealin, por vetësakrifikohet, vetëfljohet.
- Të qénit krenar, pavarësisht ndëshkimit që e pret.

1 pikë Nëse zbulon një tipar të Prometeut që e bën atë hero tragjik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë

Figura e stilistikës: Shkallëzimi rritës (ose shkallëzimi)

Funksioni artistik: Krijimi i imazheve pamore. Nxitja e imagjinatës së lexuesit.

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës.

DHE

1 pikë Nëse tregon funksionin e përdorimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 2 pikë

Model përgjigjeje

Ana stilistike: të dyja janë epitete.

Ana e fjalëformimit: të dyja janë fjalë të përbëra (mënyra e fjalëformimit: me kompozim)

1 pikë Nëse gjen anën stilistike.

DHE

1 pikë Nëse gjen tipin e fjalëve nga ana e fjalëformimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (a) 3 pikë

Përshkrimi i atmosferës:

Përgjigje e plotë

- Atmosfera në fund të këtij fragmenti është tronditëse, e zymtë, e rëndë, dramatike. Përmes fjalëve të Prometeut kuptojmë se Zeusi po hakmerret ndaj mosbindjes së tij. Ai krijon zhurmë dhe konfuzion. Toka dhe qielli po përmbysen duke krijuar një situatë gati apokaliptike. E gjithë kjo vjen përmes shumë fjalëve dhe detajeve, si: ***bubullimat, gjëmimet, gjarpërojnë rrufetë, gjuhë flake zigzag, flakërimat verbojnë, shqota ulërin, vërshëllen me lemeri, Tok' e qiell, toka me rrëmet, toka po trandet, toka po dridhet***, të cilat japin ndëshkimin që Zeusi po i bën Prometeut. Zeusi, me egërsinë e tij, është i pranishëm kudo, përmes veprimeve, gurëve që vërvit, zjarrit që lëshon, tokës dhe qiellit që përmbys.

Përgjigje e pjesshme

Konstatimi:

- Atmosfera është tronditëse,
- Atmosfera është e rëndë,
- Atmosfera është tragjike.

OSE

Jep thjesht detaje:

- *bubullimat, gjëmimet, gjarpërojnë rrufetë, gjuhë flake zigzag, flakërimat verbojnë, shqota ulërin, vërshëllen me lemeri, Tok' e qiell, toka me rrëmet, toka po trandet, toka po dridhet.*

3 pikë Nëse përshkruan në mënyrë të plotë atmosferën bashkë me detajet përkatëse.

OSE

2 pikë Nëse përshkruan në mënyrë të pjesshme atmosferën dhe përmend një ose disa detaje.

OSE

1 pikë Nëse përshkruan në mënyrë të pjesshme atmosferën, pa përmendur asnjë detaj.

OSE

1 pikë Nëse vetëm e konstaton atmosferën.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (b) 2 pikë

Përgjigje e plotë

➤ **A mbetet Prometeu i lirë?**

- Po, shpirti i Prometeut mbetet i lirë. Zeusi mund t'i ketë prangosur trupin e tij, por jo shpirtin. Edhe në vuajtjen më të madhe, ai mbetet i pamposhtur dhe nuk e shet lirinë e tij shpirtërore për asgjë.

*Le të shkreprijë flakët e rrufeve,
t'ushtojë me gjëmimet e nëndheshme,
le të pësjtjellë Tok' e Qiell së bashku
me borën pendëbardhë, le t'i tundë
e shembë të gjitha, por ta dish se kurrë
nuk më përkul dot!*

Ajo që Zeusi nuk përkul dot është pikërisht shpirti i Prometeut, pra të menduarit lirisht. Prometeu e di mjaft mirë fundin që e pret, por ai mbetet i lirë të vendosë me vullnet të plotë. Fjalët e thëna nga Prometeu na bindin, pikërisht, për këtë liri të brendshme që mbetet e paprekshme tek ai.

OSE

- Prometeu ka lirinë të zgjedhë rrugën që do të ndjekë fati i tij: të pranojë të ndëshkohet nga Zeusi apo të pajtohet me të. Kompromisi që ai nuk bën, pohon pikërisht këtë liri të shpirtit të tij. Ai thotë vetëm të vërtetën, kur i pohon Hermesit se do të pranonte më mirë të ishte në pranga, se sa të mbetej një shërbëtor i Zeusit. Duke duruar torturat dhe mundimet, ndërsa nuk i thotë Zeusit asgjë në lidhje me fatin që e pret, ai tregon se është i lirë në zgjedhjen e tij dhe bindur e i vendosur për atë që po bën.

Përgjigje e pjesshme

- Prometeu është i lirë në shpirt.
- Zeusi thjesht i prangos trupin.

2 pikë Nëse argumenton lirinë shpirtërore të Prometeut bashkë me ilustrimin që mbështet idenë e tij.

1 pikë Nëse pohon lirinë e tij shpirtërore, por nuk e argumenton atë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është e drejtë që njerëzit të kërkojnë gjithmonë ndryshim,
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë,
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë,
- duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve, ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë

1 pikë

Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin,
 - përfundimin.

1 pikë

Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

MATURA 2014

PJESA I

Gjumi dhe shëndeti

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 **3 pikë**

Model përgjigjeje

Teza: Nëse njerëzit nuk flenë çdo natë, ata dëmtojnë seriozisht shëndetin tyre.

Argumente:

- mungesa e gjumit dëmton sistemin imunitar të njeriu;
- mungesa e gjumit mund të shkaktojë disa sëmundje;
- gjumi i pamjaftueshëm ndikon në funksionimin e trurit;
- gjumi i pamjaftueshëm dëmton edhe kujtesën;
- mungesa e gjumit shkakton një nivel të rrezikshëm të hormonit të stresit, kortisolit.

1 pikë Nëse gjen tezën.

2 pikë Nëse identifikon dy argumente në mbështetje të tezës.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një argument.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Në përgjigjen e dhënë, nxënësi mund t'i marrë argumentet si fjali të gatshme nga teksti ose t'i perifrzojë.

Pyetja 9 **2 pikë**

Arsyet:

- veprimtaritë e shumta shkollore (*ndeshje sportive, studimi për provime*);
- veprimtari në familje;
- veprimtari të ndryshme;
- detyrime familjare ose shkollore.

2 pikë Nëse identifikon dy arsye, për shkak të të cilave njerëzit sakrifikojnë gjumin.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një arsye.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **3 pikë**

Shkaku: për shkak se njerëzit nuk flenë çdo natë.

Pasoja: ata dëmtojnë organizmin e tyre.

Mjeti lidhëz gjuhësor: Raporti shkak - pasojë realizohet me anë të lidhëzave shkakore ose lidhëzave: *meqenëse, për shkak se, ngaqë* etj.

OSE

- **Shkaku:** për shkak se njerëzit ngrihen herët në mëngjes, qëndrojnë zgjuar deri natën vonë.
- **Pasoja:** ata humbasin gjumin.
- **Mjeti lidhëz gjuhësor:** lidhëza shkakore: *meqenëse, për shkak se, ngaqë* etj.

OSE

- **Shkaku:** për shkak se humbasin gjumin.
- **Pasoja:** njerëzit dëmtojnë shëndetin.
- **Mjeti lidhëz gjuhësor:** lidhëza shkakore: *meqenëse, për shkak se, ngaqë* etj.

1 pikë Nëse gjen shkakun.

1 pikë Nëse gjen pasojën.

1 pikë Nëse gjen lidhëzën shkakore ose thjesht shkruan **lidhëz**.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi e nxjerr raportin shkak – pasojë nga i gjithë paragrafi i parë. Realizimi i lidhjes mes tyre kërkon një lidhëz shkakore.

Nxënësi e saktëson se cila lidhëz duhet në këtë rast ose thjesht shkruan: lidhëz shkakore ose lidhëz.

Pyetja 11 **2 pikë**

Teknikat e argumentimit:

- studimet e ndryshme;
- informacioni i nxjerrë nga referenca të ndryshme;
- argumente që sjellin të dhëna, fakte, shembuj;
- deklarimi i përfundimeve.

2 pikë Nëse identifikon dy teknika të argumentimit të përdorura nga autori.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një teknikë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 (a) **1 pikë**

Model përgjigjeje

- Fjalitë me shkronja të zeza shprehin **argumentin** ose **idenë kryesore** në mbështetje të tezës. Pjesa tjetër e paragrafit mbështet me citime, të dhëna, shembuj, fakte etj, pikërisht këtë argument ose ide të dhënë në fjalinë e parë të secilit paragraf.
 - Ajo është çështja kryesore, pastaj pjesa tjetër është zhvillimi i saj.
 - Ideja kryesore.
 - Argumenti në mbështetje të tezës.
 - Është tema e paragrafit.

1 pikë Nëse tregon lidhjen midis fjalive me shkronja të zeza dhe pjesës tjetër të paragrafit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 (b) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Janë prodhim i përpiktë, origjinal, i thënieve të studiuesve apo studimeve, ku ai është mbështetur.

OSE

- Janë fjalë ose fjali të tjerëve, saktësisht siç i kanë thënë ata.

OSE

- Fjalët ose fjalitë janë futur midis thonjzave për të treguar burimet ku autori është mbështetur.

OSE

- Janë thënie, citime të studiuesve për ta bërë argumentin më të besueshëm.

1 pikë Nëse tregon arsyen e përdorimit të thonjzave.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 2 pikë

Nxënësi i referohet përmbajtjes së paragrafit të fundit.

- Ky është paragrafi që bën përmbledhjen, përfundimin e tërë tekstit, në ndryshim nga pjesa tjetër e tij, ku shtjellohen argumentet kryesore, në mbështetje të tezës.

Nxënësi i referohet anës gjuhësore të paragrafit.

- Në këtë paragraf kemi përdorimin e vetës së parë shumës, në ndryshim nga pjesa tjetër e tekstit. Ky përdorim thekson pikërisht gjithëpërfshirjen në përfundimin e arritur, pra që përfundimi u takon të gjithë njerëzve, edhe autorit bashkë me ta.

OSE

- Autori përfshin edhe veten në përfundim (duke nënkuptuar ndryshimin e vetës).

1 pikë Nëse, duke iu referuar **përmbajtjes** së paragrafit, shpjegon ku ndryshon ai nga pjesa tjetër.

1 pikë Nëse, duke iu referuar **anës gjuhësore** të paragrafit, shpjegon ku ndryshon ai nga pjesa tjetër e tekstit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II

Ismail Kadare

Rënia e dëborës

Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Sfondi:

- Natyrë dimri, e ftohtë, me erë, me borë. Të bie në sy një qiell i mbyllur, i hirtë, që në mëngjes shfaqet i zbehtë dhe i ftohtë.

Ngjyra:

- Bazuar në poezi, ngjyra që sundon mund të jetë: gri (e hirtë), e bardhë.

1 pikë Nëse përshkruan me pak fjalë sfondin që krijohet në poezi.

1 pikë Nëse përcakton një ngjyrë që përfitron nga leximi i poezisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 2 pikë

Shumësi: erëra/t

Shpjegimi stilistik

- Ky përdorim ruan më mirë ritmin e brendshëm të vargut, muzikalitetin e tij. Krijon efekt tingullor.

OSE

- Përdorimi i formës me *n*, mund të theksojë më shumë imazhin e forcës dhe të fuqisë. Bashkëtingëllorja *n* ka forcë më të madhe dhe intensitet më të dukshëm se bashkëtingëllorja *r*.

OSE

- Fjala *ernat* e thekson më shumë idenë që kërkon të na përcjellë autori në lidhje me bashkëpunimin *qiell-erë*.

1 pikë Nëse gjen shumësin e rregullt.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen stilistike të këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22

3 pikë

Model përgjigjeje

Fjala që krijon efekt të menjëhershëm: kristal

Simbolika

Përgjigje e plotë

- Kristali nënkupton diçka të bukur, të brishtë, delikate, të thyeshme, të përsosur (*qielli punoi gjithë natën për të projektuar çdo kristal*). Vetëm diçka kaq e bukur mund të përdoret për flokët e vajzës, si pjesë shtesë e bukurisë së tyre, brishtësisë, delikatesës, ashtu siç është dhe vetë vajza (në nëntekst).

OSE

- Nuk është thjesht një kristal bore që bie nga qielli, por është një kristal i veçantë, i projektuar enkas nga qielli dhe që është i denjë për të zbukuruar flokët e saj, shtuar hijeshinë e tyre.

Përgjigje e pjesshme:

- Kristali simbolizon delikatesën, të brishtën, të bukurën.

1 pikë

Nëse gjen fjalën *kristal*.

DHE

2 pikë

Nëse zberthen në **mënyrë të plotë** simbolikën që ajo mbart në kontekstin e dhënë.

OSE

1 pikë

Nëse zberthen në **mënyrë të pjesshme** simbolikën që ajo mbart në kontekstin e dhënë.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

- Qielli mbyllet qëllimisht për të krijuar borën, por jo një borë çfarëdo, por një borë të projektuar për vajzën, për flokët e saj, për ta zbukuruar më shumë atë. Ai punon tërë natën, vetëm që vajza të bëjë gjestin e bukur të shkundjes së kristaleve.

OSE

- Asgjë në këtë sfond dimri nuk ndodh rastësisht. Qielli bashkëpunon me erërat dhe punon një natë të tërë, duke shtruar kudo dëborën dhe duke projektuar çdo kristal të saj.

OSE

- E zbukuron vajzën më shumë me kristalet borës që i hedh qëllimshëm mbi flokë.
- **Ilustrim: Se qielli rastësisht s'u mbyll, bora ra për ty, u projektua çdo kristal, gjersa i gjeti flokët e tu, punoi me ernat në bashkëpunim, dëborë që shtroi kudo/ Në të vërtetë ra për ty, Që ti ta shkundje me një gjest**

1 pikë Nëse shpjegon pse qielli shfaqet si aleat i bukurisë së vajzës.

DHE

1 pikë Nëse përgjigjen e ilustron me një ose më shumë shembuj nga poezia.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 3 pikë

Model përgjigjeje

Detaji: flokët

Interpretimi i plotë:

- Autori përqendrohet vetëm te flokët e vajzës. Mesa duket, flokët janë diçka e rëndësishme, tërheqëse, që atij i bëjnë më tepër përshtypje. Janë shenjë feminiteti, delikatese. Theksohen për të nxjerrë më në pah gjestin e bukur dhe tërheqës të shkundjes së tyre, *shkujdesshëm dhe gjithë gëzim*.

Interpretimi i pjesshëm:

- theksohen flokët si shenjë delikatese.
- përmend vetëm flokët, pasi ato i tërheqin më shumë vëmendjen.
- theksohen flokët si element bukurie.
- përmenden flokët për të theksuar gjestin delikat të shkundjes së tyre.

1 pikë Nëse identifikon **flokët**.

DHE

2 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të plotë** këtë zgjedhje të autorit.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të pjesshme** këtë zgjedhje të autorit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24

3 pikë

Argumentim i plotë:

Po, në këtë poezi shfaqet kontrasti.

- Nga njëra anë është sfondi dimëror, i ftohtë, me erë dhe dëborë, me një mëngjes të zbehtë dhe nga ana tjetër vajza, që gjithë gëzim shkund dëborën nga flokët e saj. Gjest që i shkakton emocion djalit. Pra, kemi një natyrë të ftohtë dhe dy të dashuruarit, që të gëzuar shëtisin.

Ilustrime:

*I ftohtë- e gjithë gëzim,
I ftohtë, dëborë - shëtisim ne të dy*

- **Jo**, në pamje të parë duket sikur krijohet një atmosferë kontrasti, midis sfondit dimëror dhe ndjenjës së dy të rinjve. Por, në të vërtetë, ky kontrast nuk është kaq i qartë, pasi bora e shtruar, kristalet e saj në flokët vajzës nuk krijojnë një atmosferë që hyn në kontrast me të rinjtë, por krijojnë një pamje paksa magjike, të bukur, pavarësisht se është dimër dhe ftohtë, që ata të shëtisnin në të (*bora e shtruar kudo, në këmbët tyre, shëtisin të dy*). Pra, natyra në dukje është e ftohtë, por në të vërtetë është në funksion të dy të rinjve.
- **Jo**, nuk krijohet kontrast, pasi e gjithë kjo atmosferë është krijuar nga qielli *jo rastësisht (altruizmi i tij)*, por, pikërisht për të zbukuruar flokët e vajzës me kristale, për të përfutur gjestin e saj gjithë gëzim (*shkund flokët gjithë gëzim*). Pra, nuk ndihet ndonjë kundërvënie.

Ilustrime:

*Se qielli **rastësisht s'u mbyll**, Se kjo dëborë që shtroi kudo/Në të vërtetë ra për ty,
Dhe nuk pushoi së rëni ajo /Gjersa i gjeti flokët e tu,
Një natë të tërë qielli punoi – Ti ... Shkujdesshëm krejt e gjithë gëzim
Ndërsa shëtisim ne të dy/Nën altruizmin e tij të hirtë.*

Argumentim i pjesshëm:

- **Po**, natyrë dimërore, e ftohtë, me borë- natyrë njerëzore, dy të dashuruar.
- **Po**, tërë natën qielli punon enkas që të krijojë borën për të zbukuruar flokët e vajzës - në mëngjes ai shfaqet i qetë, indiferent.
- **Jo**, natyra dimërore është në aleancë me gëzimin e të rinjve.
- **Jo**, natyra e ndihmon bukurinë e vajzës dhe gëzimin e të rinjve.

2 pikë Nëse argumenton në **mënyrë të plotë** kontrastin që mbart ose jo poezia.

OSE

1 pikë Nëse argumenton në **mënyrë të pjesshme** kontrastin që mbart ose jo poezia.

DHE

1 pikë Nëse argumentimin e shoqëron me ilustrime nga poezia.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Në argumentimin e dhënë ilustrimet duhet të jenë në funksion të tij. Nëse ilustrimi nuk përputhet me idenë e shprehur, nuk do të merret parasysh në vlerësim.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë,
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë,
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin,
 - përfundimin.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

MATURA 2015

PJESA I

Liria e fjalës

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë

Pyetja 8 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

- Autori mendon se duhet mbështetur fjala e lirë, sepse ajo të çon drejt së vërtetës.

OSE

- Autori mendon se në universitetin që ai përfaqëson, besohet në tri gjëra: vlerën e kërkimit intelektual, integritetin e individëve dhe aftësinë e anëtarëve të këtij komuniteti universitar për të menduar në mënyrë racionale dhe për të punuar fort drejt së vërtetës.
- **Argumenti:** Ne nuk mundemi që njëkohësisht t'i përkustohemi përparimit intelektual dhe, në të njëjtën kohë, të vendosim kufizime në atë që mendohet apo diskutohet.

1 pikë Nëse tregon pse autori mendon se duhet mbështetur fjala e lirë.

1 pikë Nëse shkruan argumentin kryesor të autorit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Në përgjigjen e dhënë, nxënësi mund ta marrë argumentin si fjali të gatshme nga teksti ose ta perifrzojë.

Pyetja 8 (b) 2 pikë

Model përgjigjeje

- Argumenti është **subjektiv**.
- **Arsyeja:** Përdorimi i shprehjes **ne besojmë**, pra ai mbështetet në gjykime personale, jo në të dhëna, fakte apo në studime të ndryshme shkencore.

1 pikë Nëse përcakton llojin e argumentit.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen pse argumenti është i tillë (subjektiv).

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 3 pikë

Interpretimi i plotë:

Thelbi i përgjigjes duhet të lidhet me idenë se shpesh e vërteta mund të mos na pëlqejë dhe mund të mund të mos duam ta dëgjojmë. Ajo mund të kërkojë sakrificë dhe mund të shkaktojë dhimbje.

Interpretim i pjesshëm:

- E vërteta mund të shkaktojë dhimbje.
- E vërteta mund të mos pranohet nga të gjithë.
- E vërteta mund të shkaktojë konflikte, pakënaqësi.
- **E veçanta e paragrafit përmbyllës:** Paragrafi përmbyllës (që zakonisht jep një përfundim) e lë të hapur debatin. Kjo do të thotë që ky debat nuk shteret, pikërisht për shkak të raportit që kanë njerëzit me të vërtetën.

2 pikë Nëse interpreton në mënyrë **të plotë** fjalinë e dhënë.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në mënyrë **të pjesshme** fjalinë e dhënë.

DHE

1 pikë Nëse gjen të veçantën e paragrafit përmbyllës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë bën një interpretim të ndryshëm nga modeli i dhënë, por që tregon thelbin e fjalisë së dhënë.

MATURA SHETËRORE

Pyetja 10 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Mbiemrat: të rrezikshme, të fuqishme.

2 pikë Nëse identifikon dy mbiemrat që cilësojnë idetë.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një mbiemër që cilëson idetë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Pasojat negative:

- idetë mund të jenë të rrezikshme,
- idetë mund të sjellin përçarje dhe të përmbysin situatën ekzistuese;
- idetë mund të sjellin reagime negative, të mbartin urrejtje, të lëndojnë njerëzit dhe të shkaktojnë trauma të mëdha,
- idetë kur nuk kuptohen mirë nga njerëzit, mund t'i manipulojnë ata.

2 pikë Nëse identifikon dy pasoja negative.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një pasojë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12

3 pikë

Argumentimi i plotë:

Duke qenë se universiteti ku bën pjesë autori, nuk **i kufizon fjalimet** nisur nga **emri apo përmbajtja (duhet të theksohen në përgjigje)**, atëherë kjo mund të sjellë edhe abuzim me fjalën e lirë. Ky besim që jepet, mund të shpërdorohet nga të tjerët dhe në këtë mënyrë të mund të shkaktohen edhe pasoja të ndryshme. Pavarësisht këtyre, sërish e pranojnë këtë sfidë, pasi duan të jenë promotorë të së vërtetës dhe të zhvillimit intelektual. Kjo sfidë nënkupton marrjen parasysh të rrezikut.

Argumentim i pjesshëm:

- Universiteti nuk i kufizon fjalimet duke parë vetëm përmbajtjen.

OSE

- Universiteti nuk niset nga emri i atij që e ka shkruar fjalimin.

OSE

- Universiteti nuk i kufizon fjalimet, edhe pse ato mund të shkaktojnë debate.

Ilustrime:

- Në disa situata, mund të duket sikur universiteti mbështet një platformë që prodhon gënjeshtër, urrejtje, shtrembërime dhe gabime. Për pasojë, krijohet përshtypja sikur fjalimet ofenduese legjitimohen kur ndodhin në terrenin e një institucioni kërkimor ose kur shqiptohen nga pjesëtarët e tij.
- Ajo nuk i pengon fjalimet duke u bazuar në personin që i prezanton apo nisur nga përmbajtja e tyre dhe, as ka ngritur ndonjë mekanizëm përmes të cilit institucioni vendos se kush duhet të flasë dhe kush jo. Nuk jemi ne, ata që i miratojmë fjalimet që vijnë këtu.
- Ne e dimë se fjala e lirë mund të shkaktojë dhimbje. Debati i hapur mund të jetë i vështirë dhe i papërshtatshëm. Në disa raste, edhe mund të abuzohet me besimin tonë.

2 pikë

Nëse argumenton në mënyrë **të plotë** pse me lirinë e fjalës mund të abuzohet.

OSE

1 pikë

Nëse argumenton në mënyrë **të pjesshme** pse me lirinë e fjalës mund të abuzohet.

DHE

1 pikë

Nëse argumentin e dhënë e mbështet me ilustrimet e duhura.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

Markez

Njëqind vjet vetmi

Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë

Pyetja 19 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- **Marrëdhënie miqësore.**

Shpjegimi:

Hose Arkadio e kërkon mikun e tij pa pushim dhe ndihet keq (*shtanget*) kur merr vesh se ai ka vdekur. Mënyra se si autori e përshkruan, thekson dhimbjen e madhe shpirtërore që Hoseja ndien për humbjen e mikut të tij.

Ilustrimi:

- *Hose Arkadio Buendia kërkonte gjithandej, me sy të çakërritur si një i ndërkrayer, mikun e tij Melhiades, që ky t'ia zbulonte të fshehtat e pakufishme të atij spektakli të mrekullueshëm.*
- *I pikëlluar nga mandata, Hose Arkadio Buendia ngriu në vend, duke u munduar të mposhte dhimbjen.*

1 pikë Nëse përcakton llojin e marrëdhënies.

1 pikë Nëse e shpjegon këtë marrëdhënie.

1 pikë Nëse shpjegimin e mbështet me një ilustrim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nëse në përgjigjen e dhënë nxënësi jep një ilustrim që nuk paraprihet nga shpjegimi ose nuk është në funksion të arsyetimit, atëherë ai nuk do të marrë pikë.

Pyetja 20 **3 pikë**

Model përgjigjeje

- Autori ndërthur realen me fantastiken për të nxitur më tepër fantazinë apo imagjinatën e lexuesit, për ta bërë pjesën më tërheqëse.

Momentet:

- gjeti një arixhi armen fjalëpakë për t'i ofruar një lloj shurupi që të bën të padukshëm;
- shndërrimi i arixhiut në pellg zifti;
- magjistarë të tjerë që shfaqeshin secili me nga gjashtë krahë të përdredhur;
- pellgu i armenit fjalëpakë u avullua në hiç.

1 pikë Nëse jep qëllimin e ndërthurjes së reales me fantastiken.

DHE

2 pikë Nëse identifikon dy momente të kësaj ndërthurjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- **Karakteristika të stilit në këtë fragment:** lirik, poetik, përshkrues, i detajuar, i orientuar, me nënkuptime, ndërthurja e reales me fantastiken.

2 pikë Nëse identifikon dy karakteristika të stilit të Markezit.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një karakteristikë të stilit të Markezit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (a) **1 pikë**

Model përgjigjeje

Ardhja e arixhinjve në Makondo nënkupton lidhjen e banorëve të këtij vendi me botën e largët; një dalje nga izolimi dhe vetmia ku ata janë mbërthyer. Ardhja e tyre sjell gjallëri dhe ngjyra në jetën e banorëve të vendit.

1 pikë Nëse tregon se ç'nënkupton ardhja e arixhinjve në Makondo.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (b) **2 pikë**

Model përgjigjeje

Përgjigje e plotë

- Po, janë të ndryshëm. Arixhinjtë janë njerëz të lirë që lëvizin kudo, ndërsa banorët e Makondos janë të izoluar; ata lëvizin rrallëherë nga fshati.

OSE

- Arixhinjtë janë njerëz që shfrytëzojnë gjithçka që dinë. Janë pikërisht ata që sjellin gjëra ndryshe në Makondo, që gjallërojnë vendin dhe jetën e vakët dhe të izoluar të banorëve të fshatit.

OSE

- Arixhinjtë shfaqen më të ditur se banorët e Makondos (episodi me akullin etj.). Lëvizja e lirë e tyre bën që ata të jenë në kontakt me të rejtat që shfaqen në vendet ku ata shkojnë.

Përgjigje e pjesshme

- Po, janë ndryshe pasi janë njerëz të lirë.

OSE

- Janë njerëz që dinë më shumë.

OSE

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- Janë njerëz që lëvizin më shumë.
- Janë njerëz që shfrytëzojnë paditurinë e të tjerëve për të përfituar.

2 pikë Nëse argumenton në mënyrë **të plotë** ndryshimin mes arixhinjve dhe banorëve të Makondos.

OSE

1 pikë Nëse argumenton në mënyrë **të pjesshme** ndryshimin mes arixhinjve dhe banorëve të Makondos.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23

2 pikë

Model përgjigjeje

- **E veçanta** qëndron pikërisht në atë që një copë akulli, diçka kaq e zakonshme, konsiderohet si shpikja më e madhe në botë.
- **Kjo na lë të kuptojmë** se këta njerëz dhe ky vend janë shumë të izoluar, larg gjithçkaje që ndodh në botë. Habia e Hose Arkadios kur e prek akullin, e dëshmon pikërisht këtë. Reagimi i tij vjen nga padija, mosnjohja.

1 pikë Nëse tregon të veçantën që qëndron në faktin se pse akulli konsiderohet si shpikja më e madhe.

DHE

1 pikë Nëse tregon se çfarë zbulohet përmes kësaj të veçante në lidhje me vendin dhe banorët e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24

2 pikë

Model përgjigjeje

- Fragmenti ka përshkrime të mrekullueshme të situatave dhe ngjarjeve, të personazheve, ndjesive dhe veprimeve të tyre, por **asnjë shpjegim** nga ana e autorit.
- Narratori thjesht tregon se çfarë ndodh dhe **nuk ka shprehur ndonjë opinion** mbi ngjarjet apo mënyrën se si ato ndodhin. Gjërat ndodhin sepse ndodhin. Narratori qëndron në distancë, nuk ndërhyr për asgjë dhe nuk shprehet për asgjë.

1 pikë Nëse analizon mënyrën e rrëfimit në këtë fragment.

DHE

1 pikë Nëse përgjatë analizës ndalet veçanërisht edhe në pozicionin e autorit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se me cilin nga dy këndvështrimet është dakord;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin (argumentin/argumentet),
 - përfundimin.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

MATURA 2016

PJESA I *Prindërit dhe shkolla*

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë**

Argumentet:

1. *Penalizimi (ndëshkimi) i prindërve largon përgjegjësinë nga nxënësi.*
Shembull: *Ata kurrë nuk do të mësojnë të përmbushin afatet apo të përballen me pasojat që vinë, nëse nuk kanë realizuar detyrimet që kanë.*
2. *Penalizimi (ndëshkimi) i prindërve dëmton marrëdhëniet midis shkollës dhe familjes.*
Shembull: *Megjithatë, nëse shkollat kanë aftësinë të penalizojnë prindërit për dështimet e fëmijëve, qofshin këto akademike apo të sjelljes, atëherë shkolla dhe prindërit mund të kthehen lehtësisht në kundërshtarë të njëri-tjetrit. Nëse kjo ndodh, atëherë ata që do të vuajnë do të jenë nxënësit.*

OSE

Shkollat, që kanë arritur rezultate të larta në provimet kombëtare, kanë nxënës me prindër jashtëzakonisht të përfshirë.

3. *Penalizimi (ndëshkimi) i prindërve është thuajse i pamundur për t'u zbatuar.*
Shembull: *Për më tepër, veç gjobave, nuk ka realisht rrugë efikase për ndëshkimin e prindërve.*

OSE

Nëse prindërit nuk i paguajnë dhe mungesat vazhdojnë, atëherë ata mund të dënohen edhe me burg.

OSE

Nëse prindërit sigurohen që fëmijët të arrijnë në kohën e duhur në shkollë çdo mëngjes, ata nuk mund ta dinë se fëmijët dalin nga dera e pasme e shkollës dhe largohen.

- 1 pikë** Nëse zbulon një argument.
1 pikë Nëse gjen një shembull në funksion të tij.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 9 **2 pikë**

Antiteza : Prindërit janë përgjegjës për arritjet e fëmijëve të tyre në shkollë.

Kundërargumenti:

- Prindërit duhet të kontrollojnë se sa kohë kalojnë fëmijët duke parë televizor, duke dërguar mesazhe apo luajtur në kompjuter.
- Prindërit kanë detyrim të kontrollojnë nëse fëmijët i kanë bërë detyrat e shtëpisë.

- 2 pikë** Nëse identifikon antitezën.
1 pikë Nëse identifikon vetëm një kundërargument
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 10 **2 pikë**

Përgjegjësitë:

- *të marrin nën kontroll afatet,*
- *të kontrollojnë kohën që kalojnë para TV, kompjuterit,*
- *të përballen me pasojat kur nuk janë korrektë,*
- *të përmbushin detyrimet.*

- 2 pikë** Nëse identifikon dy përgjegjësi.
1 pikë Nëse identifikon vetëm një përgjegjësi.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 11 (a) **1 pikë**

Qëllimi i përdorimit të fjalisë pyetëse:

- Përfshin edhe lexuesin.
- Përfshin lexuesit duke i bërë ata pjesë të problemit.
- U drejtohet lexuesve drejtpërsëdrejti (përdorimi i përemrit ju).
- Siguron dinamizëm, lexuesi bëhet aktiv, pjesëmarrës.
- Orienton lexuesin për mënyrën e perceptimit të argumentit.

- 1 pikë** Nëse tregon qëllimin e përdorimit të fjalisë pyetëse në paragrafin e dytë.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-

MATURA SHTETËRORE

Pyetja 11 (b) 1 pikë

Model përgjigjeje

- Autori u referohet rezultateve të provimeve kombëtare ***për të ilustruar idenë e tij*** se, sukcesi i një shkolle varet edhe nga marrëdhëniet e mira midis saj dhe prindërve.

OSE

- Për të ilustruar idenë se si ndikojnë në rezultatet e nxënësve gjithëpërfshirja e prindërve (harmonia, bashkëpunimi, mirëkuptimi, partneriteti).

1 pikë Nëse tregon se pse autori i referohet rezultateve të provimeve kombëtare.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 (c) 2 pikë

Koha e foljeve: e tashme.

Arsyeja e përdorimit: siguron gjithëkohësinë, aktualitetin (tipike e teksteve argumentuese) siguron koherencën, problemi bëhet më prezent, më i afërt.

1 pikë Nëse gjen kohën e foljeve.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e përdorimit të kësaj kohe.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12

2 pikë

Përgjigje e plotë

- a) Nëse marrëdhëniet midis shkollës dhe prindërve acarohen, pasojat do të bien mbi fëmijët. Mësuesit do të fajësojnë prindërit për mosangazhim dhe këta të fundit do të rrisin presionin mbi fëmijët e tyre.
- b) Në këtë mënyrë krijohet një klimë e pafavorshme si në shtëpi edhe në shkollë dhe kjo situatë e nderë, shton presionin mbi fëmijët duke ndikuar negativisht në progresin e tyre.

Përgjigje e pjesshme

- Fëmijët mund të ndodhen midis dy zjarresh.
- Prindërit mund të acarohen shumë me fëmijët.
- Krijohet një klimë jo e përshtatshme, jo e ngrohtë, jo e favorshme, jo mirëkuptuese, jo pozitive.
- Fëmijët ndodhen nën presion, nën trysni.
- Marrëdhëniet prind-fëmijë, tensionohen.

2 pikë Nëse arsyeton në **mënyrë të plotë** pse autori mendon se ata që do të vuajnë janë fëmijët.

OSE

1 pikë Nëse arsyeton në **mënyrë të pjesshme** pse autori mendon se ata që do të vuajnë janë fëmijët.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

MATURA SHETËRORE

Pyetja 13 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- Paragrafi i fundit përbëhet nga një fjali e vetme.
- Në këtë paragraf përmbyllës kemi konkluzionin e autorit mbi çështjen që mbron
- Paragrafi i fundit përmbledh edhe njëherë argumentet, duke rimarrë tezën.
- Paragrafi i fundit kundërshton antitezën, duke sjellë në mënyrë indirekte tezën.
- Paragrafi i fundit e lë çështjen të hapur për lexuesin.
- Paragrafi përmbyllës është koherent me paragrafët e mësipërm dhe koherenca sigurohet përmes konektorit *si përfundim*.

2 pikë Nëse tregon **dy** të veçanta strukturore të paragrafit V.

1 pikë Nëse tregon vetëm **një** të veçantë të strukturës të paragrafit V.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

Homeri

Iliada

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë

Pyetja 20

3 pikë

Motivet:

- Fati i paracaktuar,
- Vullneti i lirë,
- Ndjekja e lavdisë,
- Krenaria (te shkojë në betejë dhe të luftojë. S'ka hero të përlulur),
- Dashuria (për familjen, gruan).

Ilustrime:

- **Fati i paracaktuar:** *Por meqë zotat këto punë të liga/kështu i shestuan, e nuk di a kthehem ndër ta prapë e gjallë, apo e shkrojtën zotat, se të dyve Zeusi/ këtë fat të zi na e preu,*
- **Ndjekja e lavdisë:** *se po më digjet shpirti/me padurim t'u shkoj në ndihmë trojanëve*
- **Dashuria:** *me njerëzit t'piqem dhe me gruan e dashur,*
- **Krenaria:** *se po më digjet shpirti/me padurim.*

2 pikë

Nëse identifikon dy motive.

DHE

1 pikë

Nëse ilustron me shembuj njërin prej tyre.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

MATURA SHKETËRORE

Pyetja 21 (a) 3 pikë

Model përgjigjeje

Elena ndihet e penduar, e shqetësuar, e dërmuar, e zhgënjyer, e turpëruar, e poshtëruar.

Arsyeja: Ajo e neverit **veten e saj**, e urren për çfarë ka bërë. Ajo e kupton se marrëdhënia e saj me Paridin ka shkaktuar shumë mynxyra, shkatërrime, vdekje, vuajtje.

Ilustrimi: *Të poshtrës bushtër, Atë ditë që nëna posa më lindi/ të më kishte flakur nga prehri i saj, Ky s'ka zemër/as shpirt kreshnik e as do të ketë në të ardhmen,/e shpejt besoj se ka për t'i larë gjynahet.*

1 pikë Nëse tregon si shfaqet gjendja shpirtërore e Elenës.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e kësaj gjendjeje.

DHE

1 pikë Nëse e mbështet mendimin me ilustrime nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (b)

3 pikë

Model përgjigjeje

Paridi portretizohet si një burrë i dobët, pa vullnet, pa shpirt luftarak, që s'ka ndjesinë turpit e as mërisë. Ai është: frikacak, i mefshtë, i paturp, pa zemër. Paridi rri në shtrat dhe fle (*Por tunde këtë, që të nxitojë edhe vetë*).

Hektori: I zoti, fisnik, i ka dalë për zot vendit të tij, i qartë në idetë dhe veprimet e tij, i vendosur, luftarak.

Funksioni i kësaj përballjeje: theksohet lartësohet figura e Hektorit, heroit të Antikitetit, madhështia e heroit epik.

OSE

- Ky kontrast thekson idenë e autorit për heroin antik.

2 pikë

Nëse shpjegon kontrastin midis Paridit dhe Hektorit, duke theksuar çfarë i dallon në këtë fragment.

OSE

1 pikë

Nëse ndalet vetëm në një nga personazhet, Hektorin ose Paridin dhe nuk tregon nga buron kontrasti.

DHE

1 pikë

Nëse shpjegon funksionin e përdorimit të kontrastit.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22

2 pikë

Përgjigje e plotë

- Imazhi që krijohet, është ai i gruas që gjykon veten tepër ashpër, ndjen neveri dhe kjo theksohet përmes fjalës **bushtër** që përforcohet nga dy figurat e sintaksës poetike: **inversioni** – që përforcon dhe **elipsa** që ngjesh mendimin.

OSE

- **Përdorimi i inversionit:** ndryshimi i rendit të fjalëve thekson gjendjen emocionale të Helenës. Theksi bie mbi mbiemrin të *poshtrës*, që ka dalë para emrit *bushtër*. Nga ana tjetër mungesa e foljes, **elipsa**, sjell ngjeshje të mendimit, duke theksuar sërish pendimin e Helenës për mënyrën se si rrodhën ngjarjet. Vetë vargu mbart shumë pendim, dëshpërim deri në neverinë që Helena ka për veten e saj.

Përgjigje e pjesshme

- Inversioni, thekson gjendjen emocionale të personazhit.
- Elipsa, mungon folja.
- Vargu mbart shumë dëshpërim, pendim, zhgënjim.

2 pikë

Nëse komenton vargjet bazuar në dy figurat e sintaksës poetike.

OSE

1 pikë

Nëse komenton duke u bazuar vetëm në një figurë të sintaksës poetike ose jep idenë e imazhit që ky varg përcjell.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23

3 pikë

Fati i paracaktuar: Grekët besonin se fati i heronjve varej nga ajo çfarë zotat kishin vendosur për ta. Jeta dhe vdekja e tyre varej nga vullneti i zotave. Megjithatë, në këtë këngë duket qartë se, pavarësisht vullnetit të zotave, njerëzit marrin zgjedhje të rëndësishme. Hektori e di që fati i tij varet nga ajo çfarë zotat kanë vendosur për të, megjithatë ai sërish shkon në betejë nga e cila mund të dalë i humbur.

OSE

- Grekët besonin se ishin perënditë që paracaktonin fatin. Kështu Elena beson se asaj, ashtu sikurse edhe Paridit, Zeusi u caktoi turpin që do t'u këndohet brez pas brezi.
Hektori beson se mund të mos kthehet i gjallë, pasi mund vritet në luftë, pasi kështu e kanë shkruar zotat.

➤ **Ilustrime**

*e nuk di a kthehem
ndër ta prapë e gjallë, apo e shkrojtën zotat
nga duart e akejve shpejt të bie i vdekur”.*

*se të dyve Zeusi
këtë fat të zi na e preu, e turpi ynë
do të këndohet në breznitë e ardhshme”.*

1 pikë Nëse analizon konceptin e grekëve të vjetër në lidhje me fatin.

DHE

2 pikë Nëse jep dy ilustrime nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24

1 pikë

MATURA SHTETËRORE

Hektori shfaqet kaq i papërbajtur për të mbrojtur qytetin e tij, pasi ai është hero i Antikitit dhe në të mishërohen të gjitha virtytet e një heroi të tillë: vendosmëria, pathyeshmëria, vetëmohimi dhe sakrifica për të mbrojtur lirinë e vendit dhe të familjes së tij. Edhe pse e di që mund të vdesë, nderi i tij është në fushë të betejës.

OSE

Si hero i Antikitit, për të ishte e paimagjinueshme humbja e nderit dhe krenarisë së burrit.

1 pikë Nëse tregon pse Hektori mbron vendin e tij, pavarësisht pasojave.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se me cilin nga dy këndvështrimet është dakord,
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë,
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respektton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin (argumentin/argumentet),
 - përfundimin.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

MATURA 2017

PJESA I

Ajsbergët

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë**

Model përgjigjeje

Nga pikëpamja strukturore:

- Hyrje e qartë, koncize, e kuptueshme, ku prezantohet që në fillim referenti: ajsbergët. I drejtohet e përfshin drejtpërsëdrejti lexuesin, e fut menjëherë atë në temë. Tërheq vëmendjen e tij pikërisht duke theksuar fjalët ***ajsberg*** dhe s' do ***ta harronit***.

Nga pikëpamja gjuhësore:

- Përdorimi i vetës II shumës, e gjithë fjalia është një paragraf, përdorimi i dy mohoreve: kurrë dhe s' do ta harronit për të përforcuar idenë që në hyrje.

1 pikë Nëse analizon fjalinë hyrëse nga pikëpamja strukturore.

DHE

1 pikë Nëse analizon fjalinë hyrëse nga pikëpamja gjuhësore.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

- **Ndjesia:** mahnitje, adhurim
- **Çfarë e shkakton:** Pamja madhështore e ajsbergëve.

1 pikë Nëse identifikon ndjesinë e shkaktuar.

DHE

1 pikë Nëse tregon se çfarë e shkakton atë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 (b) 3 pikë

Shembujt:

- *mbytja e anijes Titanik në 1912.*
- *mbytja e anijes Explorer në nëntor të 2007 në Antarktidë.*
- *qindra aksidente të tjera.*
- *asnjë nuk u mbyt.*

Funksioni që luajnë:

- Ilustrojnë me shembuj perceptimin e njerëzve se ***ajsbergët janë të rrezikshëm.***
- Idenë se ***ajsbergët janë të rrezikshëm*** këto shembuj e bëjnë më të prekshme, më të besueshme, e sjellin më pranë perceptimit njerëzor.

2 pikë Nëse identifikon dy nga shembujt e dhënë.

DHE

1 pikë Nëse tregon funksionin që ata luajnë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10

3 pikë

Shembuj të përdorimit të gjuhës së figurshme:

- *kaq e bukur dhe njëkohësisht kaq e pabesueshme,*
- *kjo asgjë kaq e madhe nuk mund të jetë natyrore, e pastaj e kuptoni se një gjë e tillë s'mund të jetë veç natyrore,*
- *këto bukuri kaq të rrezikshme,*
- *me përmasat dhe bukuritë e tyre qiellore,*
- *këto masa të ngrira akulli po marrin një dimension të ri mrekullie,*
- *si një oazë akulli në rrugëtimin e jetës,*
- *lëviz i paepur në udhëtimin e tij oqeanik drejt shkrirjes.*

➤ **Arsyet:**

- Autori u ka lënë dorë të lirë emocioneve për të na përshkruar ndikimin që natyra, pamja e ajsbergëve ka tek ai.
- Autori na tregon se pamja e ajsbergëve i ka lënë mbresa dhe, pavarësisht se teksti është joletrar, ndjesitë që provon, janë aq të fuqishme, saqë ai i bën ato pjesë të këtij teksti.
- Ngjyresa emocionale vjen në funksion të bindjes, të besueshmërisë, lidhur me këndvështrimin që sjell autori.

DHE

- Për të ndikuar te lexuesit, për t'i përcjellë atij, përveç informacioneve dhe shpjegimeve, edhe emocione.

1 pikë

Nëse identifikon një rast të përdorimit të gjuhës së figurshme.

DHE

2 pikë

Nëse tregon **dy** arsye të përdorimit të gjuhës së figurshme.

OSE

1 pikë

Nëse tregon **një** arsye të përdorimit të gjuhës së figurshme.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11

3 pikë

➤ **Thelbi i madhështisë së ajsbergëve:**

- Te kompleksiteti që shfaqin, misteri që mbartin, por mbi të gjitha te kundërshtitë: **të bukur-të rrezikshëm, mbrojtës-shkatërrues, jo vetëm formë por edhe përmbajtje.**

OSE

- **të bukur-të rrezikshëm, mbrojtës-shkatërrues, jo vetëm formë por edhe përmbajtje** (do të pranohet edhe vetëm si ilustrim).

➤ **Interpretim i plotë**

- Autori është ndalur pikërisht tek të kundërtat që ajsbergët shfaqin për të theksuar më shumë madhësinë e natyrës, kompleksitetin e saj. Çdo gjë është në një ekuilibër dhe harmoni: **e bukura- e rrezikshmja, forma dhe përmbajtja.** Vetëm në këtë kompleksitet ajsbergët mund të kuptohen dhe të shijohen. Pamjet bëhen më të plota, ndikojnë te ne në forma nga më të ndryshmet dhe ne bëhemi natyrshëm pjesë e tyre.

➤ **Interpretim i pjesshëm:**

- Për të theksuar të kundërtat te ajsbergët.
- Për të na zbuluar misterin e ajsbergëve.
- Për të na krijuar ndjesi të ndryshme, për shkak të pamjes së tyre.

1 pikë Nëse tregon se ku qëndron sipas autorit thelbi i madhështisë së ajsbergëve.

2 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të plotë** këndvështrimin e tij, bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të pjesshme** këndvështrimin e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II

MATURA SHTETËRORE

Ibsen		Shtëpi kukulle
Pyetja 12	B	1 pikë
Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë

Pyetja 18 **1 pikë**

➤ **Reagimi:**

Helmeri reagon në mënyrë agresive, përbuzëse, deri në neveri dhe urrejtje (ose parafrazim nga fragmenti).

1 pikë Nëse tregon se cili është reagimi i Helmerit kur zbulon të vërtetën.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **3 pikë**

Mjetet e stilistikës:

- **Pasthirrma:** *O, çfarë ëndërr e tmerrshme; Oh, çfarë llum i ndyrë, tmerr,*
 - **Epitete:** *e tmerrshme, i ndyrë*
 - **Metafora:** *ëndërr e tmerrshme, llum i ndyrë*
 - **Shkallëzimi:** *një hipokrite, një gënjeshtare... një kriminele ... llum i ndyrë!*
 - **Kontrasti:** *gëzimi, krenaria ime - një hipokrite, një gënjeshtare... një kriminele ... llum i ndyrë!*
 - **Retiçenca:** ...
 - **Përsëritja:** *më keq, më keq*
 - **Etj**
-

Nënteksti

- Ngjyrimi i fortë emocional që mbartin këto figura, shton dramacitetin, intensitetin e momentit. Epitet, metaforat, shfaqin ndjesinë e Helmerit në lidhje me Norën, përbuzjen, neverinë që ai po ndjen për të, të vërtetën e thelbit të marrëdhënies midis tyre. Në tërësi fjalitë janë të paplota, duke e ngarkuar emocionalisht shumë situatën.

Pasthirrma ndihmon për të shprehur zhgënjimin e tij, befasimin përballë kësaj situatë, duke përgatitur terrenin që, më pas, ndjesia e tij, kalon në nivel më të lartë në neveri dhe në përbuzje.

Shkallëzimi rrit intensitetin e ndjenjave që ai po përjeton në atë moment. Renditja e fjalëve, që vijnë duke e shtuar masën e neverisë dhe të përbuzjes, përfundon me fjalën më të rëndë, fyese, denigruese që mund të artikulojë dikush: *llum i ndyrë*.

Kontrasti i përdorur thekson ndryshimin midis asaj çfarë përfaqësonte Nora dikur për Helmerin dhe ndjesisë që ajo i shkakton sot.

Përsëritja ndihmon në përforcimin e mendimit.

Retiçenca nënkupton fjalë të tjera të pashprehura, të nënkuptuara, në funksion të dramacitetit të skenës.

2 pikë Nëse identifikon dy mjete stilistike, bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një mjet stilistik, bashkë me ilustrimin përkatës.

DHE

1 pikë Nëse zbërthen nëntekstin që figurat e gjetura mbartin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nëse nxënësi i identifikon mjetet e stilistikës pa ilustrimet përkatëse, ai do të marrë 0 pikë.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20

1 pikë

Model përgjigjeje

- Helmeri e përmend disa herë babanë e Norës, sepse ai beson se ajo ka **trashëguar** karakterin e paqëndrueshëm të të atit.

1 pikë Nëse tregon pse Helmeri e ka përmendur disa herë babanë e Norës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **3 pikë**

Analiza e plotë

Nora është në pritje të reagimit të Helmerit, pasi ai të mësojë të vërtetën.

Fillimisht ajo **shfaqet e vendosur, e qetë**, në pritje të reagimit të tij: **Tani lexo letrat e tua, Torvald.**

Por kur ai shpërthen, **ajo befasohet.** (*Duke iu afruar*). Torvald! ...

Fjalitë e saj sa vinë e shkurtohen, toni me të cilat i thotë sa vjen e bëhet më i akullt. Nora tashmë po provon ndjenjën e të qenit e huaj.

Ajo çuditërisht shfaqet e huaj, e ftohtë, ekstremisht e qetë, pasi kupton të vërtetën e martesës së saj.

(*la ngul sytë dhe e vëren pa lëvizur asnjë muskul të fytyrës*). Po, tani po filloj ta kuptoj.

OSE

Nora në fillim shfaqet e vendosur, në pritje që Helmeri të mësojë të vërtetën: (**Çlirohet prej tij dhe thotë me forcë dhe e vendosur**). **Tani lexo letrat e tua, Torvald.**

Më pas ajo shfaq një lloj frike, pasigurie pasi Helmeri e kap në ikje e sipër. (*Duke thirrur me të madhe*). **Ah!; Po, e di. Më lër të shkoj! Më lër të iki!; (Përpiqet të çlirohet).**

Nora shfaqet konfuze, pasi nuk e kupton situatën e paqartë dhe mënyrën se si Helmeri po reagon. Ajo është ende duke menduar se ai do ta shpëtojë. **Ti nuk duhet të më shpëtosh, Torvald; Është e vërtetë. Të kam dashur më tepër se çdo gjë tjetër në botë; Më lër të shkoj. Ti nuk duhet të vuash për mua... Mbi ty nuk duhet të bjerë asgjë...**

Nora qartësohet, kthjellohet në përballjen me Helmerin dhe e kupton se nuk ka asnjë mrekulli për të ndodhur: **(Ia ngul sytë dhe e vëren pa lëvizur asnjë muskul të fytyrës). Po, tani po filloj ta kuptoj.**

Përfundimisht ajo fillon kalon në një pozicion të ftohtë, indiferent: **(Me qetësi, ftohtë). Po**

3 pikë Nëse analizon **në mënyrë të plotë** fazat në të cilat kalon qëndrimi i Norës, bashkë me ilustrimet përkatëse.

OSE

2 pikë Nëse analizon **në mënyrë të pjesshme** vetëm dy faza, bashkë me ilustrimet përkatëse ose më shumë se dy faza por pa asnjë ilustrim.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një fazë, bashkë me ilustrimin ose dy faza por pa ilustrimet përkatëse.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22

2 pikë

Përgjigje e plotë

- Ironia qëndron në faktin pasi menjëherë, kur sekreti i Norës zbulohet, Helmeri do të ketë mundësinë të bëjë këtë që sapo premtoi. Në të vërtetë Nora është duke pritur që ai të bëjë pikërisht këtë gjë, por ai dështon me turp. Shumë larg nga premtimi për ta shpëtuar, ai mendon vetëm për reputacionin e tij të shkatërruar dhe nevojën për të ruajtur dukjen, pamjen.

Përgjigje e pjesshme

- Helmeri ndryshe flet në fillim dhe ndryshe sillet në fund.
- Helmeri nuk është ai që shfaqet.
- Për Helmerin ka rëndësi vetëm forma, dukja, vetja e tij.

2 pikë

Nëse zberthen në ***mënyrë të plotë*** ironinë dramatikë që mbartin fjalët, parë në tërësinë e fragmentit.

OSE

1 pikë

Nëse zberthen në ***mënyrë të pjesshme*** ironinë dramatikë që mbartin fjalët, parë në tërësinë e fragmentit.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (a)

2 pikë

Momente ku shfaqet raporti i individit me shoqërinë:

- *të gjithë do të thonë se edhe unë kam pasur dijeni për aktin tënd, për krimin tënd,*
- *do të thonë se unë kam qenë nxitësi, shtytësi,*
- *do të më quajnë bashkëpunëtorin tënd,*
- *sa për sytë e botës ne do të vazhdojmë si më parë, ti do të rrish këtu, kjo kuptohet.*

Komenti:

- Është një raport varësie. Jeta duhet jetuar sipas normave dhe stereotipave të pranuar nga të gjithë.
- Helmeri është pjesë e shoqërisë ku jeton. Është një shoqëri që ka kornizat e veta, paragjyuese, shtrënguese, gjyuese dhe hipokrite, para së cilës çdo familje mund të bëhet objekt intrigash dhe skandalesh. Ai është pjesë e saj. Helmeri është vetë gjykues, por edhe vetë shoqëria është e tillë: gjykon çdo veprim të individëve të saj.
- E rëndësishme për këtë shoqëri është forma, paraqitja dhe është pikërisht kjo e fundit që Helmeri vendos të bëjë në lidhje me Norën: të ruajë formën për sytë e shoqërisë, që kjo të mbetet e kënaqur.

1 pikë

Nëse identifikon një moment në fragment ku shfaqet raporti i individit me shoqërinë.

DHE

1 pikë

Nëse shpjegon mendimin që ka në lidhje me këtë raport.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 1 pikë

Të dhëna:

- ftohtësia e Norës,
- shfaqja e zhgënjimit të saj,
- distancimi që bën nga i shoqi,
- befasia që shkakton tek ajo reagimi i tij,
- fjalët që Helmeri i thotë se nuk është e denjë për të qenë nënë dhe bashkëshorte,
- vendimi që ai merr për ta izoluar nga fëmijët,
- egoizmi i hapur që ai shfaq dhe tregon se sa të ndryshëm janë ata të dy,
- kontrasti midis asaj çfarë ajo pret nga i shoqi dhe asaj çfarë realisht ndodh,
- përgjigjet e Norës dhe nënteksti i tyre.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një të dhënë që paralajmëron fundin e kësaj drame.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 3 pikë

Përgjigje e plotë

- Është një marrëdhënie pa dashuri edhe pse ata mund të kenë pasur një iluzion të tillë.
Ka qenë një lidhje varësie e njëanshme. Në situatën që ndodhet, Helmeri mendon vetëm për veten e tij dhe jo të të dyve (përdorimi i vetës I, njëjës nga ana e tij). Prandaj, nisur edhe nga ky reagim, natyrshëm shkojmë në mendimin se dashuria e vërtetë është vetëm një iluzion për ta. Nora e para, po fillon ta kuptojë se dashuria e vërtetë nuk ka ekzistuar kurrë për ta.

OSE

- Helmerit i ka interesuar vetëm forma e marrëdhënies. Reagimi ndaj veprimit të Norës e shfaq atë si një njeri të cekët, që shqetësohet së pari dhe kryesisht për dukjen, pamjen. Në fund të këtij fragmenti ai e pohon në mënyrën më të dukshme se pamja e lumturisë është shumë më e rëndësishme se vetë lumturia.

OSE

- Është një lidhje pa dashuri. Në momentin më të vështirë, në vend që të sakrifikojë reputacionin e tij për Norën, Helmeri përpiqet të sigurojë reputacionin e tij, që të mos i preket. Në marrëdhënien e tyre ai shfaqet si një njeri që nuk merr përgjegjësi dhe i fshihet asaj. Kjo mënyrë veprimi e vendos atë në një kah të kundërt me njeriun e fortë, fisnik që ai kishte për qëllim të ishte përpara Norës dhe shoqërisë.

Përgjigje e pjesshme

- Nuk është një lidhje e vërtetë.
- Është një lidhje ku dashuria është thjesht një iluzion.
- Është një marrëdhënie pa dashuri.

Ilustrimet

- *Oh, o zot, e këto duhet t'ia them asaj që kam dashur shumë e që akoma...*
- *Ma shkatërrove lumturinë! Ma prishe të ardhmen!*
- *të më japësh llogari për të tëra një nga një. A e kupton se çfarë ke bërë? ... Fol! ... A e kupton? ...*
- *O, çfarë ëndërr e tmerrshme*

2 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të plotë** thelbin e marrëdhënies midis Norës dhe të shoqit.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të pjesshme** thelbin e marrëdhënies midis Norës dhe të shoqit.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e mbështet me ilustrime nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton mendimin e tij në lidhje me pohimin e dhënë,
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë,
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**
1 pikë **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin (argumentin/argumentet),
 - përfundimin.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë**
(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

PJESA I *Kur shkruajmë*

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë

Pyetja 8 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

- Të gjithë lexojmë,
- Një sekret tjetër është se shkruajmë shpesh,
- Shkrimtarët janë lexues,
- Ne qëndrojmë me veten, shkruajmë në aeroporte apo tavolinën e kuzhinës apo edhe tek peceta e bukës,
- Jemi të zhurmshëm,
- Jemi koleksionistë,
- Etj.

1 pikë Nëse rendit dy nga të fshehtat që autorja ndan me lexuesit e saj.

OSE

1 pikë Nëse rendit vetëm një nga të fshehtat që autorja ndan me lexuesit e saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi mund ta shkëpusë përgjigjen nga testi ose ta shprehë me fjalët e veta.

Pyetja 8 (b) 2 pikë

Proceset:

- të praktikuarit,
- të shkruarit,
- të lexuarit.

2 pikë Nëse identifikon dy proceset.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një proces.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi mund ta shkëpusë përgjigjen nga testi ose ta shprehë me fjalët e veta.

Pyetja 9

3 pikë

Përgjigje e plotë

- *Shkruhet me zemër, shkruhet me duar, duke luajtur me fjalët. Krijohet kështu një imazh i ri përmes detajeve të prekjes, që shkrin fjalën me duart dhe zemrën, me zbulimin. Fjala është forma dhe përmbajtja.*

OSE

- *Procesi i të shkruarit nuk mund të mendohet si diçka mekanike, ku vetëm duart shkruajnë. Pa zemrën ai nuk do të kishte kuptim. Kombinimi i të dyjave krijon emocionin, që derdhet më pas në fletën e bardhë të letrës.*

Përgjigje e pjesshme

Procesi i të shkruarit zhvillohet përmes emocioneve.

- Nuk mund të shkruhet pa zemër.
- Dëshira ime është të shkruaj me emocion.

➤ **Figura:** metaforë.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

2 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të plotë** kuptimin e shprehjes.
Përgjigjja e dhënë nga nxënësi shkon përtej një interpretimi fjalë për fjalë të tekstit, gjithsesi duke e interpretuar atë në përputhje të plotë me të.

1 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të pjesshme** kuptimin e shprehjes.
Përgjigjja e dhënë nga nxënësi i referohet më tepër kuptimit të drejtpërdrejtë.

DHE

1 pikë Nëse identifikon figurën e stilistikës -metaforën.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 10 2 pikë

Përgjigje e plotë

Domethënia:

- *Përmes artit të të shkruarit ajo ka njohur më mirë vetveten, ka dëgjuar zërin e saj të brendshëm dhe ka zbuluar çfarë është ose jo e rëndësishme, çfarë e trishton apo e bën të ndryshme. Është ndjerë më e plotë dhe më pak e vetmuar.*
- *Të shkruarit e ka ndihmuar të krijojë një emër, identitetin e saj, të jetë unike, të zbulojë të veçantën që ka.*

Përgjigje e pjesshme

- *Ka njohur më mirë vetveten;*
- *Ka dëgjuar brenda vetes;*
- *Ka zbuluar shumë gjëra për veten.*

2 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të plotë** kuptimin e shprehjes.

1 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të pjesshme** kuptimin e shprehjes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 (a) 2 pikë

MATURA SHTETËRORE

➤ Interpretimi

- *Rishikimi/ rishkrimi është një pjesë, etapë e rëndësishme e krijimtarisë, një moment mjaft i dobishëm për procesin e të shkruarit etj.*

➤ Rëndësia:

- *Për të bërë ndryshimet e duhura në formë dhe përmbajtje,*
- *Për ta përsosur stilin,*
- *Për të shkruar sa më mirë.*

1 pikë Nëse interpreton qëndrimin që ka autorja në lidhje me rishkrimin e një veprë.

1 pikë Nëse tregon pse kjo etapë është me rëndësi në procesin e të shkruarit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 (b) 2 pikë

Përgjigja i referohet përmbajtjes që duhet të ketë vepra:

- *Respekton mendimet, idetë, ndjenjat, duke qenë besnik i vetvetes krijon dhe përmbajtjen e duhur.*

Përgjigja i referohet formës që duhet të ketë vepra:

- *Eksploron gjuhën, fjalën, krijon dhe stilin e vet (e tij) unik, rishikon/përpunon veprën e tij.*

1 pikë Nëse tregon se në ç'mënyrë një shkrimtar sigurohet që vepra të ketë përmbajtjen e duhur.

DHE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 2 pikë

➤ Teknikat e shkrimit:

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

- Përdorimi i vetës II shumës (ku përfshin lexuesin),
- Dhënia e mesazhit,
- Pyetjet retorike me efekt nxitës,
- Rimarrja e argumentit (tezës) në paragrafin hyrës,
- Fjali të shkurtra,
- Folje në urdhërore,
- Fjali nxitëse.

2 pikë Nëse identifikon dy nga teknikat e shkrimit në paragrafin e fundit.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një teknikë shkrimi në paragrafin e fundit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

Kamy		<i>I huaji</i>
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë

Pyetja 19 3 pikë

Roli i dyfishtë:

- **Së pari:** Kujtimi i momenteve të së shkuarës i shërben Mersoit si një shkëputje nga realiteti, nga një gjyq ku ai ndihet i përjashtuar.
- **Së dyti:** Merso fillon të ndiejë fuqinë e kujtimeve dhe vlerën e atyre momenteve që i kanë sjellë dikur lumturi.

Efekti:

- Merso e kupton se e ka humbur aftësinë të gëzojë (shijojë) dhe të përjetojë momente të tilla. Kjo humbje atij fillon **t'i bëjë përshtypje** për herë të parë dhe pikërisht të kuptojë një vlerë të tij të brendshme, të cilën e kishte pasur deri më atë çast dhe që e kishte mohuar.

OSE

- Për të krijuar efektin e absurdit të lexuesi. Në sytë e tij lexuesi sheh tashmë një Merso që ndien dhe nga ana tjetër çuditet që në një moment kaq delikat, nga ku varet jeta e tij, ai të përjetojë ndjesi të tilla.

2 pikë Nëse shpjegon rolin e dyfishtë të kujtimeve

OSE

1 pikë Nëse shpjegon vetëm një pjesë të këtij roli.

DHE

1 pikë Nëse tregon efektin që kanë kujtimet në këtë çast të zhvillimit të gjyqit tek Merso.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 (a) 2 pikë

Model përgjigjeje

- **Paradoksi:** mirësia dhe konsiderata (respekti) e njerëzve (popullit) në sallën e gjyqit, kundrejt një njeriu, të cilin sapo e kanë dënuar me vdekje, tingëllon e pavend dhe paradoksale.
- **Procesi tingëllon qesharak** dhe absurd, pasi dikush po dënohet jo për krimin që ka kryer por për sjelljen e tij dhe më pas duhet të vritet në mënyrë mesjetare dhe në emër të shumë njerëzve dhe një shoqërie së cilës ai nuk i takon.

1 pikë Nëse tregon paradoksin në paragrafin e fundit.

1 pikë Nëse shpjegon se pse vendimi i marrë nga juria është qesharak.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 20 (b) 1 pikë

Reagimi:

- Merso i nuk thotë asgjë në lidhje me vendimin e jurisë, pasi kjo nuk i intereson aspak.
- Reagimi duket normal, pasi është brenda natyrës së personazhit.
- Ndoshta sepse ai e kupton se gjithçka është e kotë, e pavlerë, ndoshta sepse ai nuk mund të mendojë për asgjë dhe ndoshta sepse është nxehtë në sallën e gjyqit dhe ai me të vërtetë dëshiron të kthehet në qelinë e tij sa më shpejt të mundet.

1 pikë Nëse shpjegon reagimin e Mersoit kur dënohet me vdekje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 2 pikë

Përgjigje e plotë

MATURA SHTETËRORE

- *Gjyqi merret me veprime të së shkuarës së Mersoit dhe jo me vrasjen që ai ka bërë. Merso i është tërësisht i përjashtuar. "Viktima" nuk ka zë të mbrohet apo shprehë mendimin e vet. Vendimi i gjyqit është joracional, atij do t'i pritët koka në një shesh dhe kjo në emër të popullit francez. Ai duket sikur s'ka të bëjë fare me gjyqin ku po vendoset fati i tij. Merso duket sikur merr pozicionin e një gjyqtari: dëgjon, shikon, vëzhgon dhe jep gjykime se si duhet të bërë drejtësia.*

Përgjigje e pjesshme

- *Merso nuk ndihet pjesë e gjyqit që zhvillohet për të.*
- *Merso i po dënohet për veprime dhe sjellje të së shkuarës dhe jo krimin e kryer.*

2 pikë Nëse arsyeton në mënyrë të plotë thelbin e procesit që po zhvillohet kundër Mersoit.

OSE

1 pikë Nëse arsyeton në mënyrë të pjesshme thelbin e procesit që po zhvillohet kundër Mersoit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22

2 pikë

Përgjigje e plotë

Situata absurde:

- *Merso nuk është në gjendje ta marrë seriozisht gjyqin e tij. Ai e kupton se po e gjykojnë. Për një njeri, i cili është mësuar të vlerësohet vazhdimisht për sjelljen e tij kundër normave morale, ky gjyq është thjesht një ditë në jetën e tij, që mezi pret të mbarojë. Ndryshe nga paragrafi hyrës ku mendon se duhet të reagojë, të flasë, madje edhe guxon të flasë, në këtë moment të situatës ai tërhiqet tërësisht.*

OSE

- *Ai kërkon të gjejë qetësinë a lumturinë e tij, pavarësisht situatës dhe mjedisit në të cilin ndodhet, kjo është për të si nevojë për të ekzistuar. Edhe pse po flitet për jetën e tij, ai ndihet tërësisht i përjashtuar dhe kërkon një cep për qetësi. Vetëm kjo i sjell qetësi. Kemi dy gjendje të Mersoit, në hyrje të skenës (paragrafi i parë) ai shfaq shenja reagimi, kërkon të flasë, ndryshe nga heshtja që zgjedh në këtë çast. Kjo e bën situatën absurde.*

Përgjigje e pjesshme

- *Merso i ndihet i përjashtuar nga gjyqi që ka në dorë fatin e tij.*
- *Nuk e merr dot seriozisht gjyqin që po zhvillohet kundër tij.*

2 pikë

Nëse shpjegon në mënyrë të plotë ku qëndron absurdi në fjalinë e dhënë.

OSE

1 pikë

Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme ku qëndron absurdi në fjalinë e dhënë.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23

2 pikë

Karakteristika të rrëfimit:

- Rrëfimi është në vetën e parë, rrëfen Mersoi dhe gjithçka jepet nga këndvështrimi i tij, toni përcaktohet prej personazhit,
- Nga mënyra se si rrëfëhet (rrëfen Mersoi), duket sikur rrëfëhet për një njeri të panjohur,
- Kamy nuk shpjegon kurrë, por përshkruan dhe nuk gjen askund ndonjë justifikim të veprimeve të personazheve,
- Ka pak ngjyra në fragment (vetëm kur ai kujton),
- Ka një prani të ironisë dhe sarkazmës,
- Thjeshtësi në rrëfim,
- Përqendrim i madh tek detajet,
- Përshkrime tejet të sakta,
- Përdorimi i ligjëratës së zhdrejtë,
- Fjalor shumë i thjeshtë.

2 pikë Nëse identifikon dy karakteristika të rrëfimit.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një karakteristike të rrëfimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24

2 pikë

Përgjigje e plotë

- *Kamy përdor një stil të veçantë të rrëfyeri me qëllim që e tërë skena të ndikojë në gjendjen emocionale të lexuesit. Stili vjen i veçantë, i zhveshur. Duke paraqitur ngjarjet, mendimet, ndjenjat pa ndonjë gjuhë specifike apo komente, Kamy e nxit lexuesin të përjetojë të njëjtën ndjesi që Mersoi provon teksa vëzhgon njerëzit dhe botën që e rrethon. Kamysë i intereson të theksojë ekzistencën e paqëllimtë të njeriut dhe se në thelb kjo ekzistencë është joracionale: kalimi i kësaj ndjesie te lexuesi kërkon këtë lloj stili të veçantë.*
- *Zhveshja e fjalës, ndjesive, e çon lexuesin të përftojë situatën absurde, në të cilën ndodhet njeriu.*

Përgjigje e pjesshme

- *Tërheq vëmendjen e lexuesit.*
- *E nxit lexuesin të ketë të njëjtat përjetime si Mersoi.*

2 pikë

Nëse shpjegon në mënyrë të plotë efektin që ka rrëfimi te lexuesi.

OSE

1 pikë

Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme efektin që ka rrëfimi te lexuesi.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se si ambienti që na rrethon ndikon dhe i jep kuptim jetës sonë,
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë,
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin (argumentin/argumentet),
 - përfundimin.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike,
- ka fjalor të pasur,
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

MATURA 2019

PJESA I *Pëshpërimita e tokës*

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë

Pyetja 5 **2 pikë**

Karakteristikat:

- Paragraf i shkurtër,
- Siguron lidhjen e titullit me paragrafët zhvillues,
- Prezanton në mënyrë të përgjithshme referentin,
- Siguron komunikim të drejtpërdrejtë mes autorit dhe lexuesit, duke përcaktuar kështu teknikën e komunikimit që do të shtrihet në të gjithë fragmentin.

2 pikë Nëse identifikon dy karakteristika të strukturës.

1 pikë Nëse identifikon vetëm një karakteristike të strukturës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Çdo përgjigje që lidhet me karakteristika gjuhësore të paragrafit, do të vlerësohet me 0 pikë.

Pyetja 6 (a) **1 pikë**

Kundërvënia qëndron midis dy pamjeve, që në thelb, theksojnë: nga njëra anë praninë e ngjyrave dhe nga ana tjetër mungesën e tyre.

- E errëta – ngjyrat,
- Ditët e errëta të dimrit- ngjyrat rreth nesh,
- Hareja e ngjyrave – gjërat e zymta, mendimet pa ngjyra (të zymta).

1 pikë Nëse identifikon kundërvënien.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi mund ta shkëpusë përgjigjen nga teksti ose ta shprehë me fjalët e veta.

Pyetja 6 (b) 1 pikë

Arsyeja:

- Ne përqendrohemi tek e zymta, te mendimet e zymta. Këto na sundojnë dhe nuk na lejojnë të shikojmë ngjyrat e jetës.

1 pikë Nëse tregon arsyen pse nuk i shohim ngjyrat rreth nesh.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 7 2 pikë

Ndjesia që shkakton, mund të jetë:

- ***mahnitja*** nga bota e gjallë dhe natyra,
- ***dashuria*** për natyrën dhe botën e gjallë,
- ***dashuria*** për jetën në tërësi,
- ***kënaqësia*** e të qenit pjesë e botës njerëzore, që mund të shijojë e prekë gjithçka që ofron natyra përreth,
- ***keqardhja*** që e gjithë kjo bukuri nuk do të jetë e përjetshme.

Autori arrin të ngacmojë ndjeshmërinë e lexuesit duke shpalosur imazhe përmes:

- teknikave të zgjedhura të përshkrimit (detajet shqisore),
- gjuhës së pasur me detaje të të parit, të të prekurit etj,
- gjuhës së figurshme (përgjigje minimale),
- një gjuhe të figurshme të pasur me epitete: ***damarë të bardhë të hollë e delikatë kaq të kadifenjta***,
- gjuhës metaforike: ***të ngopura me lëngun jetëdhënës, përshkruar nga damarë ...por që mbajnë jetën brenda***,
- enumeracionit (gjuhës së figurshme): të hollë e delikatë,
- komunikimi në vetën e parë shumës, që e përfshin lexuesin dhe toneve shpesh bindëse të komunikimit.

1 pikë Nëse tregon një nga ndjesitë që shkakton leximi i pjesës.

1 pikë Nëse tregon **mënyrën** se si autori e nxit këtë ndjeshmëri, duke u përqendruar në elementë të stilit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 8 **2 pikë**

Përgjigje e plotë

- Fjala për autorin ka një peshë shumë të madhe, veçanërisht fjala e shkruar. Ai e përjeton atë si pjesë të shpirtit, një mjet për nxitjen e imagjinatës, një mjet për të kujtuar, kur gjërat nuk i sheh dot më apo kur nuk janë më. Fjala për të është imazh, ngjyrë, ndjesi. Fjala për të është pjesë e pandarë e shpirtit.

Përgjigje e pjesshme

Në përgjigjen e pjesshme nxënësi thjesht shfaq një mendim, një ide, por pa e zhvilluar atë.

- Fjala për autorin ka peshë.
- Ajo i nxit shumë ndjesi.
- Fjala është e rëndësishme, pasi përmes saj shpreh shumë gjëra.
- Fjala e lejon autorin të kujtojë gjëra që s'mund t'i shohë drejtpërdrejt.

2 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të plotë** peshën që autori i jep fjalës.
OSE

1 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të pjesshme** peshën që autori i jep fjalës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 (a) **2 pikë**

Figura stilistike që organizon titullin është:

MATURA SHTETËRORE

- personifikimi/ metafora.

OSE

- onomatopeja.

Raporti:

- Përmes kësaj figure krijohet një lidhje e ngushtë mes autorit dhe tokës së tij, ku toka që flet (pëshpërit) fiton vlera njerëzore, fiton frymë e shpirt dhe bëhet kështu shumë e afërt me autorin, i cili komunikon drejtpërdrejt me të.
- Kjo figurë e bën shumë të prekshme marrëdhënien midis autorit dhe tokës. Kjo e fundit i flet autorit, si një qenie njerëzore.
- Onomatopeja, figurë tingullore (*pëshpërima*) krijon atmosferën, me të cilën më pas do të lidhet kuptimi i të gjithë tekstit. Përmes përsëritjes së tingujve imitues, përcillet imazhi i një komunikimi të ngrohtë dhe të butë, që vjen si një pëshpërimë dhe ngacmon ndjeshmërinë e lexuesit.

1 pikë Nëse identifikon figurën e stilistikës

1 pikë Nëse shpjegon imazhin e krijuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 (b) 2 pikë

Përgjigje e plotë

Në përgjigjen e dhënë nxënësi duhet të interpretojë **peshën** që merr fjala **verbëri** dhe **kontrastin** që krijon kjo fjalë me **ngjyrat**.

- Metafora e përdorur në fjalinë e mësipërme nxit një përfytyrim ngacmues për imagjinatën e lexuesit.

Fjala *verbëri* në këtë rast nuk është përdorur në kuptimin e parë (mungesë e plotë e shqisës së të parit). Në kontekstin e mësipërm, ky përdorim lidhet me mungesën absolute të vëmendjes ndaj ngjyrave të jetës.

Krijohet kështu një përjasje e kësaj mungese vëmendjeje me verbërinë. Verbëria nuk është gjë tjetër veçse errësirë e plotë, shkëputje kontakti me botën përreth, botën e ngjyrave dhe të ndriçimit (gjë që krijon edhe kontrastin në tekst). Kjo gjendje njerëzore është vërtet shumë e rëndë. Pikërisht këtë ngarkesë kërkon të transmetojë autori përmes këtij përdorimi: *mungesa e vëmendjes ndaj ngjyrave të jetës është e njëllotë me errësirën e plotë, mosnjohjen, shkëputjen nga realiteti i botës që na rrethon.*

Përgjigje e pjesshme

- Autori ka dashur të theksojë një lloj pandjeshmërie ndaj ngjyrave.
- Vetëm natyra me ngjyrat e saj, mund ta shpëtojë autorin nga **verbëria ndaj ngjyrave**.
- Verbëria ndaj ngjyrave domethënë të jesh indiferent ndaj tyre, të mos i shohësh ato.

2 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të plotë** forcën e metaforës në fjalinë e dhënë.

OSE

1 pikë Nëse interpreton në **mënyrë të pjesshme** forcën e metaforës në fjalinë e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

MATURA SHETËRORE

PJESA II

Gjergj Fishta

Pyetja 10	B	1 pikë
Pyetja 11	C	1 pikë
Pyetja 12	B	1 pikë
Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë

Pjesa II

Migjeni

Bukën tonë të përditshme falna sot...

Pyetja 20	B	1 pikë
Pyetja 21	D	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë

Pyetja 23 (a) 2 pikë

Detajet:

- mungesa e bukës, mungesa e barnave, e ushqimit (supa, limonada), mungesa e rrobave.

Shpjegimi:

- Është detaj që dëshmon mungesën e kushteve minimale për ekzistencën njerëzore: *të ngrënë, të pirët dhe të veshurit*. Për më tepër, këto mungesa lidhen me detyrimet parësore që kanë prindërit për fëmijën (dihet që prindi sakrifikon gjithçka për mirëqenien e fëmijës së vet) dhe, nëse ato nuk mund të realizohen, atëherë nuk mund të flitet për jetë normale, por për varfëri ekstreme.

1 pikë Nëse identifikon një detaj në fragmentin e dhënë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon pse ky detaj tregon modestinë e jetesës që bën familja e Kolës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 2 pikë

E veçanta e sintaksës poetike:

- shkallëzimi: *asht futë, asht ngjitë, asht ngjeshë*.

OSE

- enumeracioni: *paçavra të ndyeta, mshisa të lagta*.

OSE

- përsëritja artistike e foljes ndihmëse jam (*asht*).

Interpretimi:

- **Përdorimi i shkallëzimit** i jep shprehësi frazës, pasi situata, përmes shkallëzimit, shkon drejt përkeqësimit, për të krijuar imazhin e një gjendjeje të pashpresë. Mjafton të krahasojmë fjalët **futë** dhe **ngjeshë**. Në rastin e parë ka mundësi ndryshimi të situatës, më shumë se në rastin e dytë. Ky përdorim i figurës përkon me idenë e Migjenit mbi zbehjen dhe zhdukjen e vlerave shpirtërore, si pasojë e varfërisë së tejskajshme. Mënyra se si vjen dhe rëndohet gjendja, na kujton që e tashmja e personazhit parashtron fundin e tij tragjik.

OSE

- **Enumeracioni** ndihmon në paraqitjen e detajuar të mjedisit, detajim gati natyralist, që ndihmon në krijimin e një imazhi ngacmues për ndjeshmërinë e lexuesit.

OSE

- **Përsëritja artistike** e foljes ndihmëse **asht** përforcon (thekson) veprimin (gjendjen) dhe mbi të gjitha rrit efektin e shkallëzimit. Kjo përsëritje shton emocionalitetin e frazës dhe krijon një lloj ritmi thuajse poetik.

1 pikë Nëse tregon të veçantën e fjalisë.

1 pikë Nëse interpreton forcën e shprehësisë përmes këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 (a) 1 pikë

Funksioni:

- Mungesa e emrit të përveçëm e barazon këtë nënë më shumë nëna të tjera.
- Ajo është njëra nga këto nëna, të dënuara të jetojnë fatin e tyre në kufi të ekzistencës.
- Ajo bëhet simbol i gjinisë femërore të shoqërisë shqiptare që huajtësohet në nivel social, ekonomik dhe moral e shpirtëror.
- Mungesa e emrit e përgjithëson fatin e saj (si nënë në radhë të parë, por edhe si grua), duke treguar se fenomeni i mjerimit dhe prostituimit a shitjes së trupit nuk është i izoluar, i përveçëm; ai po merr përmasa më të gjera (përgjigje që merr parasysh të gjithë novelën).

1 pikë Nëse shpjegon funksionin artistik të kësaj zgjedhjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 (b) 3 pikë

Të dhënat:

- Kola duket se nuk ka asnjë rrugëzgjdhje për të mbështetur familjen që po shkon keq e më keq.
- Kola po shkon drejt veseve (shpirti i Kolës...) (e nënkuptuar).
- Djali është i sëmurë rëndë dhe ka nevojë për barna për shërim.
- Varfëria e kësaj familjeje është e skajshme, ata nuk kanë as bukë të hanë.

Pse janë vendimtare:

- Të gjitha këto të dhëna janë vendimtare pasi varfëria e problemet e tjera të kësaj familjeje janë ekstreme dhe, në kushte të tilla, edhe vendimet do të jenë ekstreme.

2 pikë Nëse identifikon dy të dhëna nga fragmenti.

1 pikë Nëse shpjegon pse ato janë vendimtare.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 2 pikë

Përgjigje e plotë

Përgjigjja duhet të theksojë se në bazë të tragjizmit qëndron pikërisht **tjetërsimi** i të dy personazheve.

- Të dy personazhet po tjetërsohen shkallë pas shkalle. Ky tjetërsim përbën edhe bazën e tragjizmit të tyre.
Ata po jetojnë varfërinë më të skajshme, po vuajnë deri në kufijtë e ekzistencës. Kjo gjendje bëhet tragjike për faktin se, veç të tjerash, kjo shkallë mjerimi i **tjetërson**. Ata po humbasin vlerat njerëzore dhe po shkojnë drejt veprimeve që përmbushin nevojat më minimale, instinktë fillestare: të hanë për të mbijetuar.

OSE

- Kola po kalon në një pasivitet gjithnjë e më të dukshëm, i paaftë, i pafuqishëm të ndryshojë gjendjen e tij dhe të familjes.
Gruaja e tij, në buzë të mjerimit, po kërkon rrugën e shpëtimit për të birin, duke humbur veten dhe duke përdhosur dinjitetin e saj.

OSE

- Nga një personazh pasiv, stoik në përballimin e skamjes, Kola “shkatërrohet” (huajtësohet) menjëherë. Ai ka humbur gjithçka dhe veten. Ai kurrë nuk është rebeluar, edhe në këtë moment ai s’ka fuqi të ulërijë e të bërtasë. Sfida e mjerimit ia doli ta degradojë dhe huajtësojë atë. Nga ana tjetër gruaja, në emër të detyrimeve të saj si nënë dhe grua, po humbet cilësitë e veta morale.

OSE

- Të dy po humbasin vlerat morale, për shkak të mjerimit të skajshëm.
- Të dy po humbasin në vorbullën e mjerimit, duke shkatërruar çdo vlerë morali brenda tyre.
- Ata janë të lodhur nga mjerimi, të munduar nga tradhtia apo sëmundja e djalit. Këto i çojnë pashmangshmërisht drejt tjetërsimit final.

Përgjigje e pjesshme

- Varfëria e skajshme, po i çon në buzë të shkatërrimit përfundimtar.
- Të dy po humbasin vlerat.
- Të dy po ndryshojnë moralisht.

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

2 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të plotë** thelbin e tragjizmit të të dy personazhet.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të pjesshme** thelbin e tragjizmit të të dy personazhet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Homeri *Iliada*

Pyetja 26 C 1 pikë

Pyetja 27 D 1 pikë

Pyetja 28 B 1 pikë

Pyetja 29 1 pikë

- Mënyra e pritjes, me vaj dhe gjëmë (pikëllim, dhimbje etj), dëshmon për raporte të nderimit, respektit, vlerësimit, dashurisë.

1 pikë Nëse tregon domethënien që ka kjo mënyrë pritjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

3 pikë

Përgjigje e plotë

Vargjet e para të fragmentit nisin me një shkallëzim: *I plasi vaji* dhe *vuri ulërimën* dhe vijojnë me metaforën: *duke u lëshuar* (jo- duke rendur, që është veprim njerëzor), të gjitha të hiperbolizuara, të cilat shpalosin shkallën e lartë të dhimbjes tragjike për humbjen e Hektorit. Janë detaje të veprimit, që zbulojnë gjendjen shpirtërore të Kasandrës, dhimbjen pa kufi dhe tronditjen për humbjen e vëllait.

Përgjigje e pjesshme

- Atmosfera vjen e rënduar. Figura si: metafora japin shkallën e lartë të dhimbjes.

OSE

- Kasandra është e para që shpërndan lajmin e kobshëm. Figurativisht kjo realizohet përmes figurës së metaforës apo shkallëzimit.

Si përcaktojnë tonin e të gjithë pjesës:

- Që në dy vargjet e para përcaktohet gjithçka lidhet me tonet e përvajshme të të gjithë fragmentit: *I plasi vaji e vuri ulërimën,/ duke u lëshuar përmes gjithë qytetit.* - thotë poeti. Kështu fragmenti nis me lotët e Kasandrës dhe do të vijojë me lotët e pikëllimin e të gjithë popullit.

OSE

- Një vaj i këtyre përmasave që nis me Kasandrën, do të shtrihet në gjithë fragmentin, duke përcaktuar tonet e tij të zymta e të pikëlluara, që lidhen jo thjesht me humbjen e vëllait, por të princit dhe heroit, që ishte dhe mbështetja dhe shpresa e popullit.

2 pikë

Nëse komenton në **mënyrë të plotë** dy vargjet hyrëse të fragmentit.

1 pikë

Nëse komenton në **mënyrë të pjesshme** dy vargjet hyrëse të fragmentit.

1 pikë

Nëse tregon se në ç'mënyrë ato përcaktojnë tonin e të gjithë fragmentit.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 31 (a)

1 pikë

GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA

Në përgjigje duhet të identifikohen **dy vargje**, ku kontrasti krijohet mes **së shkuarës dhe së tashmes në mënyrën se si pritet heroi**.

- *ju që dikur kreshnikut para i dilnit, /dhe ju gufonte zemra prej gëzimit,/ (tani) shkulinin leshrat duke i puthur kokën, turma rrotull me dënesë vajtonte;*

OSE

- *ju që dikur kreshnikut para i dilnit, /dhe ju gufonte zemra prej gëzimit/ (tani) që zunë përvajshëm këngën e përmotshme*

1 pikë Nëse identifikon dy vargje që krijojnë kontrast.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 (b) **1 pikë**

Rite:

- Vendosja e trupit në një shtrat të gdhendur, për të kryer ritet që i takojnë një princi.

OSE

- Vendosja e gjëmëtareve në krye të shtratit, për të kryer ritin e vajtimit.

1 pikë Nëse identifikon në fragmentin e dhënë një rit të respektimit të të vdekurit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32

2 pikë

Përgjigjja thekson se Hektori e arriti lavdinë e tij; ai fitoi **respektin** dhe **nderimin** që i bëhet heroit pas vdekjes. Argumentimi duhet të mbështetet me **ilustrime** nga fragmenti.

Përgjigje e plotë

- Hektori e arriti lavdinë e tij. Trupi i tij u prit me nderime dhe mori respektin që i takonte. Ai vdiq i **nderuar dhe respektuar nga i gjithë populli, i cili vajtoi për humbjen e tij.**

OSE

- Hektori ishte një njeri i madh, mbrojtës i popullit dhe i familjes së tij. Si të gjithë heronjtë e mëdhenj të antikitetit, ai e arriti lavdinë e tij pas vdekjes dhe, jo më kot, "Iliada" mbyllet me vdekjen e tij.

Kjo duket:

- *pse ishte mburrja e fisit dhe e qytetit*, - detaje të personalitetit të heroit që me gjallje të tij;
- *kreshnikut para i dilnit* - thotë autori dhe dihet që epiteti "kreshnik" i vendoset vetëm heronjve të lavdishëm;
- *nuk mbeti as burrë, as grua, të gjithë u pikëlluan* - dëshmon për dashurinë, vlerësimin dhe respektin që ka populli për heroin;
- *i madh e i vogël jashtë prej porte u derdhën,* / *për t'i dalë para Priamit me kufomën* – tregon për pritjen madhështore që u bëhet pikërisht heronjve të lavdishëm;
- *turma rrotull me dënësë vajtonte* – kjo prezanton përmasat e mëdha të vajtimit për humbjen;
- *ritet e varrimit* – paraqesin mënyrën se si heroi do të përcillej në botën tjetër, duke lënë gjurmë të heroizmit dhe lavdisë së fituar.

Përgjigje e pjesshme

Përgjigjja thekson se ai pritet me **nderim**, por nuk e mbështet me ilustrime **OSE** përgjigjja është e paplotë në argumentim.

- Po, Hektori e arriti lavdinë e tij. Të gjithë e presin me nderim.
- Po, Hektori u respektua nga populli i tij. Njerëzit dhe familja e pritën me pikëllim. Kjo tregon se e donin.

Përgjigje e gabuar

- Po (e paqartë),
- Po e arriti lavdinë e tij (jep thjesht një përgjigje pohuese për pyetjen).

2 pikë Nëse argumenton **në mënyrë të plotë** se pse Hektori e arriti ose jo lavdinë pas vdekjes.

OSE

1 pikë Nëse argumenton **në mënyrë të pjesshme** se pse Hektori e arriti ose jo lavdinë pas vdekjes.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 33

2 pikë

Çfarë fiton "Iliada" nga rrëfimi në vargje?

Përgjigjja duhet të theksojë çfarë nga fiton vepra nga ky rrëfim në vargje, duke nënvizuar elemente të veçanta që mbart ky rrëfim. Përgjigjja duhet të përmbajë edhe shpjegimin se si do të kishte qenë kjo vepër, po të ishte në prozë, duke theksuar disa elemente që mbart proza.

Përgjigje e plotë

- Fiton më emocion, më ndjenjë, bëhet më e prekshme. E rrëfyer në vargje, ajo fiton një forcë më të madhe shprehëse, figuracion më të fuqishëm, muzikalitet, ritëm etj, që na lejon të ndiejmë së bashku me personazhet, të përjetojmë ndjesitë e tyre.

Nëse do të ishte **në prozë**, figuracioni do të kishte qenë më i kufizuar, pasi peshën kryesore do ta mbante ngjarja në vetvete, vëmendje e lexuesit do të orientohej më shumë tek aksioni dhe më pak tek detajet që ngacmojnë ndjeshmërinë.

OSE

- Poema ka më shumë muzikalitet, më shumë figuracion, transmeton më shumë emocion dhe përfytyrim të lexuesit (dëgjuesit). Në prozë këto nuk janë dhe aq të dukshme, pasi vendin kryesor e zë ngjarja, veprimi.

Përgjigje e pjesshme

- E rrëfyer në poezi vepra fiton më shumë forcë.
- E treguar në vargje, vepra përçon më shumë emocion.
- Po të ishte e rrëfyer në prozë, ajo do të ishte e përqendruar vetëm tek veprimi, ngjarja.
- E rrëfyer në vargje, vepra mbart më emocionalitet, kurse në prozë vëmendjen gjithçka do të ishte aksion.

2 pikë

Nëse shpjegon **në mënyrë të plotë** se çfarë fiton vepra e rrëfyer në vargje.

OSE

1 pikë

Nëse shpjegon **në mënyrë të pjesshme** se çfarë fiton vepra e rrëfyer në vargje.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 34

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku përshkruan marrëdhënien që ka krijuar me natyrën,
- përdor shembuj dhe ilustrime, fjalë kyç etj, për të përshkruar raportin e krijuar, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

1 pikë **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen;
 - zhvillimin
 - përfundimin.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike, përshkruese, subjektive,
- leksik i shumëllojshëm dhe fjalor i pasur me detaje (ndjesore),
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë**
(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.

Kurrikula e vjetër

MATURA SHTETËRORE

PJESA I

Koha

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë**

Pasojat negative:

- nxënësit mund të marrin nota jo të mira,
- obeziteti,
- jemi bërë të pandjeshëm ndaj dhunës,
- mund të kenë shqetësime gjatë gjumit.

2 pikë Nëse identifikon dy pasoja.

DHE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një pasojë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 **2 pikë**

E veçanta e fillimit të tekstit:

- Teksti fillon me disa thënie, një si lloj dialogu imagjinar, pohime të ndryshme në lidhje me çështjen që do të trajtohet përgjatë të gjithë këtij teksti.
Më pas autori i drejtohet lexuesit me disa pyetje (fjali pyetëse) të drejtpërdrejta, ku shtron çështjet për diskutim.

Arsyeja:

- Tërheq vëmendjen, i përfshin lexuesit apo dëgjuesit menjëherë në temën që do të trajtojë.

1 pikë Nëse tregon të veçantën e fjalive hyrëse.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 10 **3 pikë**

Elemente të tekstit informues:

- në një vit, ky total arrin në 1642 orë;
- në një vit, janë 68 ditë;
- më shumë se dy muaj;
- në një javë janë 30 orë e gjysmë;
- rreth katër orë e gjysmë duke parë televizor çdo ditë.

Funksioni:

- Ato mbështesin argumentet me të dhëna të besueshme.

2 pikë Nëse identifikon dy momente ku shfaqen tipare të tekstit informues.

1 pikë Nëse tregon funksionin që ato luajnë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë**

Dëmi më i madh:

- Koha që na vjedh.

Pse?

- Autori e shikon televizorin si dikë që na merr diçka dhe jo thjesht na e merr, por na e vjedh. Këtë e bën në mënyra të ndryshme, por në fund është një kohë që nuk na vjen më, të cilën e humbasim përgjithnjë. Është diçka që ikën pa kthim. Koha është e shtrenjtë dhe nuk zëvendësohet me asgjë. Po humbi, e humbasim për fare.

1 pikë Nëse identifikon mendimin e autorit për dëmin që na sjell televizori.

1 pikë Nëse shpjegon pse ky mendim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12 (a)

2 pikë

Përgjigje e plotë

- Shumë njerëz kanë frikë, pasi ata mendojnë se televizori është e vetmja mënyrë që ata të kalojnë kohën. Duke mos u përfshirë në veprimtari të ndryshme, ata e shikojnë televizorin si të vetmin burim kënaqësie. Në këtë mënyrë, mungesa e tij do të bënte që ata realisht të mos dinin se çfarë të bënin.

Përgjigje e pjesshme

- Kanë frikë, pasi televizori është për ta i vetmi mjet argëtimi.

OSE

- E shohin televizorin si të vetmen mundësi për të kaluar kohën.

2 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të plotë** pse njerëzit kanë frikë të rrinë pa parë televizor.

1 pikë Nëse shpjegon **në mënyrë të pjesshme** pse njerëzit kanë frikë të rrinë pa parë televizor.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12 (b) 3 pikë

Përgjigje e plotë

- Stil unik jete do të thotë të krijosh një mënyrë individuale të të jetuarit, një mënyrë jetese që të përmbush ty dhe i jep vlerë jetës sate. Kjo do të thotë t'i kushtosh kohë vetes në radhë të parë dhe më pas atyre që kanë rëndësi për ty: familjes, miqve. Ta mbushesh jetën tënde me veprimtari të dobishme, që çojnë në përmbushjen e ëndrrave dhe pasioneve.

Përgjigje e pjesshme

- Të krijosh një stil unik jete, do të thotë të jetosh sipas mënyrës sate.
- Të krijosh një stil unik jete, do të thotë të jesh vetvetja.

Ilustrime (shembujt janë në paragrafin e tetë):

- jete që nuk zotërohet nga programet komerciale;
- të shijosh natyrën;
- të merresh me kopshtari, sporte, mësime vallëzimi;
- të shëtisësh në natyrë;
- të krijosh nga imagjinata;
- etj.

2 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të plotë** çfarë do të thotë stil unik jete.

1 pikë Nëse shpjegon në **mënyrë të pjesshme** çfarë do të thotë stil unik jete.

DHE

1 pikë Nëse mendimin e ilustron me shembuj nga teksti.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Ilustrimet mund të merren drejtpërdrejt nga fragmenti ose të perifrashohen.

PJESA II

Petro Marko

Nata e Ustikës

Pyetja 13	D	1 pikë
Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	A	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë

Pyetja 19 **2 pikë**

Arsyet:

- prezenca e ushtarëve;
- mënyra e trajtimit;
- pritja e gjatë në atë mjedis;
- heshtja e rëndë;
- frika nga vdekja;
- fakti që nuk dinë ku e si do të shkojnë;
- etj.

2 pikë Nëse identifikon dy nga arsyet që shkaktojnë reagimin e të burgosurve.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një arsye që shkakton reagimin e të burgosurve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20

2 pikë

Antiteza:

- Ata **poshtë** sikur do të na hanin me dhëmbë. Ne **lart** këndonim.
- Ne tundeshim në erë. / Përposh nesh britma.
- Ne tundeshim në erë./ Mijëra njerëz me grusht na kërcënonin.
- Turma sikur deshi të na hante./ Po ja që ne ishim lart.
- Kënga ngrihej më lart se ne./ Turma kishte heshtur.
- Ne tundeshim në erë duke kënduar./ Turma kishte heshtur

Shpjegimi:

- Antiteza sjell raportet mes histerisë së turmës dhe individëve që shpesh janë viktima të saj.
- Antiteza shpalos shkallën e urrejtjes që nxit lufta tek njerëzit, dëmin e madh që i bën ajo raporteve njerëzore.
- Lufta është shkatërrim, ndërsa kënga është shpresë për të ardhmen më të mirë.

1 pikë Nëse identifikon dy fjalitë.

1 pikë Nëse shpjegon funksionin e kontrastit që krijohet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (a) 1 pikë

Përgjigjja duhet të theksojë: fatin e përbashkët midis të burgosurve dhe turmës, si dhe dashurinë njerëzore, pa luftë klasore.

- Iloja reagon ashtu për të treguar se të burgosurit dhe turma janë njëloj viktima të një lufte që e bëjnë të tjerët për qëllime shoviniste. Ai këndon në gjuhën italiane një këngë me fjalë internacionaliste, për të dëshmuar se kjo nuk është një luftë klasore.
Ai do të nënvizojë idenë e dashurisë njerëzore në kontrast me urrejtjen, për të ndërtuar një botë më të mirë.

OSE

- Të gjithë janë njësoj, të gjithë po vuajnë nga kjo luftë, pavarësisht kombësisë. Dashuria njerëzore është mbi dhunën, mbi luftën. Të gjithë janë *një* përballë këtij kaosi.

OSE

- Iloja reagon ashtu për të treguar se të gjithë janë njësoj përballë një lufte të tillë.

OSE

- Të gjithë janë viktima në këtë luftë.

1 pikë Nëse shpjegon reagimin e Ilos.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (b)

3 pikë

- Iloja është kurajoz, qëndresëtar, energjik, edhe pse ka kaluar një kalvar mundimesh, si edhe të tjerët.

Pse në gjuhën italiane:

- Fakti që këndon në gjuhën italiane, dëshmon se ai nuk këndon vetëm për shqiptarët, por për të gjithë bashkëvuajtësit me të, madje edhe për ata që e trajtojnë si armik, pasi ai vetë nuk sheh armikun tek ata.

Shpjegimi

- Ai e gjen fuqinë për të reaguuar kështu tek e drejta që ka me vete, tek ideali për çlirim e popujve nga dhuna fashiste, tek besimi që popujt do ta fitojnë lirinë.

1 pikë

Nëse shpjegon çfarë tregon për karakterin e llos fakti që këndon i pari.

DHE

1 pikë

Nëse shpjegon pse ai këndon në gjuhën italiane.

DHE

1 pikë

Nëse shpjegon se ku e gjen kurajën Iloja.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 **3 pikë**

Pyetjet retorike:

- Si dukeshin ashtu? Po ç'thoshin? Po kjo? Qeshnin me ne që u dukeshim si miza? Ç'është kjo pritje në tokën italiane?

Gjendja shpirtërore:

- Në të gjitha rastet kemi të bëjmë me **ankthin** e të burgosurve përballë fatit të tyre. Ata janë të pasigurt, të befasuar nga situata ku ndodhen, madje edhe të fyer.

Vlera që fiton vepra:

- Nga pikëpamja stilistike pyetja retorike siguron një **komunikim më të drejtpërdrejtë** me lexuesin, duke theksuar atë çfarë po përjetojnë të burgosurit në atë moment.
- Të duket sikur pyetja të fton në bashkëbisedim, për të komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi gjendjen e trazuar që personazhet po përjetojnë.

1 pikë Nëse identifikon një rast të përdorimit të pyetjes retorike.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon gjendjen shpirtërore që ajo thekson.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon vlerën që fiton vepra nga ky përdorim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 2 pikë

Pjesa e ligjëratës: folja

Interpretimi:

- Folja **tundeshin** në erë, sjell imazhin e një objekti jonjerëzor, rroba, rrecka, që i merr era dhe i lëviz andej nga fryn ajo. Në nëntekst theksohet mënyra e trajtimit të njeriut në periudhën e luftës. Ai nuk trajtohet si njeri, por si një robë çfarëdo, si një plaçkë e pavlerë që e fryn era.

1 pikë Nëse identifikon pjesën e ligjëratës.

DHE

1 pikë Nëse interpreton imazhin e krijuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24

2 pikë

Përgjigje e plotë

- Kënga është simbol i së ardhmes së popujve liridashës, të cilët janë solidarë në qëndresën e tyre; është simbol i botës së re, pa shtypje e luftëra. Të burgosurit (*ne*) janë vetëm një pjesë e atyre që vuajnë pasojat e luftës. Prandaj kënga ngrihet më lart se grupi i të burgosurve shqiptarë, sepse u takon më shumë se sa vetëm të burgosurve shqiptarë.

OSE

- Kënga i takon një shpirti të lirë, pa pranga. Njeriun mund ta burgosësh fizikisht, por shpirti i mbetet atij. Atë është e vështirë ta burgosësh. Krijohet një kontrast kontekstual midis asaj çfarë mund ta prangosësh (trupit) dhe asaj që nuk mundesh (këngës). Ndaj kënga ngrihet lart, si simbol i shpresës dhe i lirisë.

Përgjigje e pjesshme

- Kënga është simbol i së ardhmes, i lirisë, i shpresës.

2 pikë

Nëse interpreton **në mënyrë të plotë** nëntekstin e fjalisë.

OSE

1 pikë

Nëse interpreton **në mënyrë të pjesshme** nëntekstin e fjalisë.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25

8 pikë

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se çfarë është më e rëndësishme: përfshirja në jetën reale apo ndjekja e versionit të saj në televizor,
- përdor shembuj dhe ilustrime, fjalë kyç etj, për të mbështetur idenë e tij mbi raportin e krijuar, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve,
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË

2 pikë

1 pikë

Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen,
 - zhvillimin (argumentin/argumentet),
 - përfundimin.

1 pikë

Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë,
- shprehet me një gjuhë eseistike argumentuese, bindëse, subjektive,
- ka fjalor të pasur,
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore,
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta,
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm,
- ka saktësi drejtshkrimore.